PLANI I KOSOVËS PËR VEPRIM NË MJEDIS 2006 – 2010

PRISHTINË, PRILL 2006

Përgatitur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
në bashkëpunim me Qendrën Rajonale të Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore
Zyra në Kosovë

Projekt i financuar nga Qeveria Suedeze, përmes
Swedish International Development Corporation Agency

Prishtinë, Prill 2006

Fjala e ministrit

Kosova, ka trashëguar një numër të madh problemesh mjedisore, të akumuluara me dekada si pasojë e shfrytëzimit të pakontrolluar të resurseve natyrore dhe minierave, prodhimit industrial shoqëruar me një shkallë të lartë të ndotjes, dhe me mungesë të madhe politikash, ligjesh dhe institucionesh relavante për të trajtuar dhe zgjidhur këto probleme. Kjo ka sjellë një degradim të dukshëm dhe në raste të pariparueshëm të mjedisit dhe me këtë një ndikim direkt në shëndetin e popullatës.

Momenti historik në të cilin po kalon Kosova, dhe orientimi i saj në të ardhmen për proceset e intergrimeve evropiane, kërkon një veprim të përgjegjshëm të të gjitha institucioneve përmes politikave efikase sektorale. Kompletimi gradual i infrastrukturës ligjore, ngritja e institucioneve kompetente në nivelin qendror dhe atë lokal, përgatitja e dokumentave kryesore politike si: Raporti për Gjendjen e Mjedisit 2003, Strategjia e Kosovës për Mjedisin, janë zhvillimet kryesore të Minisitrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nga themelimi i saj, që shkuan paralelisht me disa hapa të vegjël por të dukshëm të përmirsimit të mjediseve urbane të qytetarëve të identifikuara tashmë me "Kosova- shtëpia ime".

Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis, që është edhe pjesë e programit të Qeverisë, paraqet dokumentin e parë të tillë mjedisor në Kosovë, që synon përmirsimin gradual të mjedisit dhe kushteve të tij të ngarkuar me ndotje nga e kaluara, e me këtë edhe përmirsimin e shëndetit të popullatës.

Plani i Veprimit, për 5 vitet e ardhshme do të jetë korniza themelore e të gjitha aktiviteteve për përmirsimin gradual të kushteve mjedisore në Kosovë, mbi të cilin duhet të mbështeten prioritetet e veprimit të institucioneve përgjegjëse për mjedisin, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal. Këtu duhet potencuar edhe nevojën e modaliteteve të involvimit të komunitetit shkencor, shoqërisë civile, bizneseve si akterëve tjerë të rëndësishëm në të gjitha këto zhvillime.

Plani i Veprimit adreson detyra konkrete për vendimmarrësit dhe jep përgjegjësi të qarta për të gjithë rol-luajtësit, të afatizuara për periudhën 2006-2010, në hartimin dhe aprovimin e politikave dhe legjislacionit primar dhe atij sekondar, në mënyrë që Kosova të përafroj politikat mjedisore me kërkesat e *Aquis Communitaire*, paralelisht me zgjidhjen e statusit dhe hapave për integrimet evropiane, ku mjedisit paraqet një ndër kushtet kryesore. Konsiderimi i kërkesave të Programit të VI-të Akcional Mjedisor të BE në të gjitha dokumentet e ardhshme politike mjedisore që derivojnë nga ky Plan, do të jetë një sfidë e paevitueshme për tu përballuar nga zhvillimi ekonomik i Kosovës për periudhën në vijim.

Dokumenti i Planit paraqet një udhëzues konkret për mekanizmat ndërkombëtar finaciar dhe komunitetin e donatorëve prezent në Kosovë, që deri tani na kanë ndihmuar në fushën e mjedisit, se cilat janë aktivitetet prioritare të veprimit në mjedis për 5 vitet e ardhshme në Kosovën, dhe ku Ministria jonë pret mbështetjen e mëtutjeshme.

Në fund sinqerisht më duhet të falenderoj qeverinë suedeze që përmes SIDA-s, financoi hartimin e Planit, si dhe Qendrën Rajonale të Mjedisit (REC), Zyrën në Kosovë, për implementimin e sukseshëm dhe në kohë. Po ashtu i falenderoj të gjithë ekspertët vendor e ndërkombëtar të angazhuar për 18 muaj me radhë që me ekspertizën e tyre pakursyeshëm i kontribuan hartimit të këtij dokumenti.

Prishtinë, Prill 2006

Ardian Gjini



Ministër i Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor

PËRMBAJTJA

KAPITULLI 1
1.1 PROCESI DHE METODOLOGJIA E PKVM 9
1.2 STRATEGJIA E KOSOVËS PËR MJEDIS 9
1.3 KONCEPTI DHE METODOLOGJIA E HARTIMIT TË PKVM 10
1.4 KRONOLOGJIA E PROCESIT TË PKVM 13

KAPITULLI 2
2.1 GJENDJA E MJEDISIT NË KOSOVË NË VITIN 2006 15

KAPITULLI 3
3.1 STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT TË PKVM 19
3.2 LISTA E PROJEKTEVE PRIORITARE 20

KAPITULLI 4
4.1 MENAXHIMI I KUALITETIT TË AJRIT 21
4.1.1 Ndryshimet klimatike 25
4.1.2 Acidifikimi dhe eutrifikimi 27
4.1.3 Mbrojtja e shtresës së ozonit 28
4.2 MENAXHIMI I UJËRAVE 29
4.3 MENAXHIMI I TOKAVE 35
4.4 BIODIVERSITETI DHE TRASHËGIMIA NATYRORE 37
4.5 MENAXHIMI I MBETURINAVE 41
4.6 SHËNDETI DHE MJEDISI 46
4.7 SIGURIA KIMIKE DHE BIOLOGJIKE 50
4.7.1 Kimikatet 50
4.7.2 Siguria biologjike 52
4.8 MBROJTJA CIVILE 53
4.9 MBROJTJA NGA RREZATIMI 55

4.9.1 Rrezatimi jonizues……..... 55
4.9.2 Rrezatimi jo jonizues …….. 55
4.10 ENERGJETIKA 56
4.11 INDUSTRIA DHE MINIERAT 61
4.12 TRANSPORTI 65
4.13 BUJQËSIA 67
4.14 MENAXHIMI I PYJEVE 71
4.15 EDUKIMI DHE NDËRGJEGJËSIMI 74
4.16 MENAXHIMI I INTEGRUAR HAPËSINOR..... 76

KAPITULLI 5
5.1 LISTA E PROJEKTEVE PRIORITARE 81

SHTOJCA I
Lista e Konventave, Direktivave, Rregulloreve dhe Vendimeve të BE që duhet të konsiderohen gjatë implemntimimit të PKVM 181
……

SHTOJCA II
Lista e ekspertëve që punuan në hartimin e PKVM 186

FJALORTHI I SHKURTESAVE

AEM	Agjencia Evropiane e Mjedisit
AER	Agjencioni Evropian për Rindërtim
AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
AKMM	Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
ANEA	Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike
APPELL	Vetëdijësimi dhe Përgatitja për Emergjenca në Nivel Lokal (APPELL – Awareness and Preparedness for Emergencies at Local Level)
ARPL	Autoritetet Rajonale për Pellgje Lumore
BE	Bashkësia Evropiane
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
BRE	Burimet e Ripërtritshme të Energjisë
DKU	Direktiva Kornizë për Ujëra
EE	Efiçienca Energjetike
EMP	Ekipi Menaxhues i Projektit
EQL	Evropa Qendrore dhe Lindore
FAO	Organizata për Ushqim dhe Bujqësi (FAO – Food and Agriculture Organisation)
GIS	Sistemi Gjeografik i Informatave (GIS – Geographical Information System)
GS	Gazrat Serrë
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
IKMN	Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
INKOS	Agjencia Mjedisore në KEK
IPVQ	Institucionet e Përkohëshme Vetëqeverisëse
ISO	Organizata për Standarde Ndërkombëtare (International Standards Organisation)
IVL	Institucionet e Vetëqeverisjes Lokale
IZHNJ	Indeksi i Zhvillimit Njerëzor
KB	Kombet e Bashkuara
KDU	Korniza Direktivë për Ujëra
KE	Këshilli Evropian
KE	Komisioni Evropian
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOR	Kosovo Force
KFOS	Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur
KK	Kuvendi Komunal
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
KRSHP	Komisioni Rregullativ për Shërbime Publike (PURC - The Public Utilities Regulatory Commission)
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MË	Mega Watt
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MSHP	Ministria e Shërbimeve Publike
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MTP	Ministria e Transportit dhe Postë-telekomunikacionit

NP/P	Ndërmarrjet publike/private
NPO	Ndotësit Persistent Organik (POPs - persistent organic pollutants)
OBEZH	Organizata për Bashkëpunim, Ekonomi dhe Zhvillim
OBSH	Organizata Botërore për Shëndet
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
OMGJ	Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht
PEMM	Programi Evropian për Monitorim Mjedisor (EMEP-Europian Monitoring and Evaluation Programme)
PFN	Pika Fokale Nacionale
PKIN	Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes
PKVM	Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
PLM	Plani Lokal Mjedisor
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
REACH	Vlerësimi i Regjistrimit dhe Autorizimit të Kimikateve (REACH – Registration Evaluation on Authorising Chemicals)
REC	Qendra Rajonale për Mjedis (REC – Regional Environmental Center)
Sida	Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida – Swedish Development Coorporation Agency)
SKM	Strategjia e Kosovës për Mjedis
SVO	Substancat që Varfërojnë Ozonin (ODS - Ozone Depleting Substances)
SWOT	Analiza Përparësive, Dobësive, Mundësive dhe Rreziqeve (SWOT – Strenghts, Weaknesses, Opportunities and Threats)
TSD	Totali i Substancave të Depozituara
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
VCJ	Vlerësimi i Ciklit Jetësor
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik i Mjedisit

Kapitulli 1

1.1 PROCESI DHE METODOLOGJIA E PKVM

Hyrje

Në qershor të vitit 2004, Qeveria e Kosovës[1] e ka miratuar Strategjinë e Kosovës për Mjedis (SKM). Në mbështetje të këtij dokumenti dhe detyrimeve që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit është hartuar ky plan i veprimit mjedisor për Kosovën.

Fillimisht, duke i dhënë rëndësi obligimeve strategjike, PKVM bazohet në parimet e partneritetit dhe ndarjes së përgjegjësisë. Me rëndësi është fakti që PKVM do të ndihmojë në procesin për integrimin e Kosovës në BE. Kështu që, gjatë hartimit të këtij dokumenti janë marrë në kosiderim obligimet[2] që dalin nga ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

PKVM, ashtu sikur edhe Strategjia nuk është hartuar si një dokument sektorial por më shumë si një instrument për t'u përdorur në vendosjen e procesit për përmirësimin e gjendjes mjedisore. Plani është dokument i hapur i cili do t'i nënshtrohet azhurnimit dhe revididimit të vazhdueshëm edhe gjatë fazës së implementimit.

PKVM duhet të mundësojë përmbushjen e obligimeve individuale të rëndësishme strategjike bazuar në parimin 'hapat e vegjël' dhe përmes involvimit të sa më shumë palëve që është e mundur dhe aty ku është e mundur, me përshtatjen e orientimeve strategjike në detyra konkrete, me partnerë të dëshmuar, vlerësim të kostos, burime financiare dhe afate kohore.

Gjatë procesit të prioritizimit të aktiviteteve vëmendje e veçantë i është kushtuar faktit që varfëria është një problem i madh dhe se duhet bërë përpjekje në të gjitha mënyrat e mundshme për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm të shoqërisë kosovare.

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) është zgjedhur si agjenci implementuese për zhvillimin e PKVM dhe e gjithë puna është kryer në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor[3]. Projekti është financuar nga Qeveria Suedeze përmes Agejncisë Suedeze për Zhvillim Bashkëpunim Ndërkomëbtar (Sida).

1.2 STRATEGJIA E KOSOVËS PËR MJEDIS

Procesi i hartimit të Strategjisë për Mjedisin e Kosovës nga ana e Minstrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka filluar në fillim të vitit 2003. Në vazhdim projekti është financuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur. Gjatë një takimi punues 4 ditor në Tiranë janë vënë bazat e punës për hartimin e Strategjisë.

---

[1] Për shkak të mungesës së procedurave parlamentare për aprovimin e strategjive sektoriale Strategjia nuk i është dorëzuar Kuvendit të Kosovës për shqyrtim edhe pse si dokument është miratuar nga komisioni qevertiar

[2] PKVM në masë të madhe i ka inkorporuar parimet e Planit të 5 për Mjedis dhe aty ku kjo ka qenë e mundur edhe orientimet e dala nga Programi i 5 dhe i 6 për Veprim në Mjedis. Janë analizuar konventat ndërkombëtare dhe janë marr parasysh obligimet ligjore të vendeve në integrim dhe vendeve të reja anëtare të BE.

[3] Këto dy entitete nënshkruan me 16. 04. 2004 një Marrëveshje Mirëkuptimi me qëllim të realizimit të projektit

Nga prilli 2003 deri në prill 2004, Grupet punuese të Strategjisë kanë hartuar këtë dokument.. Në përfundim të punës, u sigurua mbështetja e Qeverisë Suedeze përmes Sida-s e cila se finalizoi projektin e Strategjisë me ndihmën e ekspertizës ndërkombëtare.

Strategjia për Mjedisin e Kosovës u miratua nga ana e Qeverisë së Kosovës në mbledhjen e datës 14 korrik 2004.

Strategjia identifikon problemet kyçe mjedisore dhe përcakton orientimet strategjike, bazuar në Raportin e Gjendjes Mjedisore të vitit 2003.

Prioritetet e Strategjisë

i. Kompletimi i legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit, në harmoni me kushtet ekzistuese të Kosovës, plotësimin gradual të standardeve të BE, dhe zbatimi efikas i atyre ekzistuese
ii. Ngritja e institucioneve kompetente, të afta, të pajisura me kapacitete njerëzore dhe mjetore për zbatimin e politikave mjedisore. Këtu, para së gjithash : • institucionet vendimmarrëse, • institucionet monitoruese,dhe • institucioneve mbikëqyrëse dhe inspektive.
iii. Sigurimi i mjeteve të nevojshme financiare dhe instrumenteve efikase ekonomike, për një mbrojtje të mjedisit në hap me zhvillimin ekonomik. Themelimi i domosdoshëm, i Fondit Mjedisor.
iv. Rritja graduale e përqindjes së qasjes së popullatës në ujë të sigurt të pijës, në sistemin e kanalizimit, në sistemin e trajtimit të mbeturinave si dhe përkrahja e programeve të riciklimit të ujërave të zeza dhe mbeturinave.
v. Krijimi dhe funksionimi i rrjetit të monitorimit të mjedisit në nivel vendi duke e shtrirë atë me prioritet në subjektet e mëdha ndotëse industrial dhe në "hot spotet" në Kosovë.
vi. Përdorimi dhe shfrytëzimi racional i resurseve natyrore: tokë, ujë, minerale, pyje etj. duke pasur kujdes në përdorimin e atyre të rrezikuara dhe orientimin drejt resurseve të përtritshme.
vii. Rritja e sipërfaqes dhe mbrojtja e zonave të trashëgimisë natyrore dhe atyre me vlera të veçanta natyrore krahas rritjes së kapaciteteve për një menaxhim efikas të tyre në pajtim me parimet e Deklaratës së Rios.
viii. Zhvillimi i programeve afatgjata edukative, arsimore, fushatave të ndërgjegjësimit si dhe përkrahja e projekteve shkencore të fokusuara në mjedis.
ix. Përkrahja e konceptit të sjelljes së teknologjive të pastra në Kosovë në fazën e fillimit të industrive të reja dhe rifillimit të industrisë ekzistuese.
x. Zbatimi i konceptit të efikasitetit energjetik në të gjithë sektorët e shfrytëzimit të energjisë.

1.3 KONCEPTI DHE METODOLOGJIA E HARTIMIT TË PKVM

Krahas me strategjinë, filloi edhe puna në Planin e Kosovës për Veprim në Mjedis. PKVM është një dokument i cili ofron hapat praktik për implementimin e strategjisë. Parimi kryesor në të cilin u mbështet hartimi i PKVM ishte integrimi dhe respektimi i dukumenteve relevante ekzistuese dhe të detyrueshme legjislative. Për këtë arsye PKVM synon prioritetin e përafrimit të Kosovës me BE.

Dokumenti i PKVM mbështetet në këto kritere, si:

- Direktivat e Kapitullit 22 të a*cquis communautaire* për mjedis*;*
- Strukturën dhe idenë e Programit të 5-të të BE për Veprim në Mjedis (PVM);

- Elementet e PVM të 6-të janë përfshirë në dokument aty ku kjo është konsideruar të jetë relevante dhe reale të bazuara në kushtet e Kosovës në kohën e hartimit; dhe
- Elementet e Konventave dhe Protokolëve ndërkombëtar.

Përveç SKM janë konsultuar edhe strategjitë sektoriale të aprovuara nga Qeveria si Strategjia Energjetike e Kosovës, Libri i Gjelbër i Kosovës etj., përfshirë dhe të tjera që janë në procedim. Njëkohësisht, jemi përballur me mungesën Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, që ka paraqitur një pengesë në hartimin e prioriteteve të Strategjisë së Kosovës për Mjedis ashtu edhe gjatë hartimit të dokumentit të PKVM.

Integrimi në BE është një nga prioritetet e Qeverisë, së bashku me zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Për këtë arsye në Qeveri është themeluar Zyra për Integrime Evropiane e cila udhëheq Mekanizmin Përcjellës të Procesit të Stabilizim Asocimit. Në mbledhjen e 5-të të këtij Mekanizmi (shtator 2004), të mbajtur në Bruksel, një nga pikat e rendit të ditës ishte mjedisi, në të cilën u diskutua harmonizimi i legjislacionit mjedisor ekzistues me direktivat e BE-s dhe u trajtua edhe Strategjia e Mjedisit si dhe puna në Planin e Veprimit. Harmonizimi i legjislacionit mjedisor me atë të BE është edhe një ndër prioritetet themelore të Qeversisë së Kosovës.

Në pajtim me procesin e harmonizimit të politikave vendore me ato ndërkombëtare e mbi të gjitha ato të BE-s, puna si në Strategjinë e Mjedisit ashtu edhe në Planin e Veprimit është mbështetur në Programin e V-të për Veprim në Mjedis të BE-së. Programi i V-të për Veprim ka pesë objektivat kryesore , si:

- ***Formulimi i strategjive për shtatë probleme prioritare (ndryshimet klimatike, acidifikimi, diversiteti biologjik, ujërat, mjedisi urban, zonat bregdetare dhe mbeturinat);***
- ***Veprimi në sektorët prioritarë në të cilët mbrojtja e mjedisit duhet integruar;***
- ***Zgjerimi i numrit dhe i të gjitha llojeve të instrumenteve me anë të të cilave zvogëlohen ndikimet në mjedis;***
- ***Informimi i plotë, transparenca në qasje dhe zhvillimi i konceptit të përgjegjësisë së ndarë;***
- ***Theksimi i dimensionit ndërkombëtar të mbrojtjes së mjedisit.***

PKVM është një dokument që nuk kufizohet vetëm në trajtimin e problemeve mjedisore por ai poashtu merr në konsideratë aspekte të shumta të zhvillimit socio- ekonomik. Gjatë gjithë përgatitjes së dokumentit është konsistuar të sigurohet një proces gjithpërfshirës duke përfshirë kapacitetet njerëzore të institucioneve lokale dhe qendrore, organizata ndërkombëtare, ekspertë universitarë, ekspertë të pavarurë, zyrtarë mjedisorë dhe përfaqësuesit e industrisë.

I gjithë procesi i përgatitjes së PKVM zgjati 18 muaj, me tre muaj zgjatje afati për qëllim të kryerjes së aktiviteteve për pjesmëarrje publike dhe informim publik. Edhe kjo pjesë plotësuese e projektit u financua nga Sida dhe përbëhej prej debateve publike, debateve televizive, zhvillimit të një webfaqeje të veçantë për PKVM si dhe botimin e katër edicioneve të Buletinit Mjedisor, në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe.

Duke pasur parasysh që kjo ishte hera e parë që MMPH zhvillonte një dokument aq gjithpërfshirës dhe në detaje si është PKVM, u pa e nevojshme që puna në fazën fillestare të projektit të fokusohej më shumë në ngritjen e kapaciteteve dhe vjeljen e përvojës teorike dhe praktike.

Po ashtu është e njohur se MMPH posedonte me resurse njerëzore me njohuri dhe mbështetje të nevojshme teknike por në këtë proces ishte esenciale të sigurohet që të gjitha palët e involvuara të jenë të vetëdijshme me kopleksitetin e shumë çështjeve mjedisore që

duhej të konsideroheshin gjatë përgatitjes së një plani gjithpërfshirës veprimi ashtu si është PKVM.

Për këtë qëllim u organizuan dhe u mbajtën trajnime të ndryshme të cilat përfshinë, mes tjerash: Ndikimin e Vlerësimit në Mjedis, Vlerësimin Strategjik të Mjedisit, Pjesëmarrjen Publike, Ekonominë Mjedisore dhe çështje tjera relevante. Me qëllim të arritjes së koordimit sa më të mirë të aktiviteteve doli e nevosjhme të mbahen prezantime dhe ushtrime praktike sa i përket menaxhimit të përgjithshëm dhe komponentëve specifike si puna ekipore, analiza SWOT dhe kost-benefit.

Gjatë gjithë procesit janë bërë përpjekje të vëzhgohet metodologjia e punës e bazuar në përvojat ndërkombëtare gjatë procesit të implemetimit të Programit për Veprim në Mjedis për Evropën Qendrore dhe Lindore si dhe udhëzimeve të dala nga zhvillimi i Planeve Nacionale për Veprim në Mjedis në shumë vende të EQL. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) kishte rolin udhëheqës gjatë gjithë projektit dhe konsiderohet të jetë pronar i dokumentit, përderisa zyra e REC në Kosovë ishtë më shumë në pozitën e agjencisë implementuese si dhe duke siguruar shërbime të konsulentit ndërkombëtar, z. Viktor Simonçiç.

Përveç kësaj janë siguruar edhe shërbimet konsultative të ekspertëve tjerë lokal dhe ndërkombëtar me qëllim të asistimit të zyrtarëve të MMPH në elaborimin e secilit sektor tematik. Shumica e anëtarëve të grupeve punuese përfaqësonin institucionet vendore, të cilat në të ardhmen do të punojnë së bashku në realizimin e aktivitetetve të projekteve të propozuara.

Megjithatë, që nga faza fillestare u vlerësua se numri i propozuar për katër GP nuk do të mjaftonte për t'i plotësuar të gjithë sektorët që do të trajtoheshin dhe përfshiheshin në këtë dokument, ashtu që u vendos që numi i GP të rritet në atë mënyrë që të korespondojë më numrin e sektorëve tematikë të përfshirë në këtë dokument.

Skema në vijim do të jep një indikacion për strukturën e vendosur dhe të përcjellur gjatë zhvillimit të PKVM:



Është shumë me rëndësi që zhvillimi i PKVM mos të kosiderohet si një proces më një synim të vetëm për të nxjerrë një dokumet të tillë. Gjatë gjithë procesit kemi synuari të mundësohet shkëmbimi i përvojave nga sektori në sektor si dhe akumulimi i njohurive dhe përvojave, të cilat do të mund të përdoren në punët ditore të MMPH, por edhe në revidimin dhe zhvillimin e dokumenteve të ngjajshme në të ardhmen, pa pasur nevojë për asistencë të jashtme.

Ky ishte edhe qëllimi për të cilin, gjatë gjithë kohës procesi u plotësua me aktivitete trajnuese për të gjithë të involvuarit nga MMPH, ministritë tjera të involvuara, institucionet dhe asociacionet tjera të përkushtuara për mbrojtjen e mjedisit dhe të involvuara në procesin e hartimit të PKVM.

Takime koordinuese të Ekipit Menaxhues të Projektit janë mbajtur për çdo javë duke mundësuar që përfaqësuesit e MMPH-së dhe REC-ut janë rënë dakord për hapat nëvazhdim të zhvillimit të këtij projekti.

1.4 KRONOLOGJIA E PROCESIT TË PKVM

Fillimisht, hartimi i projektit i PKVM ka filluar, më 2 nëntor 2004, me një ceremoni zyrtare ku ishin prezent edhe Kryeministri i atëhershmë i Kosovës, Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtori i Sida-s, agjenicitë donatore, zyrat ndërlidhëse në Kosovë dhe pjesëmarrësit tjerë

Procesi i zhvillimit të këtij projekti ishte i ndarë në tri faza kryesore:

a) nga dhjetor 2004 deri në Mars 2005 ku kryesisht u fokusua në identifikimin e problemeve, vendosjen e strukturës së projektit, themelimin e grupeve punuese dhe zhvillimin e aktiviteteve trajnuese esenciale. Gjatë gjithë procesit anëtarët e GP dhe konsulenti ndërkombëtar janë informuar dhe konsultuar në lidhje me hapat e ardhshëm në projekt. Si rezultat i fazës së parë ishte një draft fillestar, i cili në mënyrë më të përgjithësuar përshkruante gjendjën aktuale mjedisore duke përfshirë komentet dhe sugjerimet e mbledhura në Forumin e parë;

b) faza e dytë fokusohej në përgatitjen e dokumentit dhe identifikimin e problemeve prioritare;

c) faza e tretë dhe e fundit ishte zhvillimi i projekt koncepteve të përfshira në dokument. Puna e GP në hartimin e dokumentit u plotësua me aktivitete të ndryshme konsultative dhe pjesëmarrëse. Këto veprimtari janë përshruar më gjërësisht në vazhdim.

1.4.1 Forumi

Takimet e Forumit kishin një rol kyç gjatë zhvillimit të PKVM ngase ato ofruan një platformë në përmisimin e dokumentit, listës së aktiviteteve, projektkoncepteve të përgatitura nga grupet punuese, vendosjen e kritereve për prioritizim, aprovimin e draftit të PKVM, ngritjen e interesit kombëtar duke i orientuar informatat mbi PKVM deri te institucionet që ata përfaqësonin.

Forumi i parë u mbajt, më 29 mars 2005 dhe shënoi përfundimin e periudhës së parë hartuese duke inkuadruar rreth 150 ekspertë të spektrit të gjërë. Forumi rezultoi në një diskutim të hapur dhe konstruktiv rreth planit të punës si dhe me shumë sugjerime pozitive sa i përket çështjeve tjera mjedisore që do duhej të konsiderohëshin dhe përfshiheshin në dokument.

Forumi i dytë u mbajt, më 14 tetor 2005, duke përmbyllur kështu fazën e dytë të punës së grupeve punuese. Këtë herë synimi kryesor ishte në aktivitetet dhe masat e propozuara. Me qëllim të marrjes së mendime rreth kësaj u përpilua një pyetësor të prioriteteve, i cili, fillimisht iu dërgua pjesëmarrësve. Me plotësimin e këtij pyetësori nga një spektër i gjërë përvojash, propozimeve dhe interesimeve u sigurua mendimi rreth masave dhe aktiviteteve të propozuara.

1.4.2 Takimet dhe workshopet

Me qëllim të përcjelljes sa më të përafërt dhe koordinimit të punës janë mbajtur takime të rregullta me EMP dhe me moderatorët e GP. Për të siguruar komunikim efikas dhe të rregullt u krijua edhe një listë e postimit elektronik ku EMP, moderatorët e GP dhe konsulenti ndërkombëtar komunikonin rregullisht gjatë gjithë projektit.

Faza I – Fillimisht gjatë kësaj faze u mbajt një seminar dy javor, më 29 nëntor – 9 dhjetor 2004. Java e parë (29 Nëntor – 3 Dhjetor) në Maqedoni (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Maqedoni sapo e kishte përfunduar procesin e hartimit të Planit të Dytë Nacional për Veprim në Mjedis).

Ekspertë nga "Ramboll Natura" (Suedi) mbajtën prezantimi mbi vlerësimet socio- ekonommike, vlerësimin e ndikimit në mjedis, menaxhimin e projekteve dhe instrumentet planifikuese.

Si pjesë e trajnime për ngritje të kapacitetit u mbajt edhe një trajnim special njëditor me fokusim në analizën e kornizës logjike të projektit. Ky trajnim u mbajt nga një kompani vendore, Grupi për Konsultime dhe Shërbime. Ky trajnim u siguroi posaçërisht moderatorëve të GP por edhe vet anëtorëve të këtyre grupeve, një njohje më të afërt me instrumentet dhe procedurat e ndryshme menaxhuese, të cilat do t'i mundësonin ata të kryejnë deturat e tyrë në mënyrë sa më efiakse dhe brenda afateve të caktuara kohore.

Gajtë gjithë procesit janë mbajtur takime të rregullta të Grupëve Punuese. Faza më intensive ishte sidomos fillimi i fazës së dytë hartuese.

Faza II – Për të shënuar fillimin e fazës së dytë,më 1 prill 2005 u mbajt një workshop në Prishtinë. Qëllimi kryesor i këtij workshopi ishte të prezantohen dhe diskutohen problemet e hasura nga GP, si dhe të dakordohen aktivitetet e përshtatshme për të elaboruar dhe adresuar problemet specifike.

Faza III – Filloi me një workshop konsultativ dyditor ku mori pjesë edhe konsulenti ndërkombëtar dhe ku u trajtua përpilimi i projekt koncepteve nga grupet punuese. Koncepte këto që do të përbëjnë Listën e Projekteve Prioritare.

Për të plotësuar të gjithë programin për ngritje kapaciteti të zhvilluar gjatë projektit, por edhe për të siguruar që stafi i MMPH do të jetë në gjendje të elaborojë projektkoncpetet në projet propozime detale, në prill 2006 u organizua edhe një trajnim shtesë. Ky trajnim u mbajt nga anëtarja ndërkombëtare e Grupit Ekonomik dhe përqëndrohej në: aktivitete për gjetjen e fondeve, zhvillimin e projektpropozimeve dhe buxheteve detale. Ky ishte trajnimi i fundit ky synohej të sigurohej se institucionet përgjegjëse do të jenë në gjendje që në mënyrën më të mirë që është e mundur të prezantojnë projektidetë e tyre para Qeverisë dhe komunitetit të donatorëve.

1.4.3 Takimet e Task Force

Task Force e PKVM përbëhej nga Sekretarët e Përhershëm të ministrive të Qeversië së Kosovës. Pas prezantimit të një raporti mbi PVMK, të përgatitur nga EMP, në një nga takimet e rregullta të Sekretarëve të Përhershëm, në qershor 2006, u mbajt një takim i veçantë ku Sekretarët e Përhershëm prezent shprehen mbështetjen dhe përkrahjen për punën e bërë në PKVM.

Kapitulli 2

2.1 GJENDJA E MJEDISIT NË KOSOVË NË VITIN 2006

Disa nga specifikat themelore që e karakterizuan shoqërinë kosovare në kohën e hartimit të PKVM janë :

- Shkalla e natalitetit relativisht e lartë, ku pjesa dërmuese e popullësisë është shumë e re me shkallë të lartë të papunësisë (rreth 50%);
- Administrimi ndërkombëtar i Kosovës dhe statusi i padefinuar politik i cili pritet të qartësohet deri në fund të 2006;
- Nivel i ulët i zhvillimit ekonomik, zhvillim shumë i ngadalshëm i procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe mungesa e vizionit për zhvillim ekonomik;
- Rënie e prodhimtarisë industriale në sektorin e dikurshëm shoqëror dhe ngritje e ngadalshme e ndërmarrjeve prodhuese;
- Shkallë e lartë e varfërisë (rreth 50% jetojnë në varfëri dhe 12-16% në varfëri të skajshme);
- Dualizmi legjislativ, në qeverisje dhe në aspektin ligjor mes UNMIK dhe IPVQ;
- Mungesë e kuadrit kompetent me kualifikime profesionale në institucionet qendrore dhe lokale;
- Reformimi në të gjitha nivelet e edukimit;
- Furinizim jo i mjaftueshëm me rrymë për popullatën dhe ekonominë;
- Kriza në sektorin bujqësor dhe infrastruktura e dobët rrugore.

Ajri - Aktualisht kontribuesit më të mëdhenj të ndotjes së ajrit në Kosovë janë burimet statike edhe ato lëvizëse në zonat urbane si dhe në zonat kryesore të prodhimit të energjisë dhe zonave industriale. Këto janë objekte për prodhimin e energjisë (impiante termike), sektori i transportit, objektet industriale (metalurgjia, mihjet dhe fabrika e çimentos), aktivitetet bujqësore dhe lokacionet ku hedhen ilegalisht mbeturinat. Në objektet për prodhimin e energjisë përdoren karburantet fosile si thëngjilli, dhe derivatet e naftës me përbërje të lartë të sulfurit, sektori i transportit karakterizohet me numër të madh të makinave të vjetruara dhe përdorim të karburanteve jo adekuat. Përveç kësaj edhe sektori i industrisë në shumicën e rasteve përdor pajisje të vjetra.. Në qytetet më të mëdha mungojnë sistemet për ngrohje qendrore. Sektori i bujqësisë kontribuon në ndotjen e ajrit kryesisht përmes djegies së biomasës. Zonat ilegale për hedhjen e mbeturinave me djegie të pakontrolluara të mbeturinave paraqesin një burim serioz të ndotjes së ajrit.

Ujërat - Kosova ka rezerva të kufizuara ujore që në të ardhmen do të jenë një faktor kufizues për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit. Kosova ndahet në 4 pellgje lumore: Drini i Bardhë, Ibri, Morava e Binçës, dhe Lepeneci[4]. Mesatarja vjetore e të reshurave në Kosovë lëvizë prej 658 mm (në pellgun e lumit Sitnica) deri 1515 mm (në pellgun e lumit Erenik) me koeficienti të rrjedhës prej 4.92 l/sec/km^2 (Morava e Binçës) deri 42.46

[4] Raporti mbi gjendjen e mjedisit në Kosovë 2003

l/sec/km^2 (lumi Lumbardhë në Deçan). Nga territori i Kosovës në vitin me lagështi mesatare rrjedhin përafërsisht 3.8 x 10 ^{9} ujë përkatësisht 121.2 m^3 /sec.

Toka - Sipërfaqja e Kosovës përfshin afër 1.1 milion ha, 53% e të cilës është tokë e punueshme. Mbi 88% të tokës pyjore është pronë private. Mesatarisht një familje i takojnë 3 ha tokë.

Kosova karakterizohet me një llojllojshmëri të tokave duke u bazuar në gjenezën e krijimit të tyre dhe karakteristikave pedologjike, fizike dhe kimike. Sipërfaqja tokësore e Kosovës është përshtatshme për prodhimtari bujqësore. Llojet e tokave që më së shpeshti i hasim në Kosovë janë: humusore, toka aluviale dhe deluviale, toka shkëmbore.

Biodiversiteti - Mbrojtja e natyrës përmes zonave të mbrojtura është një instrument mjaft i rëndësishëm për ruajtjen e biodiversitetit. Deri më tani një sipërfaqe prej rreth 46247 ha (4.27% e tërë territorit të Kosovës) është e mbrojtur me ligj. Nga zonat e sipërpërmendura një është park nacional, 11 janë rezervate natyrore, 37 monumente natyrore dhe 2 janë peizazhe të mbrojtura.

Sipas studimeve që janë bërë në Kosovë, janë identifikuar rreth 1800 lloje të florës. Supozohet që ky numër është më i madh dhe arrin deri në 2500 lloje. Florën dhe faunën e Kosovës e bëjnë të rëndësishme dhe atraktive një numër i madh i llojeve endemike, relikte dhe subendemike. Zonat më të pasura me florë dhe faunë janë Malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna[5]. Mirëpo, edhe më tutje Kosova nuk ka një evidentim të plotë të biodiversitetit.

Mbeturinat - Sistemi i tanishëm i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë nuk evidenton në mënyrë të strukturuar dhe të mirëfilltë të dhëna mbi gjenerimin, mbledhjen, trajtimin, rikuperimin apo mënjanimin e mbeturinave.

Edhe pse përafërsisht 90% e popullatës urbane mbulohet me mbledhjen e mbeturinave, kjo është e një standardi mjaft i dobët për arsye të mungesës së pajisjeve dhe vendeve të dedikuara për hedhje. Zonat rurale mbulohen me më pak se 10%. Tarifa për mbeturina është 3€/shtëpi dhe pagesa e faturave është shumë e ulët (30-40 %).

Në Qershor 199-- nuk kishte sistem operativ për menaxhimin e mbeturinave.

Sasia mestare e gjenerimit të mbeturinave në Kosovë është rreth 2 kg. për kokë të banorit në ditë[6]. Nga 29 deponi komunale, 26 janë të rehabilituar. Aktualisht Agjencia Evropiane për Rindërtim (AER) dhe donatorë tjerë kanë mbështetur rindërtimin apo ndërtimin e 9 deponive sanitare në Kosovë.

Energjetika - Sektori energjetik bazohet kryesisht në prodhimtarinë elektrike dhe paraqet njërin ndër sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë. Resurset për fitimin e energjisë primare janë mjaft të larta[7], mirëpo nga aspekti i ndikimit në mjedis kjo është e dëmshme. Kryesisht përbëhet prej rezervave të mëdha të lignitit. Në fakt 97% prej gjithë energjisë elektrike që prodhohet në Kosovë brenda një viti, sigurohet nga djegia e thëngjillit në termoelektrana, përderisa hidrocentralet prodhojnë vetëm 3% të energjisë vjetore. Nuk ka përdorim të energjisë solare, termale, apo prodhim energjie nga era dhe biomasa.

Industria dhe minierat - Zhvillimi i industrisë në Kosovë ka qenë i diktuar nga interesat ekonomike të ish Jugosllavisë. Në pajtim me këtë eksploatimi i resurseve natyrore ishte shumë i përhapur, sa që në vitin 1988 energjia, metalet me ngjyrë dhe procesimi i tyre përbënte 63% të prodhimeve industriale në Kosovë. Këto aktivitete, duke pasur parasysh që nuk aplikoheshin masa për mbrojtjen e mjedisit, kanë shkaktuar ndikime të mëdha në mjedis

[5]Vlerësohet se ka: 8 lloje të ndryshme të peshkut, 13 ujtokësor, 12 lloje zvarranikësh, 154 lloje shpendësh, 37 lloje gjitarësh dhe 147 lloje të fluturave ditore.

[6] Raporti për Gjendjen e Mbeturinave në Kosovë 2003/2004 MMPH

[7] Rezervat më të mëdha të thëngjillit janë të koncentruara në këto pellgje: Pellgu i Kosovës me rezerva gjeologjike që kalojnë 11 miliard ton, Dukagjini me rezerva gjeologjike të thëngjillit që arrijnë mbi 2,5 miliard ton dhe Drenica me mbi 100 milion ton.

dhe pasojat e tyre nuk janë rehabilituar sot e kësaj dite. Kosova, nga shumë aspekte i takon grupit të vendeve në Evropë me sipërfaqe më të ndotura. Sektori i prodhimit privat ka filluar të zhvillohet këto vitet e fundit mirëpo pa një koncept dhe vizion të shëndoshë.

Transporti - Territori i Kosovës shërbehet nga një rrjeti prej 1700 km, me rrugë dykahëshe kryesore dhe dytësore (rajonale), 330 km sistem njëbinarësh hekurudhor, në Veri/Jug dhe Veri-Lindje/ Perëndim të Prishtinës dhe me një aeroport rajonal. Pas luftës së fundit pasoi një rritje enorme e numrit të automjeteve. Përafërsisht 215.000 automjete të regjistruara[8] dhe një numër i konsiderueshëm i automjeteve[9] të UNMIK-ut dhe KFOR-it. Pjesëmarrja e transportit publik është shumë e vogël. Karburantet dhe vajrat janë plotësisht nga importi. Në bazë të të dhënave të Doganës, në vitin 2002 në Kosovë u importuan pa kontrolle të rregullt të kualitetit rreth 30 000 ton dizel, dhe 25 000 ton benzinë.

Bujqësia - Në 1991, popullsia e Kosovës ishte 63% rurale, dhe vlerësohet së në vitin 2000 përqindja e popullsisë rurale[10] zbriti në 60%. Trendet e ardhshme nuk mund të parashikohen lehtë por duket sikur Kosova tani gjendet në një situatë të urbanizimit rapid. Kjo do të zvogëloj numrin e banorëve të vendeve rurale të cilët do të gjeneronin të ardhurat e tyre nga aktivitetet bujqësore.

Sipërfaqja e përgjithëshme e Kosovës është 1.1 milion ha, 53% nga e cila janë tokë e punueshme. Prej 585 000 ha të tokës së punueshme, në 51% të saj kultivohet gruri, 45% janë luadhe dhe kullosa, 2% pemishte dhe më pak se 1% vreshta.

Rreth 88% e tokës së punueshme është pronë private. Sektori i bujqësisë është në gjendje shumë të vështirë. Shumë ferma janë të braktisura përderisa edhe infrastruktura është pjesërisht e në disa raste edhe plotësisht e dëmtuar.

Pyjet - Rreth 47% të gjithë territorit të Kosovës përbëhet nga pyjet, tokat pyjore dhe djerrinat. Prej kësaj sipërfaqe pyjore janë 460.800, ose 89.93%, toka tjera pyjore janë 28.200ha ose 5.50%, dhe djerrina 23.400 ha ose 4.57%.

Pyjet në Kosovë paraqesin një resurs shumë të rëndësishëm. Mirëpo si pasojë e menaxhimit jo adekuat të pyjeve në të kaluarën ka ardhur deri të degradimi i pyjeve. Rreth 28.4000ha ose 61.63% sipërfaqes pyjore është në pronësi publike përderisa pjesa tjetër e mbetur, prej 176.800ha ose 38.37% është në pronësi private. Sipas statistikave të Agjencisë Pyjore të Kosovës rreth 222.000 m^3 të drurit teknik dhe drurit për djegie, eksploatohet nga të dyja sektorët në vit. Masa drurore[11] e tërsishme është rreth 54 mil m^3. Vëllimi mesatar i drunjëve për ha është përafërsisht 90 m^3, dhe rritja mesatare vjetore arrin përafërsisht 3 m^3 për ha.

Kërkesat e mëdha për dru në kohën e pasluftës vendosin presion të madh në qëndrueshmërinë e pyjeve dhe ekosistemeve pyjore.

[8] Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit

[9] Vlerësohet që numri i tyre arrin rreth 15-20% të numrit të plotë të automjeteve të regjistruara

[10] Sot popullata bujqësore e Kosovës llogaritet rreth 1.3 milion

[11] Të dhëna nga Inventarizimi i pyjeve 2003

Kapitulli 3

3.1 STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT TË PKVM

PKVM u hartua me qëllim të definimit të prioriteteve mjedisore për periudhën kohore 2006 – 2010. Mirëpo këto prioritetet mund të ndërrojnë në mënyrë dinamike pa e ndryshuar kuptimit thelbësor të planit.

Të gjitha aktivitetet e shtjelluara në plan janë të dizajnuara në atë mënyrë që të kenë përmbajtjen e njejtë, duke filluar nga identifikimi dhe prioritizimi i problemeve e deri të përcaktimi i rol-luajtësve kyç dhe mjetet teknike dhe financiare për zgjedhjen e këtyre problemeve.

Kapitulli 4 paraqet thelbin e PKVM. Këtu janë elaboruar masat dhe aktivitetet për të gjithë 16-të sektorët[12]. Ky përcaktim është vendosur në konsultim me ministritë relevante, institucionet shkencore dhe ekspertët e pavarur të fushave të ndryshme. Në fund të këtij procesi janë dakorduar për një numër të projekteve të caktuara që do të përfshiheshin në secilin sektor të PKVM veç e veç.

Secili prej 16 sektorëve të këtij kapitulli përfshin planin e veprimit, i cili përbëhet prej pjesës narrative dhe tabelës me aktivitetet e planifikuara:

- Përshkrimin e gjendjes së tanishme;
- Legjislacionin ekzistues;
- Identifikimin dhe prioritizimin e problemeve;
- Objektivat;
- Masat;
- Tabelën e aksioneve për veprim.

Në tabelat e veprimeve janë definuar:

- Objektiva;
- Aktivitetet;
- Niveli dhe akterët e involvuar;
- Burimet e mundshme financiare;
- Lidhjet me sektorët tjerë të planit; dhe
- Indikatorët e suksesit për secilin veprim.

Aksionet e Planit janë të prioritizuar duke marrë për bazë disa kritere kryesore si: ndikimin në shëndetin njerëzor, natyrë dhe biodiversitet, të përcjella këto me implikimet ekonomike dhe sociale.

[12]Mbrojtja e Ajrit, Menaxhimi i Ujërave, Mbrojtja e tokave, Biodiversiteti dhe Trashëgimia Natyrore, Menaxhimi i Mbeturinave, Shëndeti dhe Mjedisi, Siguria Kimike dhe Biologjike, Mbrojtja Civile, Rrezatimi, Energjetika, Industria dhe Minierat, Transporti, Bujqësia, Menaxhimi i Pyjeve, Edukimi dhe Vetëdijësimi, Menaxhimi i Integruar i Hapësirës.

Kritere shtesë për prioritizim ishin edhe:

- Parimet e zhvillimit të qëndrueshëm;
- Arsyeshmëria e projekteve potencial;
- Përmbushja e obligimeve dhe kërkesave ndërkombëtare (legjislacioni i BE dhe konventat ndërkombëtar) dhe asociimit të Kosovës në BE në të ardhmen;
- Përfitimet socio-ekonomike – varfëria;
- Përgatitja e projektit;
- Efikasiteti i kostos;
- Grupet e interesuar shtetërore dhe lokale;
- Interesi i donatorëve/qeverive.

Sa i përket proritizimit, përveç kritereve të konsideruara nga grupet punuese është mbledhur edhe kontributi i një grupi më të gjërë ekspertësh. Të dy Forumet siguruan bazën për mbledhjen e komenteve nga ekspertë të cilët nuk ishin drejtpërsëdrejti të kyçur në hartimin e planit. Forumi i parë siguroi bazën apo kornizën për prioritizimin e problemeve mjedisore që cilat do të shtjelloheshin. Ndërsa, Forumi i dytë ofroi një mundësi për dhënien e mendimeve rreth prioritizimit të aktiviteteve konkrete të propozuara për zgjidhjen e këtyre problemeve.

Bazuar në kriteret e lartpërmendura secili Grup Punues ka përcaktuar një numër të projekteve prioritare për secilin sektor apo çështje tematike.

3.2 LISTA E PROJEKTEVE PRIORITARE

Përfundimisht u përgatit një Listë e Projekteve Prioritare 2006 – 2010, përfshirë në Kapitullin 5, e cila përmban 53 projekte të përgatitura në formë të një projekt-koncepti të shkurtër, të cilat japin informacione mbi emrtimin e projektit, afatin kohor, iniciatorin dhe implementuesin e projektit, qëllimin kryesor dhe objektivat e projektit përkatës, rezultatet e pritura si dhe koston e pritur për secilin aktivitet të projektit të propozuar.

Në bazë të këtyre të dhënave Grupi Ekonomik i angazhuar për vlerësimin e ndikimit financiar dhe ekonomik të PKVM, ka udhëzuar Grupet Punuese dhe reviduar secilin projekt dhe në fund të punës së tij ka nxjerrë koston e pritshme finaciare të PKVM për 5 vitet e ardhshme.

Kapitulli 4

4.1 MENAXHIMI I KUALITETIT TË AJRIT

Ajri i pastër është me rëndësi vitale për shëndetin e njeriut. Mirëpo, që nga revolucioni industrial kualiteti i ajrit që e thithim ka rënë konsiderueshëm – kryesisht si rezultat i aktiviteteve njerëzore. Ngritja e prodhimit industrial dhe energjetik, djegia e karburanteve fosile si dhe rritja dramatike e trafikut kanë shtuar edhe më shumë ndotjen e ajrit nëpër qytete, çka si rrjedhojë mund të shkaktojë probleme shëndetësore serioze. Paralelisht me problemet shëndetësore me acidifikimet e viteve të fundit, harxhimi i shtresës së ozonit dhe ndryshimet klimatik paraqesin brenga të mëdha shoqërore.

Gjendja e tanishme

Aktualisht kontribuesit më të mëdhenj të ndotjes së ajrit në Kosovë janë burimet statike edhe ato lëvizëse në zonat urbane, zonat kryesore të prodhimit të energjisë dhe zonat industriale. Këto janë objekte për prodhimin e energjisë (impiante termike), sektori i transportit, objektet industriale (metalurgjia, mihjet dhe fabrika e çimentos), aktivitetet bujqësore dhe lokacionet ku ilegalisht hedhen mbeturinat. Në objektet për prodhimin e energjisë përdoren karburantet fosile si thëngjilli dhe derivatet e naftës me përbërje të lartë të sulfurit, sektori i transportit karakterizohet me numër të madh të makinave të vjetruara dhe përdorim të karburanteve jo adekuat. Përveç kësaj edhe sektori i industrisë në shumicën e rasteve përdor pajisje të vjetra..Mungojnë sistemet pë ngrohje qendrore në ngrohje qendrore në qendrat urbane të Kosovës. Sektori i bujqësisë kontribuon në ndotjen e ajrit kryesisht përmes djegies së biomasës. Zonat ilegale për hedhjen e mbeturinave me djegie të pakontrolluara të mbeturinave paraqesin një burim serioz të ndotjes së ajrit. Në përgjithësi niveli i ulët i vetëdijësimit të ndërmarrësve, konsumatorëve dhe publikut të gjerë poashtu ndikojnë në situatën e tanishme.

Për arsye të mungesës së legjislacionit sa i përket emisionit të ndotësve, pajisjeve teknike adekuate dhe stafit të trajnuar, aktualisht nuk kryhen aktivitete të monitorimit të mirëfilltë[13]. Mungojnë të dhënat relevante për analiza të detajuara. Po ashtu edhe mbështetja e nevojshme administrative nuk është ngritur ende, kështu që anashkalimi i përgjithshme e çështjeve mjedisore ka krijuar një mori problemesh me të cilat ballafaqohet Kosova.

Cilësia e ajrit ambiental është i dëmtuar në zonat e zhvilluara urbane në Kosovë posaçërisht në Prishtinë. Ndikimi më i madh në mjedis shkaktohet nga termoelektranat A dhe B me kapacitet prej 1513 MW të instaluara, por ndotje shkaktohet poashtu edhe nga objektet individuale për ngrohje. Mitrovica me pasojat nga mbeturinat industriale të mbetura nga kompleksi i Trepçës, numërohet poashtu ndër burimet e mëdha të ndotjes njësoj sikur edhe fabrika e çimentos Sharcem në Han të Elezit (gjendet në zonën kufitare me Maqedoninë) edhe pse pas një studimi të ndikimeve në mjedis kjo fabrikë ndërmori disa masa për uljen e nivelit të ndotjes.

Në të shumtën e rasteve ndotja paraqitet në formë të emisioneve të dyoksidit të sulfurit (SO_2), okside të azoti (NO_x), ozon (O_3), plumb (Pb), dyoksid karboni (CO_2), pluhur, tym, grimca të patretshme dhe dioksine. Në thelb të analizave të ajrit[14] në vet kompleksin e

[13]Ekzistojnë të dhëna të pjesëshme monitoruese mbi ndotësit e mëdhenj të ajrit në Kosovë gjatë periudhës kohore 1986 - 1988

[14] Analizuar nga INKOS

termoelektranave (aty ku kryhen matje të emisionit të pluhurit) mund të konkludohet se emisioni i pluhurit tejkalon nivelin e lejuar disa herë më i lartë se niveli i lejuar.

Monitorimi i indikatorëve tjerë si totali i grimacave të suspenduara, metalet e rënda, H_2S, O_3, fenolët, kloratet, sulfatet si dhe karbonet aromatike policiklike poashtu nuk ekziston . Mirëpo edhe përkundër trendëve evidente negative në kualitetin e ajrit ambiental, është me rëndësi të theksohet se në Kosovë ende nuk ekziston monitorimi esencial dhe gjithëpërfshirës dhe si pasojë e kësaj edhe të dhënat nuk janë të plota dhe konsistenete për të mundur të marrim vendime në bazë të tyre. Përveç kësaj, nuk është bërë inventarizimi i ndotësve e poashtu edhe kadastra e ndotësve nuk është përpiluar për asnjë grup ndotësish. Kjo paraqet problem të madh gjatë vendosjes së limiteve nacionale dhe definimit të nivelit aktual të gazrave, të cilët shkaktojnë ndryshime klimatike dhe kjo mund të ketë ndikim të madh në të ardhmen në përdorimin e resurseve minerale dhe në sektorin e energjetikës.

Korniza ligjore

Përveç Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit është miratuar edhe Ligji për Mbrojtjen e Ajrit[15], i cili është hartuar në përputhshmëri me Direktiva të caktuara të BE[16]. Ligji i kategorizon burimet kryesore të ndotjes, vendos indikatorët dhe obligimet themelore për mbrojtjen e ajrit dhe rekomandon adoptimin e limiteve për shkarkim në ajër konform standardeve të BE dhe OBSH. Si pjesë e programit të përgjithshëm për mbrojtjen e mjedisit ligji inicion edhe përgatitjen e një Programi kombëtar për mbrojtjen e ajrit, në pajtim me të cilin, më pastaj do të hartoheshin edhe programet lokale për mbrojtjen e ajrit. Sipas ligjit programi për mbrojtjen e ajrit do të duhej organizuar nga MMPH.

Qyteteve dhe vendbanimeve tjera ku niveli i supozuar i ndotjes arrin nivelin III dhe II duhet kushtuar vëmendje të posaçme sa i përket mbrojtjes së kualitetit të ajrit edhe për nga numri edhe për nga metoda e monitorimit te indikatorëve kritik. Po ashtu edhe sa i përket kontrollimit më të mirë të burime statike dhe atyre lëvizëse në relacion me emisionet që ndotin ajrin.

Fatkeqësisht Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit i mungojnë pothuajse të gjitha aktet e nevojshme nënligjore, ku duhet theksuar domosdoshmërinë për të konsideruar obligimet që dalin nga një numër i direktivave për ajër. Këtyre aktiviteteve do të duhet dhënë prioritet.

Sa i përket strukturës organizative në nivel qendror, organi përgjegjës për kualitetin e ajrit është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor brenda së cilës funksionojnë Njësia për Mbrojtjen e Ajrit në kuadër të Departamentit të Mjedisit dhe Instituti Hidrometeorologjik në kuadër të AKMM.

Këto institucione kanë nevojë për ngritje të kuadrit, qoftë duke shtuar numrin e ekipit a si dhe aftësimin me me trajnime shtesë, posaçërisht te marrja e më shumë detyrimeve nga sistemi i drejtësisë i BE. Edhe pse ka një Udhëzim Administrativ për themelimin e Agjencisë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit[17], brenda së cilës do të themelohej një njësi teknike për mbrojtjen e ajrit (monitorim) kjo ende nuk është realizuar. Njëri ndër elementet më të rëndësishëm të politikave mjedisore në Kosovë për mbrojtjen e mjedisit është kompletimi dhe përputhshmëria e sistemit rregullativ me sistemin e BE, nënshkrimi si dhe ratifikimi i marrëveshjeve të ndryshme ndërkombëtare.

Duke pasur parasysh që transporti është burimi kryesor i lëvizshëm i ndotjes është me rëndësi tepër të madhe të zhvillohet një Plan që do të ofrojë hapa konkret për heqjen nga përdorimi benzinës me plumb, duke u bazuar në Direktivën 98/70/EC mbi kualitetin e benzinës dhe derivateve të naftës, si dhe në Vendimin e BE 2000/159/EC, dhe Direktivën

[15] 30/2004
[16] 96/62, 93/30, 93/76, VOC (Volatile Organic Components)
[17] Udhëzimi Adminstrativ

96/62/EC mbi kualitetin e ajrit. Kjo do të mund të zbatohej relativisht lehtë në Kosovë, ngase Kosova nuk posedon rafineri dhe do të duhej të merren vendime në lidhje me karburantet e importuara dhe të sigurojë mbikëqyrjen e respektimit të këtyre vendimeve.

Janë në hartim e sipër:

- Rregullorja mbi emisionet në ajër nga burimet e palëvizshme dhe të lëvizshme;
- Rregullorja mbi monitorimin e cilësisë së ajrit;
- Rregullorja mbi cilësinë e karburanteve;
- Rregullorja mbi testin ekologjik të automjeteve.

Në afat të shkurtër duhet të transponohen edhe direktiva tjera të rëndësishme dhe gradualisht të aplikohet IPPC- Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes.

Prioritizimi i problemeve

- Përpilimi i akteve nënligjore (fillimisht rregulloret e lartpërmendura) dhe transponimi i legjislacionit të rëndësishëm evropian në atë vendor;
- Përgatitja e kapaciteteve dhe institucioneve për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare forcimi i për t'i implementuar ato
- Funksionalizimi i Agjencisë Kosovarë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe organizimin e sistemit për infromim për ajrin.
- Ndërtimi i Kadastrit të shkarkimeve të ndotësve kryesor në ajër;
- Përgatitja e Programit Nacional për Mbrojtjen e Ajrit së bashku me planet lokale përkatëse;
- Sigurimi i pajisjeve për të përcjellur gjendjen dhe për të informuar, çka nënkupton themelimin e laboratorëve të përshtatshëm;
- Revitalizimi i pajisjeve dhe teknologjive industriale të vjetruara;
- Forcimi i kuadrit dhe forcimi potencial në ministri dhe industri;
- Sigurimi i pjesëmarrjes së grupeve tjera të interesuara gjatë përgatitjes dhenë procesin e implementimit të dokumenteve të rëndësishme strategjike dhe ligjore
- Ndërgjegjësimi i publikut dhe pjesëmarrësve tjerë (industria, bujqësia);
- Zbatimi i instrumenteve ekonomike.

Objektiva

O1 Të përmirësohet gradualisht cilësia e ajrit duke reduktuar emisionet e larta të ndotësve nga burimet relevante.

Masat

M1 Përshtatja e nënligjeve të nevojshme dhe harmonizimi me legjislacionin e BE;

M2 Përgatitja e Strategjisë kombëtare për mbrojtjen e ajrit dhe Planit të veprimit përkatës;

M3 Vendosja e sistemit të plotë për monitorim të ajrit;

M4 Ngritja e mekanizmave efektiv financiarë.

Objektiva	Aktivitetet		Niveli dhe akteret	Burimet potenciale për financim	Sektorët tjerë me te cilët ndërlidhet	Indikatorët e suksesit
O1	M1	Përgatitja, përshtatja dhe zbatimi i rregullave dhe procedurave për: Normat vendore për burimet stacionare dhe ato të lëvizshme Monitorimin e cilësisë së ajrit Cilësinë e karburanteve Eko-testin e automjeteve.	**Qendror** MMPH MTI MSH MTT **Lokal** KK Biznesi	BKK Investimet private Donacionet	Energjetika Industria Transporti Bujqësia Shëndetsia	Numri i rregulloreve të përshtatura
O1	M2 M3	Inventarizimi i substancave ndotëse Përpilimi i Kadastrit të ndotësve (M2, M3) dhe Vlerësimi ndotjes ndërkufitar.	**Qendror** MMPH MTI MSH MTT **Lokal** KK	BKK Donacione	Energjetika Industria Transporti Bujqësia Shëndetsia	Numri i ndotësve të identifikuar Kadastri i Ndotësve Plani për vlerësimin e ndotjes ndërkufitare të ajrit.
O1	M2	Ngritja e kapaciteteve për hartimin dhe zbatimin e Strategjisë për mbrojtjen e ajrit dhe Programeve lokale	**Qendror** Institucionet qendrore **Lokal** Bizneset	BKK Donacionet	Energjetika Industria Transporti Bujqësia Shëndetsia	Plani për trajnimin e resurseve njerëzore Niveli i përmbushjes së planit
O1	M2	Programi për uljen e përbërjes së Pb në karburante	**Qendror** MMPH MTI MTT	BKK	Transporti	Plani për uljen e përdorimit të benzinës me plumb
O1	M2	Përfshirja e komponentës se mbrojtjes se ajrit ne Strategjinë e Energjetikës, dhe strategjitë sektorale: transport, industri, bujqësi	**Qendror** MMPH MEM MTI MBPZHR	BKK	Energjetikë Transport, Industri, Bujqësi	Lista e veprimeve të nevojshme për zbatimin e strategjive sektoriale.
O1	M3	Themelimi dhe akreditimi i laboratoreve për cilësi të ajrit	**Qendror** MTI	BKK Donacionet Investimet private	Energjetika Industria Transporti Bujqësia Shëndetsia	Lista e laboratorëve të certifikuar
O1	M3	Zhvillimi i sistemit të monitorimit të ajrit përmes rrjetit në nivel vendi	**Qendror** MMPH MTI MBPZHR MSH MTI MTT	BKK	Energjetika Industria Transporti Bujqësia Shëndetsia	Studimi i arsyeshmërisë ekonomike (fizibiliteti)

O1	M4	Zbatimi i instrumentave ekonomike.	**Qendror** MMPH MEF **Lokal** Biznesi Konsumatori	BKK Investimet private	Ekonomia Tregti Industri	Numri i instrumenteve të aplikuara
O1	M4	Themelimi i Fondit për Mbrojtjen e Mjedisit	**Qendror** MMPH	BKK Instrument.ekonomike	Transporti Industria Ekonomia Energjetika	Ligji për themelimin e Fondit
O1	M1 M2	Zbatimi i legjislacionit horizontal VNM, VSM, dhe Cikli jetësor i produkteve	**Qendor** **Lokal** Biznesi	BKK Investimet private	Energjetika Industria Transporti Bujqësia Shëndetsia	Rregulloret mbi VNM dhe VSM

4.1.1 Ndryshimet klimatike

Situata e tanishme

Kosova ka nivel të ulët të zhvillimit ekonomik dhe bënë pjesë në grupin e vendeve në zhvillim. Duke pasur parasysh që në Kosovë resursi kryesor për energjetikë është thëngjilli pritet që me zhvillimin ekonomik do të ketë një ngritje të përgjithshme të shkarkimeve të "gazrave serë". Shumica e banorëve të Kosovës janë të varur nga bujqësia dhe duke pasur parasysh numrin e madh të deponive ilegale pritet që niveli i amoniakut, oksideve të azotit dhe metanit, do të jetë mjaft i lartë. Deri më tani në Kosovë nuk ekzistojnë të dhëna mbi emisionet e gazrave nga serat. Ka disa të dhëna të pamjaftueshme mbi ndryshimet klimatike dhe kontributin e tyre në ndikimin më të gjerë të ndryshimeve klimatike. Të dhënat e vetme që mund të japin një vlerësim të përafërt të ndryshimeve klimatike janë të viteve 1985-1989. Pas kësaj periudhe nuk ka rezultate të matjeve relevante.

Edhe pse Kosova nuk merr pjesë aktive në implementimin e Konventave Kornizë të BE mbi Ndryshimet Klimatike, është me rëndësi që në të ardhmen e afërt të vendoset një Pikë Fokale për çështjet e ndryshimeve klimatike dhe të themelohet organi përgjegjës për krijimin e politikave përkatëse që ndërlidhen me implementimin e kësaj konvente. Kosova duhet të fillojë përgatitjen e Planit të Veprimit për uljen e gazrave serrë. Kjo do të paraqesë një sfidë të madhe financiare për Kosovë. Protokolli i Kyotos mbetet një pyetje e hapur deri sa nuk arrihet statusi përfundimtar politik i Kosovës. Sidoqoftë, forcimi dhe organizimi i resurseve institucionale dhe teknike si dhe përshtatja e legjislacionit të nevojshëm duhet konsideruar si një ndër aktivitetet prioritare në periudhën vijuese.

Përveç kësaj, përdorimi i biomasës, burimeve të ripërtritëshme të energjisë dhe sjellja e teknologjive më të pastra janë vetëm disa nga masat që do të duhen zbatuar për reduktimin e emisioneve të GS në Kosovë. Përfundimisht kjo nuk do të jetë e mundur para se të vendosen statusi politik final dhe para se të vendoset rrjeti i plotë monitoruese dhe mbledhja e të dhënave të besueshme.

Prioritizimi i problemeve

- Kosova nuk është partner aktiv në protokollin e Kyotos - duhet sqaruar statusin ligjor së pari,
- Nuk janë vendosur organizimet institucionale dhe kuadri është i pamjaftueshëm,
- Mungesa e të dhënave,

- Nuk është përshtaturadoptuar legjislacioni,
- Nuk ekziston strategjia për uljen e emisionit të gazrave nga serrat,
- Efikasitet i ulët i energjisë dhe pajisje të vjetruara industriale,
- Komunikacion i ngarkuar rrugor dhe strukturë e vjetruar e automjeteve,
- Përdorim i ulët i burimeve alternative të energjisë.

Objektiva

O1 Vendosja e bazës ligjore, institucionale dhe teknike për përgatitjen e Strategjisë për reduktimin e emisioneve të gazrave serrë.

Masat

M1 Aprovimi i legjislacionit të nevojshëm konfrom protokollit Kyoto dhe standardeve të BE dhe zhvillimi i Strategjisë për reduktimin e emisioneve të gazrave serrë;

M2 Vendosja e një Pike Fokale kombëtare për ndryshimet klimatike;

M3 Përgatitja e Inventarit kombëtar të gazrave serrë dhe përcaktimi i një kuote referuese kombëtare.

Objektiva	Aktivitetet		Niveli dhe akteret	Burimet potenciale për financim	Sektorët tjerë me te cilët ndërlidhet	Indikatorët e suksesit
O1	M1 M2	Plani i komunikimit për qasje në Konventën Kornizë të Ndryshimeve Klimatike	**Qendror** MMPH MEM MSH MTI	BKK	Energjetika Industria Transporti Bujqësia Shëndetsia Pylltaria	Realizmi i Planit
O1	M1	Hartimi i inventarit dhe bilancit sipas Kyoto Protokolit	**Qendror** **Lokal** Biznesi	BKK Donacione Investime private	Energjetika Industria Transporti Bujqësia Shëndetsia	Bilanci i pergatitur dhe Inventari
O1	M2	Hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për problemin e ndryshimeve klimatike në Kosovë	**Qendror** MMPH MBPZHR MTT MTI MEM MSH	BKK	Energjetika Industria Transporti Bujqësia Shëndetsia	Përgatitja e planit për bashkëpunim Zbatimi i planit për bashkëpunim

4.1.2 Acidifikimi dhe eutrifikimi

Gjendja e tanishme

Aktivitetet njerëzore më të rëndësishme që shkaktojnë acidifikimin dhe eutrifikimin në mjedis dhe paraqitjen e ozonit tokësor janë djegia e karburanteve fosile dhe aktivitetet bujqësore që shkaktojnë lirimin e dyoksidit të sulfurit (SO_2), oksidit të azotit (NO_x), volatile organic compounds (VOC) dhe amoniakut (NH_3). Depozitimi i thatë dhe i lagësht i gazrave acidike shkakton acidifikimin e dheut dhe ujërave. Efektet e tyre negative janë shumë të

dukshme në pyje dhe ekosistemet akustike, por janë mjaft të konsiderueshme edhe në ndërtesa dhe monumente kulturore.

Në të kaluarën por edhe tani, këtij problemi në Kosovë nuk i është kushtuar vëmendje. Kjo do të thotë se niveli i koncentrimit të SO_2, NO_x dhe depozitimi i lagësht nuk janë monitoruar. Pritet që pas funksionalizimit të plotë të objekteve industriale dhe atyre për gjenerimin e energjisë, ndikimet në mjedis do të shumëfishohen dhe kjo do të kërkojë aktivitete konkrete dhe të organizuara mirë për zgjidhjen e problemit.

Në të ardhmen do të duhet të jemi pjesë e Programit Evropian për Monitorim [European Monitoring and Evaluation Program (EMEP)] duke vendosur disa stacione monitoruese në Kosovë, me qëllim të mbledhjes të të dhënave të besueshme mbi substancat acidifikese dhe eutrifikuese. Do të ishte me shumë rëndësi sikur paralelisht me rrjetin nacionale për monitorim të vendosej një rrjet për monitorimin e ozonit tokësor.

Objektiva

O1 Definimi i statusit të protokolleve dhe konventave ekzistuese, vendosja e bazës ligjore, institucionale dhe teknike për përgatitjen e Strategjisë për eliminimin gradual të gazrave acidike dhe ozonit tokësor

Masat

M1 Miratimi i legjislacionit të nevojshëm në të gjithë sektorët relevant (transport, bujqësi, industri, etj)

M2 Themelimi i rrjetit për monitorimin e gazrave acidik dhe ozonit tokësor

Objektiva	Aktivitetet		Niveli dhe akteret	Burimet potenciale për financim	Sektorët tjerë me te cilët ndërlidhet	Indikatorët e suksesit
O1	M1	Plani i veprimit për nënshkrimin dhe ratifikimin e Konventave	**Qendror** Qeveria	BKK Donacione	Energjetika Industria Transporti Bujqësia Shëndetsia	Përgatitet plani i veprimit
O1	M2	Hartimi i Kadastrit të emisioneve të gazrave acidike	**Qendror** **Lokal** Biznesi	BKK Donacione	Energjetika Industria Transporti Bujqësia Shëndetsia	Përgatitet Kadastri
O1	M2	Vlerësimi dhe hartografimi i rrjetit me pikat me ngarkesa kritike në Kosovë	**Qendror** MMPH	BKK Donacione	Energjetika Industria Transporti Bujqësia Shëndetsia	Kryhen llogaritjet dhe paraqiten në hartë.
O1	M2	Përgatitja e Raportit për Qendrën Evropiane për Raportim (EMEP)	**Qendror** MMPH Enti Statistikor i Kosovës	BKK	Energjetika Industria Transporti Bujqësia Shëndetsia	Raporti i rregullt në institucione ndërkombtare

O1	M2	Instalimi i një pilot stacioni monitorues në Prishtinë për matjen e nivelit tokësor të ozonit	**Qendror** MMPH **Lokal** KK	BKK Donacione	Energjetika Industria Transporti Bujqësia Shëndetsia	Pilot stacioni monitorues në Prishtinë.
O1	M2	Përdorimi i praktikave të mira bujqësore për eliminimin e emisioneve të amoniakut dhe metanit nga fermat e blegtorisë	**Qendror** **Lokal** Sektori privat	BKK Donacione Investimet private	Bujqësia Mbeturinat Shëndetsia	Lista e masave për reduktimin e metanit dhe amoniakut në bujqësi Sillen masat relevante

4.1.3 Mbrojtja e shtresës së ozonit

Gjendja e tanishme

Ekonomia e Kosovës nuk prodhon asnjë nga elementet e përmendura në shtesat A, B, C dhe E të Protokollit të Montrealit[18] për mbrojtjen e shtresës së ozonit, por ka qenë importues i prodhimeve që përmbajnë disa nga kemikaliet e përmendura (kryesisht materie ftohëse dhe pajisje të përdorura për nevoja shtëpiake dhe komerciale). Importuesi më i madh i këtyre kemikalieve është sektori i prodhimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve ftohëse. Në vijim nuk ka të dhëna mbi pajisjet apo llojet e freoneve të përdorura.

Objektiva

O1 Eliminimi gradual i substancave që shkaktojnë varfërimin e ozonit (Ozone Depleting Substances ODS)

Masat

M1 Kontrolli i përhershëm dhe monitorimi i shfrytëzimit, importit dhe eksportit të substancave që e varfërojnë ozonin (ODS) të evidentuara në shtesat e Protokollit të Montrealit, Stokholmit dhe Roterdamit

M2 Përpilimi i Kadastrit të pajisjeve dhe kimikateve qe shkaktojne varfërimin e ozonit

Objektiva	**Aktivitetet**		**Niveli dhe akteret**	**Burimet potenciale për financim**	**Sektorët tjerë me te cilët ndërlidhet**	**Indikatorët e suksesit**
O1	M1	Themelimi i një institucioni përgjegjës për kontrollimin dhe monitorimin e ODS	**Qendror** MMPH MTI MTPT **Lokal** Biznesi	BKK Donacione	Energjetika Industria Transporti Bujqësia Shëndetsia	Themelohet institucioni përgjegjës

[18]Kosova nuk është nënshkruese e drejtpërdrejtë i asnjë Konvente apo Protokoli për mbrojtjen e ozonit. Gjatë kohës kur Kosova ka qenë pjesë e RFSJ, ajo ka ratifikuar Konventën e Vjenës dhe Protokolin e Montrealit, por nuk ka nënshkruar ndryshimet e këtij protokolli (London, Kopenhagen, Montreal dhe Beijing)

O1	M2	Sistemi i monitorimi dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore	**Qendror** MMPH MTI MTPT MBPZHR MEM **Lokal**	BKK Donacione Investime private	Energjetika Industria Transporti Bujqësia Shëndetsia	Sistemi i monitorimit Kuadri i përgatitur
O1	M2	Vendosja e pilotpikave për mbledhje dhe riciklim të paisjeve që shkaktojne varfërimin e ozonit	**Qendror** **Lokal** Biznesi privat	BKK Donacione Investimet private	Energjetika Industria Transporti Bujqësia Shëndetsia	Numri i pilotpikave të ngritura të krijuara

4.2 MENAXHIMI I UJËRAVE

Uji është faktorë esencial për jetë, kulturë, prodhim, energji të ripërtritshme, por njëkohësisht në raste të jashtzakonshme është edhe kërcënim i madh për jetën dhe hapësirën jetësore. Ujërat nuk njohin kufij dhe përmes qarkullimit të vet natyror janë në dispozicion tonin të vazhdueshëm. Mirëpo ujërat nuk janë një resurs pakufi dhe për këtë kërkon mbrojtje të veçantë.

Gjendja e tanishme

Resurset ujore

Kosova ka rezerva të kufizuara ujore që në të ardhmen do të jenë një faktor kufizues për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit. Kosova ndahet në 4 pellgje lumore: Drini i Bardhë, Ibri, Morava e Binçës, dhe Lepeneci[19]. Mesatarja vjetore e të reshurave në Kosovë variron prej 658 mm (në pellgun e lumit Sitnica) deri 1515 mm (në pellgun e lumit Erenik) me koeficienti të rrjedhës prej 4.92 l/sec/km^2 (Morava e Binçës) deri 42.46 l/sec/km^2 (lumi Lumbardhë në Deçan). Nga territori i Kosovës në vitin me lagështi mesatare rrjedhin përafërsisht 3.8 x 10 ^{9} ujë përkatësisht 121.2 m^3 /sec.

Karakteristikë kryesore hidrologjike në Kosovë është shpërndarja jo e barabartë dhe jo adekuate e resurseve ujore në krahasim me nevojat. Shpërndarja jo e barabartë dhe rexhimi jo i volitshëm hidrologjik reflektohet me mungesa të mëdha të ujit për të gjitha qëllimet, sidomos gjatë muajve të verës. Potenciali për energji ujore në Kosovë është shumë i vogël dhe deri më tani shfrytëzimi i saj është mjaft modest duke arritur vetëm 48 MË.

Rezervat e ujërave nëntokësor janë të kufizuara dhe gjenden kryesisht në pjesën perëndimore të Kosovës, ku edhe rezervat e ujërave sipërfaqësor janë më të mëdha në krahasim me pjesën lindore me rezerva të pakta dhe pjesën jug-lindore ku nevojat për ujë janë shumë të mëdha.

Kosova ka numër të vogël të liqejve natyror. Liqe artificial janë Batllava, Gazivoda, Radoniqi, Përlepnica dhe Badovci si dhe një numër i liqeve të vegjël për ujitje. Kushtet topografike për ndërtimin e rezervuarve artificial për mbledhjen e ujit nuk janë të përshtatshme. Për këtë arsye kërkohen ndërtime mjaft të shtrenjta.

Kosova ka burime të rëndësishme të ujërave termale të cilat shfrytëzohen për qëllime shërimi dhe rekreative. Zyrtarisht ekzistojnë vetëm tri qendra shëruese: Banja e Pejës, e Kllokotit dhe e Banjës (në veri të Mitrovicës). Megjithatë ekzistojnë edhe burime tjera të cilat

[19] Raporti mbi gjendjen e mjedisit në Kosovë 2003

nuk shfrytëzohen dhe nuk janë hulumtuar. Në të ardhmen ato duhet të hulumtohen dhe t'ju kushtohet më shumë vëmendje. Duke shfrytëzuar potencialin e ujërave termal mund të krijohen mundësi për zhvillimin e turizmit rekreativ.

Kosova ka resurse të kufizuara ujore me përafërsisht 1600m³/ujë për kokë banori. Për këtë arsye mbrojtja, ruajtja dhe zhvillimi i resurseve ujore është shumë i rëndësishëm dhe një ndër sfidat më të mëdha mjedisore.

Monitorimi i cilësisë dhe sasisë së ujërave

Ujërat sipërfaqësor dhe nëntokësor nuk janë të mbrojtur nga ndotja dhe nuk respektohen zonat e përcaktuara sanitare. Kualiteti i ujit të patrajtuar për furnizim të popullatës dallon prej rajoni në rajon. Përmbajtja e ujërave sipërfaqësore varet edhe nga përbërja minerale e tokës nëpër të cilën rrjedh si dhe nga struktura e akuiferëve. Rreth 56% të popullsisë shfrytëzon burime të patrajtuara të ujit. Ky është një problem serioz duke pasur parasysh se nuk respektohen standardet për zona sanitare. Pra, është e nevojshme të përpilohet rregullorja dhe aktet tjerë për përcaktimin e zonave sanitare. Poashtu nuk kryhet monitorim i rregullt i kualitetit dhe kuantitetit të ujërave. Është prioritet absolut të themelohen mekanizmat për monitorim me qëllim të sigurimit të të dhënave të sakta mbi kualitetin dhe kuantitetin e ujërave në Kosovë.

Furnizimi me ujë

Vetëm 44 - 50% e popullsisë së Kosovës kanë qasje në sistemet e furnizimit me ujë, të cilat menaxhohen nga 32 ndërmarrje komunale (tani të koordinuara në 7 kompani rajonale)[20], duke përdorur nga 50-100 litra ujë në ditë për kokë banori, ku harxhimi vjetor arrin deri në 75-80 milion m³ apo 15% të harxhimit të përgjithshëm. Niveli i furnizimit me ujë nuk është i njëjtë në gjithë territorin e Kosovës. Qytetet kryesisht janë të lidhura në rrjetë furnizimi përderisa në vendet rurale qasja në rrjetë të furnizimit është vetëm 9%. Për arsye të mungesës së infrastrukturës dhe burimeve me ujë edhe rrjeti ekzistuese ka kapacitet të kufizuar. Përfundimisht gjendja e tanishme e furnizimit me ujë nuk përmbush nevojat e popullsisë dhe se problemet me furnizim janë shumë serioze.

Industria furnizohet vetëm pjesërisht nga ujësjellësit publik, ngase pjesa dërmuese e industrisë furnizohet nga liqenet akumuluese. Për nevoja të industrisë (për procese teknologjike prodhuese, ftohje dhe nevoja sanitare, etj.) llogaritet se në vit shpenzohen rreth 150 milion m³, çka paraqet 30% të shpenzimit të përgjithshëm. Mund të përfundohet se për arsye të zvogëlimit të prodhimtarisë industriale është ulur edhe nevoja për ujë në industri, trend ky i cili zvoglon edhe ndotjen e ujërave nga industria.

Gjendja e furnizimit aktual me ujë të pijshëm, kontaminimi i ujit dhe mbrojtja e ujit nga aktivitetet e dëmshme në Kosovë nuk është e mirë. Problemet janë të shumta, si:

- Numër i vogël i shërbimeve për furnizim me ujëra, posaçërisht në zonat rurale (vetëm 50% e popullsisë kanë qasje në ujësjellës);
- Nivel i ngadalshëm i ndërtimit dhe lidhjes me sistemin e kanalizimit (28-30% e popullatës ka qasje në sistem kanalizimi);
- Mungesa e infrastrukturës për pastrimin e ujërave të ndotura;
- Mbrojtje e dobët nga aktivitetet e dëmshme të ujërave;
- Shkallë e ulët e mirëmbajtjes së infrastrukturës ujore;

[20] Burimi AKM - menaxhon ndërmarrjet publike

- Sistemi shpërndarës për furnizim me ujë dhe për kanalizim është i amortizuar;
- Mungesa e sistemit monitorues;
- Mungesa e planit për mbrojtjen e rezervave ujore;
- Ndarja e përgjegjësive nuk është në përputhje me rexhimin ujor;
- Mungesa e strategjisë dhe mjeteve materiale për mirëmbajtjen e infrastrukturës ujore etj.

Ndotja e ujërave

Ujërat e ndotura rurale dhe urbane

Sa i përket cilësisë të ujërave të ndotura urbane nuk ka monitorim të ujërave të shkarkuara nga sistemet e kanalizimit komunal. Menaxhimi i sistemeve të kanalizimit është përgjegjësi e ndërmarrjeve publike. Rreth 28-30% të vendbanimeve urbane janë të lidhura në një sistem qendror për ujëra të ndotura, edhe pse në Kosovë praktikisht nuk ekzistojnë impiante për trajtimin e ujërave të ndotura.. Rindërtimet dhe ndërtimet urbane e rëndojnë edhe më shumë sistemin i cili edhe ashtu nuk është adekuat. Vetëfinancimi nuk është i mundur dhe kthimi i kostos është nën 15%[21]. Kapaciteti menaxhues profesional është i ulët në të gjitha fushat. Problem tjetër i madh është infiltrimi i madh i ujërave të ndotura. Kanalet e hapura kulluese bllokohen nga toka e mbeturinat dhe paraqesin rrezik për të shkaktuar vërshime dhe rreziqe tjera për mjedisin.

Në vitin 2004 MMPH në bashkëpunim me KEIM Water nga Finlanda, ka hartuar draft Strategjinë për trajtimin e ujrave të zeza. Nuk dihen hapat pas saj si dhe efektet.

Industria

Ujërat e ndotur industrial janë një ndër ndotësit kryesor të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Nevojat e industrisë për ujë janë 150 milion m³ që përafërt rreth 30% të shpenzimit të përgjithshëm. Ndotësit më të mëdhenj janë KEK, minierat e Trepçës, Artanës dhe minierat tjera.

Në Kosovë ka fare pak mekanizma për trajtim të ujërave të ndotur industrial (në Parkun Industrial të Mitrovicës). Furnizimi me energji elektrike në Kosovë kryhet kryesisht nga termoelektranat, të cilat përdorin linjit. Dy termoelektrana me kapacitet prej 1513 MW përdorin ujë për ftohje.

Sa i përket prodhimit të energjisë ekzistojnë hidrocentrale të vogla si Kozhnjer në Bistricën e Deçanit, me fuçi 6.4 MW dhe në Gazivodë me 2x17 MW, i cili bënë pjesë në hidrosistemin e Ibrit. Në krahasim me energjinë e përgjithshme nga termoelektranat energjia e fituar nga hidrocentralet arrin vetëm 5% të sasisë së përgjithshme.

Bujqësia

Para luftës, në Kosovë ujiteshin 70.000 ha tokë punuese. Gjysma është ujitur me spërkatje ndërsa gjysma tjetër në mënyrë tradicionale. Menjëherë pas luftës ky numër pësoi një rënie të madhe dhe llogaritet që ujiten vetëm 23 000 ha, për shkak të dëmeve që kanë pësuar sistemet për ujitje dhe mirëmbajtjes së dobët. Gjatë vitit 2002 në Kosovë ka qenë e mundur të ujiten 50.925 ha, çka paraqet një përmirësim të gjendjes menjëherë pas luftës, dhe kjo është arritur me investime zhvillimore nga jashtë.

[21] Kosova: rindertimi 2000

Për ujitje shfrytëzohen 270 milion m³ që paraqet 55% të harxhimit të përgjithshëm në Kosovë. Ekzistojnë hidrosisteme të ndërtuara në vitet e 80-ta (Ibër-Lepenci), i cili ka qenë dedikuar për ujitje të sipërfaqeve bujqësore. Ky projekt nuk është përfunduar plotësisht dhe nuk është mirëmbajtur, ashtu që edhe funksionimi i tij është i kufizuar.Po ashtu edhe sistemi i Radoniqit ka kapacitete për ujitje.

Mbrojtja nga veprimet e dëmshme të ujërave

Mbrojtja nga përmbytjet dhe rregullimi i regjimit ujorë kërkojnë qasje serioze afatgjate. Në bazë të vlerësimeve të kryera (Master Plani i vitit 1983) për përmbytjet me rastisje një herë në 100-vjetë si dhe në bazë të zhvillimit, i cili ka qenë në kohën e përllogaritur, mund të konstatohet se dëmet nga vërshimet do të ishin: në pellgun e Drinit të Bardhë 50%, ate të Ibrit 24%, Lepencit 20% dhe Moravës së Binqës 6%. Sipas vrojtimeve të deritanishme gjatësia e lumenjve të Kosovës, të cilët janë të rrezikuar nga vërshimet sillet rreth 491km, kurse deri më tani janë rregulluar vetëm 140 km, përkatësisht 28% nga gjatësia e përgjithshme e paraparë për rregullim.

Ndër problemet kryesore që shpie deri te vërshimet janë:

- Dëmtimi i shtretërve të lumenjëve nga eksploatimi pa kriter i rërës dhe zhavorrit;
- Ndërtimi i shtëpive, rrugëve dhe urave në vende që janë të rrezikuara nga vërshimet;
- Hedhja e mbeturinave në lumenjë;
- Prerja e pyjeve në afërsi të zonave vërshuese;
- Mirëmbajtja e dobët e objekteve mbrojtëse;
- Mungesa e mjeteve financiare për ndërtimin e objekteve mbrojtëse të reja, etj.

Korniza ligjore

Ligji i Ujërave (2004/24) është miratuar, më 14.10.2004 dhe nënshkruar nga PSSP. Duhet të hartohen dhe miratohen edhe 20 akte nënligjore që dalin nga Ligji për ujra.

Me ligjin për Ujëra të Kosovës janë paraparë që të formohen 2(dy) autoritete të pellgjeve : Autoriteti i Pellgut lumor për Drinin e Bardhë dhe Autoriteti i Pellgut për lumenjtë Ibër, Moravë e Binqës dhe Lepenc. Për këtë qëllim Departamenti i Ujërave ka formuar Grupin punues për hartimin e aktit nënligjorë për formimin e Autoriteteve të Pellgjeve. Drafti i parë i këtij akti është përfunduar dhe është lëshuar në diskutim publik.

Ligji për Ujëra të Kosovës në nenin 22 (Plani Strategjik për Ujëra) dhe neni 23 (Plani për administrimin e ujërave) obligon që të hartohen Strategjia dhe Plani i veprimit për ujëra si dhe ka nxjerrë draftin e parë të aktit nënligjor për hartimin e Planit për Administrimin e Resurseve Ujore.

Prioritizimi i problemeve

- Kapacitete të pamjaftueshme (infrastrukturë e shkatërruar dhe humbje të mëdha të ujit) të ujësjellësit në qytete dhe mungesa e këtij sistemi në zonat rurale;
- Mungesa e monitorimit të mirëfilltë të cilësisë dhe sasisë të ujërave;
- Mungesa e akteve kyçe nënligjore dhe strategjisë për menaxhim gjithëpërfshirës të ujërave;

- Uji i përdorur në sistemet energjetike shkarkohet sërish në rrjedhat ujore pa asnjë trajtim paraprak;
- Nuk është përpiluar Kadastra e ndotësve të ujërave;
- Mungesa e rrjetit të kanalizimit dhe objekteve për trajtim të ujërave të ndotura komunale dhe industriale;
- Të dhënat e pamjaftueshme mbi shpenzimin e ujit nga shfrytëzuesit shtëpiak, industritë dhe bujqësia;
- Mungesa e mekanizmave për mbrojtje nga vërshimet;
- Gropat septike në zonat rurale nuk përmbushin standardet e duhura;
- Nuk respektohen zonat për mbrojtje sanitare;
- Nivel i ulët i pagesës për ujin e shfrytëzuar;
- Mungon Këshilli Kombëtar për Ujra;
- Aftësi të dobëta menaxhuese dhe numër i kufizuar i resurseve njerëzore të involvuara.

Objektiva

O1 Të sigurohen kushtet ligjore, teknike, financiare dhe kapacitet njerëzore për vendosjen e bazës për politika të menaxhimit të integruar të ujërave në Kosovë duke u bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm

Masat

M1 Rehabilitimi dhe ndërtimi i infrastrukturës (rrjeti për furnizim me ujë dhe kanalizim, impiante për trajtimin e ujërave të ndotura) me qëllim të mbrojtjes së mjedisit dhe përmbushjes së nevojave të popullsisë .

M2 Miratimi i akteve nënligjore të nevojshme në pajtim me Direktivat e BE

M3 Ngritja e institucioneve institucional

Objektiva	**Aktivitetet**		**Niveli dhe akteret**	**Burimet potenciale për financim**	**Sektorët tjerë me te cilët ndërlidhet**	**Indikatorët e suksesit**
O1	M3	Themelimi i Këshillit Kombëtar për Ujëra	**Qendror** Kuvendi i Kosovës **Lokal**	BKK	Bujqësi Indstri Energjetikë Mbeturinat Shëndetësi	Vendimi i Kuvendit për Themelim
O1	M1	Zhvillimi i Strategjisë Kombëtare për Ujëra dhe Planit të Veprimit	**Qendror** Kuvendi i Kosovës MMPH MBPZHR MTI MEM MEF MSH	BKK Donacione	Bujqësi Industri Energjetikë Shëndet Mbeturinat	Miratimi i Strategjisë në Kuvendin e Kosovës

O1	M3	Ngritja e kapaciteteve të stafit në Ministri dhe institucione tjera relevante	**Qendror** **Lokal** ARPL NP/P	BKK Donacione Investimet	Bujqësi Industri Energjetikë Shëndet	Numri i trajnimeve, numri i pjesmarrsve
O1	M1 M2 M3	Zhvillimi i Strategjisë për Monitorim dhe vendosja e rrjetit monitorues	**Qendror** NP/P	BKK Donacione Investimet private	Bujqësi Industri Energjetikë Shëndet Pylltari Mbeturinat	Është përgatitur Strategjia Është vendosur rrjeti monitorues
O1	M1	Të përpilohet Kadastri i Ujrave dhe Kadastri ndotësve të ujërave	**Qendror** **Lokal**	BKK Donacionet	Bujqësi Industri Energjetikë Shëndet Mbeturina	Kadastri i Ujrave Kadastri i ndotësve të ujrave
O1	M2	Harmonizimi i rregulloreve me normat dhe standardet e BE.	**Qendror** MMPH	BKK Donacione	Bujqësi Industri Energjetikë Shëndet Pylltari Mbeturina	Rregulloret e harmonizuara dhe të miratuara
O1	M1 M2	Plani i Veprimit për ndërtimin e impianteve për trajtim të ujërave ne zonat urbane me më shumë se 10.000 banorë	**Qendror** MMPH MEF Oda Ekonomike	BKK Donacione Investime	Bujqësi Industri Energjetike Shendetesi Mbeturina Planifikimi hapësinor	Studimet e përgatitura
O1	M1 M2 M3	Krijimi i instrumenteve ekonomike për reduktimin e ndotjes së ujërave	**Qendror** MMPH MEF Dogana	BKK	Ekonomi Industri Tregti	Janë definiuar dhe zbatohen instrumentet ekonomike
O1	M3	Ngritja e kapaciteteve njerëzore të shërbimit të inspekcionit	**Qendror** MMPH **Lokal** KK	BKK Donacione	Bujqësi Industri Energjetike Shendetesi	Trajnimi i stafit të inspektoriatit sipas planit të BERCEN-it

4.3 MENAXHIMI I TOKAVE

Ndikimet e vazhdueshme nga aktivitetet njerëzore sjellin deri te degradimi i sipërfaqeve tokësore duke shkaktuar edhe pasoja socio-ekonomike. Sfida është që të parandalohet degradimi i tokave nëpërmes masave dhe politikave specifike për mbrojtjen e tokave.

Gjendja aktuale

Sipërfaqja e Kosovës është rreth 1.1 milion ha, 53% e të cilës është tokë e punueshme, ndërsa 47% është e mbuluar me pyje. Prej 585 000 ha të tokës së punueshme, në 51% të saj kultivohet gruri, 45% janë livadhe dhe kullosa, 2% pemishte dhe më pak se 1% vreshta. Mbi 88% të tokës pyjore është pronë private. Afër 35% të pyjeve janë poashtu pronë private ndërsa pjesa e mbetur është në pronësi shoqërore. Mesatarisht një familje i takojnë 3 ha tokë.

Kosova karakterizohet me një llojllojshmëri të tokave duke u bazuar në gjenezën e krijimit të tyre dhe karakteristikave pedologjike, fizike dhe kimike. Sipërfaqja tokësore e Kosovës është e përshtatshme për prodhimtari bujqësore. Llojet e tokave që më së shpeshti i hasim në Kosovë janë: humusore, toka aluviale dhe deluviale, toka shkëmbore etj.

Presionet mjedisore

Faktorët kryesor që dëmtojnë cilësinë e tokave në Kosovë janë:

- Vendbanimet (ndërtime të paplanifikuara);
- Industria (mbeturinat industriale, mihjet sipërfaqësore);
- Minat e mbetura nga lufta e fundit në Kosovë;
- Mbeturinat shtëpiake dhe deponitë;
- Erozioni;
- Eksploatimi i pakontrolluar i zhavorrit;
- Përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve.

Korniza ligjore

Aktualisht korniza ligjore për tokat rregullohet përmes disa ligjeve si:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (2003/9)
- Ligji për Tokat Bujqësore
- Ligji i Planifikimit Hapësinor (2003/30)
- Ligji i Ndërtimit (2004/15)
- Ligji i Pyjeve të Kosovës (2003/6, 2004/9)
- Ligji për Miniera (UNMIK/REG/2005/3)
- Ligji për Mbeturinat (aprovuar në Kuvendin e Kosovës).

Disa nga aktet nënligjore që dalin nga ligjet e miratuara janë nxjerrë, ndërsa disa tjera janë në procedurë. Projektligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje është në procedim

Prioritizimi i problemeve

- Mungesa e inventarit të tokave;
- Industria – mbeturinat industriale[22] dhe mihjet e hapura (deponitë e mëdha të hirit);
- Zonat e degraduara;
- Përdorimi i plehrave artifciale dhe pesticideve[23];
- Mungesa e standardeve për vlerat e lejuara të ndotësve;
- Ndërtimi i paplanifikuar;
- Erozioni nga eksploatimet e ndryshme;
- Mungesa e monitorimit të tokave;

[22]Tokat mund të dëmtohet në tri zona: zonën e eksploatimit, zonën e shtresës së jashtme, dhe atë ku ruhen mbeturinat industriale.

[23]Nëse thirremi në të dhënat e vitit 2002 shihet se 79.825 kg. pesticide janë sjellë në Kosovë (raport i Ministrisë për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Prishtinë 2002). Pesticidet për të luftuar faktorët e dëmshëm biologjik, përdoren në këta sektorë: bujqësi 88%, pylltari 3.4%, blegtori dhe veterinari 3.3%, higjienë komunale 2.9% dhe industri ushqimore 1.6%. për një hektar përdoren rreth 6.5 kg

- Mungesa e bashkëveprimit ndërsektorial

Objektiva

O1 Të krijohen politikat për mbrojtjen e tokave.

Masat

M1 Parandalimi i degradimit të mëtutjeshëm të tokave dhe rehabilitimi i pikave të nxehta;

M2 Miratimi i procedurave për menaxhim të qëndrueshëm të tokave.

Objektiva	Aktivitetet		Niveli dhe akteret	Burimet potenciale për financim	Sektorët tjerë me te cilët ndërlidhet	Indikatorët e suksesit
O1	M1	Përgatitja e planit për rehabilitim të pikave të nxehta mjedisore	**Qendror** MMPH MBPZHR MEM MTI **Lokal** KK	BKK Donacione	Pylltaria Bujqësia Industria Energjetika	Plani për rehabilitim i përgatitur
O1	M2	Inventarizim i tokave dhe paraqitja në hartë	**Qendror** MMPH MBPZHR MEM UP **Lokal**	BKK Donacione	Pylltaria Bujqësia Industria Energjetika	Inventari dhe hartografimi i tokave.
O1	M1 M2	Monitorimi i tokave dhe zhvillimi i sistemit informativ	**Qendror** MMPH MBPZHR **Lokal** KK	BKK Donacione	Bujqësi Pylltaria Industri	Sistemi i monitorimit dhe informimit
O1	M2	Kontrollimi i përdorimit të kimikateve të rrezikshme për të parandaluar kontaminimin e tokave	**Qendror** MMPH MEM MBPZHR MTI	BKK Donacion	Industria Energjetika	Sistemi për kontrollimin e përdorimit të kimikateve
		Përforcimi i veprimtarisë së inspekcionit mjedisor	**Qendror** MMPH Gjykatat **Lokal** KK	BKK	Bujqësia Pylltaria Industria Energjetika	Numri i rasteve të proceduara për ndotjen e tokës
O1	M1 M2	Hartimi i një Kadastre të re për toka	**Qendror** MMPH MBPZHR MSHP Enti i Statistikës Agjencioni Kadastral AKM Universiteti **Lokal** KK	BKK Donacion	Bujqësia Pylltaria Industria Energjetika Planifkimi hapësinor	adastra e përpiluar

4.4 BIODIVERSITETI DHE TRASHËGIMIA NATYRORE

Mbrojtja dhe konservimi i natyrës dhe llojeve të ndryshme të gjallesave, gjatë këtyre 20 viteve të fundit, është bërë bazë e çdo politike mjedisore. Pothuajse të gjitha shoqëritë filluan të pranojnë që mbrojtja e natyrës është një kategori zhvillimore esenciale për njerëzimin.

Gjendja e tanishme

Sipas studimeve që janë bërë në Kosovë, janë identifikuar rreth 1800 lloje të florës. Supozohet që ky numër është më i madh dhe arrin deri në 2500 lloje. Florën dhe faunën[24] e Kosovës e bëjnë të rëndësishme dhe atraktive një numër i madh i llojeve endemike, relikte dhe subendemike. Zonat më të pasura me florë dhe faunë janë Malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna[25]. Mirëpo, edhe më tutje Kosova nuk ka një inventar të plotë të biodiversitetit.

Mbrojtja e natyrës përmes zonave të mbrojtura është një instrument mjaft i rëndësishëm për ruajtjen e biodiversitetit. Deri më tani një sipërfaqe prej rreth 46247 ha (4.27% e tërë territorit të Kosovës) është e mbrojtur me ligj. Nga zonat e sipërpërmendura një është park kombëtar, 11 janë rezervate natyrore, 37 monumente natyrore dhe 2 janë peizazhe të mbrojtura. Synimi kryesor mbetet mbrojtja dhe zgjerimi i rrjetit ekzistuese të zonave të mbrojtura. Me shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna park kombëtar dhe vënien e sipërfaqeve të reja nën mbrojtjen e ligjit, sipërfaqja e tërësishme e zonave të mbrojtura do të përfshinte deri 10% të territorit të plotë të Kosovës.

Meqenëse mbrojtja e natyrës shumë shpesh kuptohet në koncept të kufizuar duke u bazuar në parimet e ndalesave, dhe jo duke u bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, është e vështirë të arrihet një mirëkuptim me banorët vendas për të shpallur zonat ku ata jetojnë si zona të mbrojtura. Për këtë prioritet kryesor mbetet afirmimi i planeve bashkëkohore për menaxhimin e zonave të mbrojtura.

Sa i përket biodiversitetit bujqësor, ende nuk është kryer inventarizimi dhe mund të supozohet se intensifikimi i përdorimit të gjenotipeve produktive dhe moderne për prodhimtari intensive ka s rrezikuar zhdukjen e disa llojeve dhe varieteteve autoktone.

Korniza ligjore

Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës në mars të vitit 2005. Gjatë përgatitjes së ligjit janë marrë parasysh dy Direktiva të BE dhe dokumentat tjera ndërkombtare.

Për zgjidhjen e problemeve në menaxhimin e zonave të mbrojtura si dhe problemeve tjera të përgjithshme që ndërlidhen me biodiversitetin, ekziston edhe legjislacion tjetër relevant[26], por sikur edhe në sektorët tjerë problemi qëndron në zbatimin e ligjit, ku në të shumtën e rasteve

[24] Vegjetacioni i Kosovës klasifikohet në 139 asociacione, 63 alianca, 35 rradhë dhe 20 klasë. Kosovo ka rreth 230 specie të vertebrateve të egra, përderisa speciet invertebrate nuk janë studiuar sa duhet. Ka rreth 150 lloje fluturash dhe rreth 400 lloje të makrobentosit të ujërave të ëmbla.

[25] Vlerësohet se ka: 8 lloje të ndryshme të peshkut, 13 ujtokësor, 12 lloje zvarranikësh, 154 lloje shpendësh, 37 lloje gjitarësh dhe 147 lloje të fluturave ditore.

[26] Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (2003/9), Ligji i Pylltarisë (2003/6, 2004/40), Ligji i Parkut Nacional 'Malet e Sharrit' , Ligji për Shpalljen e zonave të mbrojtura natyrore/kulturore, Ligji i Pesticideve (2003/35), Ligji për Gjyeti dhe rregullimin e mbrojtjes së disa llojeve të florës dhe faunës, vendimi i MMPH , 23 Maj 2003 për mbrojtjen e llojeve të rralla dhe të rrezikuara të gjitarëve në Kosovë, dhe vendimi për ti mbrojtur me ligj disa lloje të rralla të cilat shfaqen në dy apo më shumë komuna (nr 236/86).

mungojnë aktet nënligjore, nuk ekziston struktura e përshtatshme organizative dhe resurset e kualifikuara si dhe mungesa e kushtet e përshtatshme teknike.

Duke pasur parasysh rëndësinë e mbrojtjes së biodiversitet është e domosdoshme hartimi i Strategjisë dhe Planit Veprimit për Mbrojtjen e Diversitetit Biologjik në Kosovë. Sa i përket konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për mbrojtjen e biodiversitetit[27], që duhet të jenë një temë me prioritet të lartë për Qeverinë e Kosovës, është me rëndësi të fillohet me fazën parapërgatitore pavarësisht nga statusi i tanishëm politik i Kosovës. Statusi final politik nuk duhet të jetë pengesë për zhvillimin e aktiviteteve përgatitore dhe forcimin e kapacitetit administrative në fushëveprimin e MMPH.

Eshtë e nevojshme të hartohetProjektligji për Parqet Kombëtare. Për më tepër, në mbështetje të Ligjii për Mbrojtjen e Natyrës duhet të ndryshohen dhe përmisohen edhe vendimet mbi zonat e mbrojtura dhe të përshtaten edhe nënligjet tjera përkrahëse (rregulloret dhe udhëzimet).

Mbrojtja e llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës *in situ* është e rregulluar në atë mënyrë që zona speciale janë emëruar rezervate të mbrojtura të llojeve të caktuara të florës dhe faunës (shtatë rezervate bimësh dhe dy rezervate shtazësh). Aktualisht nuk ka ndonjë organizim për menaxhimin e tyre e as plane për mirëmbajtje dhe zhvillim. Deri më tani nuk janë vendos praktika institucionale për mbrojtjen e llojeve *ex situ*.

Prioritizimi i problemeve

Në Kosovë mund të dallohen këto lloj probleme për biodiversitetin dhe trashëgimin natyrore:

- Mungesa e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për mbrojtjen e biodiversitetit dhe trashëgimisë natyrore;
- Mungesa e praktikave bashkëkohore për menaxhimin e zonave të mbrojtura;
- Organizim institucional relativisht i dobët dhe mungesa e resurseve njerëzore të kualifikuara;
- Mungesa e rregulloreve dhe paraqitjes hartografike të zonave të mbrojtura;
- Mungesa e Listës së Kuqe të florës dhe faunës;
- Mosinkorporimi i ruajtjes se bidiversitetit në sektorët tjerë relevant (bujqësia, pylltaria, transporti);
- Mungesa e sistemit të monitorimit dhe krijimi i sistemit të inspektimit;
- Mungesa e inventarit dhe hartografimit të llojeve, habitatet dhe ekosistemeve;
- Mungesa e bashkëpunimit mes vendeve fqinje në mbrojtjen e zonave të mbrojtura ndërkufitare;
- Prerja ilegale e pyjeve, gjuetia dhe peshkimi;
- Tejeksploatimi i zhavorrit dhe ekosistemeve ujore;
- Ndërtimtaria ilegale posaçërisht shfrytëzimi i tokës bujqësore të klasës të lartë kadastral për aktivitete jo produktive;
- Niveli i lartë i ndotjes industriale dhe nga transporti;

[27]Konventa mbi Diversitetin Biologjik (CBD), Konventa Ramsar për Tokat a Lagështa, Konventa mbi Tregëtin Ndërkombëtare me Llojet e Rrezikuara [Convention on International Trade in Endangered Species (CITES)], Konventa mbi Trashëgiminë Botërore dhe Konventa mbi Llojet Migruese [Convention on Migratory Species (CMS)]

- Mbështetja e dobët dhe jo efikase institucionale;
- Mungesa e instrumenteve ekonomike dhe niveli i ulet i ndërgjegjes publike.

Objektiva

O1 Të krijohet një sistem më efikas ligjor dhe institucional për ruajtjen e biodiversitetit, dhe trashëgimisë natyrore, dhe futja nën mbrojte e 10% të territorit të Kosovës.

Masat

M1 Përshtatja e akteve nënligjore, Staregjisë dhe Planit të Veprimit për mbrojtjen e natyrës, si dhe parapërgatitjet për nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare;

M2 Bashkëpunimi ndërsektorial për të siguruar përfshirjen e çështjeve të biodiversitetit dhe trashëgimisë natyrore në të gjithë sektorët relevant;

M3 Ngritja e kapaciteteve të institucioneve të involvuara në ruajtjen biodiversitetit dhe trashëgimisë natyrore.

Objektiva	**Aktivitetet**		**Niveli dhe akteret**	**Burimet potenciale për financim**	**Sektorët tjerë me te cilët ndërlidhet**	**Indikatorët e suksesit**
O1	M1	Përgatitja e akteve nënligjore që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Natyrës	**Qendror** MMPH MBPZHR **Lokal** KK	BKK	Bujqësia Transporti Pylltaria	Numri i akteve nënligjore të përshtatura a
O1	M1	Themelimi i një Zyre Koordinuese për marrëveshjet ndërkombtare	**Qendror** MMPH	BKK	Ajri Toka Uji Biodiversiteti Industria Transporti	Themelimi i Zyrës Koordinuese
O1	M1	Përgatitja e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit.	**Qendror** MMPH MKRS MBPZHR MTT MTI MEF	BKK Donacioni	Ajri Toka Uji Biodiversiteti Industria Transporti	Strategjia e përgatitur dhe e përshtatur
O1	M2	Inventarizimi dhe digjitalizimi i zonave të mbrojtura	**Qendror** MMPH **Lokal** KK	BKK Donacione	Ajri Toka Uji Biodiversiteti Industria Transporti	Inventari i zonave të mbrojtura
O1	M2	Inventarizimi i llojeve dhe ekosistemeve	**Qendror** MMPH	BKK Donacione	Ajri Toka Uji Biodiversiteti Industria Transporti	Inventari i llojeve dhe ekosistemeve

O1	M1 M2	Hartimi i Planit të aktiviteteve monitoruese dhe inspektuese	**Qendror** MMPH **Lokal** KK	BKK Donacione	Ajri Toka Uji Biodiversiteti Industria Transporti	Plani për monitorim dhe numri i aktiviteteve inspektuese
O1	M1 M2	Vendosja e sistemit për kontroll të tregtisë me lloje të florës dhe faunës	**Qendror** MMPH MBPZHR Doganat	BKK	Bujqësia	Lista e llojeve të ndaluara për tregëti
O1	M2	Shpallja e Bjeshkëve të Nemuna Park Kombëtar	**Qendror** MMPH MBPZHR MTI **Lokal** KK	BKK	Toka Uji Biodiversiteti Transporti Bujqësia Pylltaria	Ligji për Bjeshkët e Nemuna
O1	M2	Përpilimi i Listës së Kuqe të florës dhe faunës	**Qendror** MMPH MBPZHR UP	BKK Donacione	Uji Bujqësia Pylltaria	Lista e Kuqe e miratuar
O1	M2 M3	Përgatitja e Planeve për menaxhimin e zonave të mbrojtura	**Qendror** MMPH MBPZHR MTI MTT **Lokal** KK	BKK Donacione	Toka Uji Biodiversiteti Transporti Bujqësia Pyllatria	Miratimi i Planeve menaxhuese për zona
O1	M2 M3	Projekte ndërkufitare në mbrojtjen e natyrës	**Qendror** MMPH **Lokal** KK	BKK Donacione	Toka Uji Transporti Pylltaria Bujqësia	Projektet ndërkufitare të propozuara dhe të zbatuara
O1	M1 M2 M3	Të zhvillohen programet lokale për mbrojtjen e natyrës në pajtim me Strategjinë kombëtare	**Qendror** MMPH **Lokal** KK	BKK Doancione	Toka Uji Transporti Pylltaria Bujqësia	Numri i programeve të përshtatuara nga komunat
O1	M1 M2 M3	Projekte për ngritjen e vetëdijes së popullatës për mbrojtjen e natyrës	**Qendror** MMPH	BKK Donacione	Edukimi Ajri Toka Uji Industria Transporti Bujqësia Pylltaria	Projektet e pergatitura dhe fushatat e zhvilluara
O1	M3	Ngritja e kapaciteteve njerzore për ruajtjen e biodiversitetit dhe trashëgimisë natyrore	**Qendror** MMPH MKRS MASHT **Lokal** KK	BKK Donacione	Toka Uji Transporti Pylltaria Bujqësia	Numri i trajnimeve Numri i stafit të trajnuar

4.5 MENAXHIMI I MBETURINAVE

Gjenerimi i mbeturinave paraqet një ndër shqetësimet më të mëdha për mjedisin dhe një barrë të madhe ekonomike për shoqërinë. Vet gjenerimi i mbeturinave nënkupton edhe humbjen e resurseve (p.sh. materialet dhe energjinë). Pas gjenerimit mbeturinat duhet të mblidhen, trajtohen dhe mënjanohen dhe ky proces sërish involvon përdorim të resurseve dhe paraqet një

rrezik potencial për ndotje. Për këtë arsye puna me mbeturina ngërthen një mori problemesh mjedisore duke përfshirë këtu shfrytëzimin e resurseve natyrore, konsumimin e energjisë, gjenerimin e gazrave që ndikojnë në klimë si dhe kontaminimin e ujërave, tokave dhe ajrit. Për këtë arsye, shoqëria jonë menaxhimin e mbeturinave duhet ta vendos ndër prioritetet e saj duke e mbështetur edhe në aspektin financiar.ekonomikisht.

Situata e tanishme

Sistemi i tanishëm i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë nuk evidenton në mënyrë të strukturuar dhe të mirëfilltë të dhëna mbi gjenerimin, mbledhjen, trajtimin, rikoperimin apo mënjanimin e mbeturinave.

Edhe pse përafërsisht 90% e popullatës urbane mbulohet me mbledhjen e mbeturinave, kjo është e një standardi mjaft të ulët për arsye të mungesës së pajisjeve dhe vendeve të dedikuara për hedhje. Zonat rurale mbulohen me më pak se 10%. Tarifa për mbeturina është 3€/shtëpi dhe pagesa e faturave është shumë e ulët (30-40 %).

Sasia mesatare e gjenerimit të mbeturinave në Kosovë është rreth 2 kg/kokë banori në ditë[28]. Nga të dhënat e raportit, në Kosovë gjenerohen këto lloje dhe sasira të mbeturinave:

Llojet e mbeturinave	**Mesatarja ditore/kg/banorë**	**Sasia vjetore/ kg/banorë**	**Sasia vjetore në tonelata**
Mbeturinat e amvisërisë	0.277	101	232541
Mbeturinat komerciale	0.250	91.25	209875
Mbeturinat medicinale	0.0024	0.876	2014.5
Mbeturinat e hirit dhe ngjyrës	0.907	331	761426.5
Mbeturinat e ndërtimit/shkatërrimit	0.200	73	167900
Mbeturina të tjera (ambalazh, plastikë, gomë, pesticide, elektronikë, dru etj.)	0.360	131.4	302220
Totali	2.0	729	1675977

Struktura e llojeve te mbeturinave te gjeneruara ne përqindje gjate vitit 2004 ne Kosove pasqyrohet ne grafikonin vijues:

Grafikoni 1: Llojet e mbeturinave në %



Nga 29 deponi komunale, 26 janë rehabilituar. Aktualisht Agjencia Evropiane për Rindërtim (AER) dhe donatorë tjerë kanë mbështetur rindërtimin apo ndërtimin e 9 deponive sanitare në Kosovë. Prej tyre 5 janë rajonale kurse të tjerat komunale (një deponi e re ne Prishtinë është para përfundimit, Prizren (funksionon që nga Tetori 2004), Gjilani, Dragashi, Kaçanik, Podujeva, Zveçan (hapur në 2003), Peja (funksionon nga 2001), dhe Fushë Kosovë. Është

[28] Raporti për Gjendjen e Mbeturinave në Kosovë 2003/2004 MMPH

me rëndësi të përmendet se këto 9 deponi do tu shërbejnë rreth 2 000.000 banorëve të Kosovës. Deponitë janë ndërtuar sipas standardeve minimale të BE për deponi.

Deponitë të cilat është planifikuar të mbyllen por ende janë në përdorim janë: deponitë e vjetra në Prishtinë, Lypjan, Gllogoc, Gjakovë, Burim dhe Leposaviq.

Deponitë të cilat aktualisht nuk janë duke u përdorur dhe në të cilat mendohet të investohet për t'i mbyllur janë: Besjana, Skenderaj, Dragashi, Rahoveci, Prizreni, Gjilani, Dardana, Ferizaj dhe Vitija.

Elementet vijuese karakterizojnë lokacionet kryesore të deponimit në Kosovë:

- Klasifikimi dhe riciklimi i mbeturinave është në fazat fillestare me disa pika të vogla ricikluese të mbeturinave të ndryshme (plastikë, letër, mbetje organike etj.).
- Sipërfaqja ku hedhen mbeturinat është 413 ha prej të cilave 130 ha janë të ndara për mbeturina komunale dhe 283 ha për mbeturina industriale
- Kapaciteti i plotë i përbashkët është 14 mil m^3
- Mesatarisht 5-10 % të kapacitetit shfrytëzohet për mbeturina komunale ndërsa pjesë më e madhe prej 90 % për mbeturina industriale
- Sipërfaqja e plotë e deponive komunale që janë të gatshme të rehabilitohen apo mbyllen në periudhën e ardhme është përafërsisht 15.000 m^2

Në Kosovë nuk kryhet klasifikimi i përshtatshëm i mbeturinave, e as riciklimi apo trajtimi, edhe pse në qytetin e Prishtinës ka pasur disa projekte të vogla për ndarjen e mbeturinave[29]. MMPH ne bashkëpunim me AKM, NP, KK është duke tentuar qe përmes Kompanive të ndryshme teë huaja të fillon klasifikimin e plastikës dhe ambalazheve për riciklim.

Në Kosovë problemet më të theksuara rrjedhin nga mbeturinat e rrezikshme. Mungon sistemi i organizuar për mbledhjen e vajrave të përdorura, baterive dhe akumulatorëve, gomave të automjeteve, automjetet e papërdorshme, mbeturinat bujqësore (bimore dhe shtazore), medicinale, medikamenteve të skaduara, pesticide etj.

Çështjet që i përkasin mbeturinave të rrezikshme lidhen me kapacitetin e industrive të cilat janë të shënuara si 'pika të nxehta mjedisore' (environmental hot spots)[30]. Nuk ekzistojnë të dhëna relevante për gjenerimin e mbeturinave të rrezikshme**.** Menaxhimi i medikamenteve me afat të skaduar, mbeturinave spitalore dhe kimikateve nga industritë shihet si një problem me prioritet. Për këtë arsye, aktualisht Ministria e Mjedisit është duke ndërmarrë disa vlerësime paraprake për përcaktimin e një lokacioni të përshtatshëm për ndërtimin e një deponie (venddeponimi-) për mbeturina të rrezikshme.

Korniza ligjore

Ligji për Mbeturina është miratuar nga Kuvendi i Kosovës (22 Korrik 2005) dhe tani pritet nënshkrimi nga PSSP. Ky ligj është përgatitur në pajtim me Direktivat e BE dhe përvojat e shteteve fqinje.

Divizioni për Menaxhimin e Mbeturinave në Ministrinë e Mjedisit, si përgjegjës për përgatitjen e legjislacionit themelor, është në fazën e përgatitjes së akteve nënligjore. Të gjitha aktet do të jenë në pajtim me legjislacionin ekzistues të BE.[31]

[29]Pilot projekt për ndarjen e mbeturinave në Prishtinë (REC 2003)
[30] Fabrika e Trepça, KEK, dhe fabrika e baterive në Gjilan
[31]99/31/EC, 75/442/EEC plus ndryshimet

Dokumenti më i rëndësishëm që duhet të miratohet dhe zbatohet është Plani Strategjik për Menaxhimin e Mbeturinave, ku do të përcaktohen orientimet kryesore për menaxhim të mbeturinave si dhe do të vlerësohen nevojat afatgjata në nivel lokal dhe kombëtar.

Organi përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të mbeturinave komunale është AKM (Agjencia Kosovare e Mirëbesimit). AKM koordinon ndihmat e donatoreve dhe vepron në ndërtimin dhe menaxhimin e deponive. Gjithashtu AKM liçencon dhe mbikëqyr kompanitë për Shërbime Publike. Në Kosovë ka 7 Kompani rajonale për shërbime publike që operojnë në 7 rajonet e Kosovës.

Zyra Rregullative për Ujëra dhe Mbeturina është i involvuar në aspektet ekonomike dhe operacionale të menaxhimit të mbeturinave (rregulloret dhe tarifat).

Prioritizimi i problemeve

Edhe pse janë arritur suksese në ndërtimin dhe rehabilitimin e deponive, sektori i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë ende nuk i përmbush standardet themelore dhe mund të përshkruhet si në gjendje kritike.

Problemet mjedisore rezultojnë kryesisht nga karakteristikat vijuese:

- Menaxhim jo i qëndrueshëm dhe zhvillim i ulët ekonomik çka karakterizohet me përqindje të lartë të varfërisë;
- Mungesa e Planit Strategjik për Menaxhimin e Mbeturinave, së bashku me aktet tjera nënligjore (p.sh. udhëzime për llojet e veçanta të mbeturinave);
- Mungesa e rregulloreve për mbeturina industriale, komunale dhe lloje tjera të veçanta;
- Mungesa e sistemeve moderne për punën me mbeturina;
- Hedhja dhe deponimi ilegal i mbeturinave;
- Mungesa e programeve për parandalimin e gjenerimit të mbeturinave;
- Numër i pamjaftueshëm i kuadrit në Ministri e sidomos në nivele lokale;
- Mungesa e industrive ricikluese të çertifikuara;
- Mungesa e aplikimit të aktiviteteve 'redukto-ripërdor-riciklo';
- Një përqindje relativisht e vogël e popullatës në Kosovë është përfshirë në rrjetin e mbledhjes së mbeturinave;
- Niveli i ulët i inkasimit nga kompanitë për shërbimet e ofruara;
- Mungesa e vetëdijes sa i përket rëndësisë së problemit të mbeturinave dhe përfitimeve që sjell një sistem i mirë i menaxhimit të mbeturinave;
- Mungesa e strategjisë së përkohshme apo afatgjatë për mbeturina të rrezikshme si dhe mbeturinave jonizuese dhe jo-jonizuese.

Objektiva

O1 Të zhvillohet një sistem i qëndrueshëm financiar për menaxhimin e mjedisit dhe mbeturinave i cili do të shërbejë nevojave të tanishme dhe të ardhëshme të qytetarëve dhe të ekonomisë së vendit.

Masat

M1 Miratimi i dokumentave politike për menaxhimin e mbeturinave;

M2 Miratimi i nënligjeve të nevojshme dhe harmonizimi i plotë i tyre me legjislacionin e BE

M3 Formimi i instrumenteve të shëndosha ekonomike;

M4 Forcimi institucional per menaxhimin e mbeturinave në nivel qendror dhe lokal.

Objektiva	Aktivitetet		Niveli dhe akteret	Burimet potenciale për financim	Sektorët tjerë me te cilët ndërlidhet	Indikatorët e suksesit
O1	M1 M2	Hartimi i Planit Strategjik për menaxhimin e mbeturinave	**Qendror** MMPH MTI MBPZHR MSH MEM	BKK Donacione	Industri Bujqësi Transport Energjetika Minierat Shëndetsi	Plani Startegjik i miratuar
O1	M1	Hartimi i planeve lokale për menaxhimin e mbeturinave	**Qendror** MMPH **Lokal** Komunat	BKK Donacione	Industri Bujqësi Transport Energjetika Minierat Shëndetsi	Planet lokale të miratuara
O1	M2	Aprovimi i 18 rregulloreve për lloje të ndryshme të mbeturinave dhe zbatimi i legjislacionit egzistues	**Qendror** MMPH MTT MTI MBPZHR MSH Doganat	BKK Donacione	Industri Bujqësi Transport Energjetika Minierat Shëndetsi	Rregulloret e miratuara
O1	M1 M2 M3	Avansimi i sistemit për mbledhjen e mbeturinave komunale	**Qendror** MMPH AKM MSHP **Lokal** NP	BKK Donacione Investime private	Industri Bujqësi Transport Energjetika Minierat Shëndetsi	Zgjerimi i sistemit të mledhjes së mbeturinave
O1	M1 M3	Pilot projekte si: - mbledhja e mbeturinave-vajrave - ndarja e mbeturinave të llojeve të veçanta (letër/karton, plastikë/PET - kompostim (mbeturinat komunale) -rikuperimi	**Qendror** MMPH AKM **Lokal** KK NP/P	BKK Donacione Investime private	Industri Bujqësi Transport Energjetika Minierat Shëndets	Numri i pilot projekteve te realizuara
O1	M3	Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës të nevojshme për menaxhimin e mbeturinave	**Qendror** MMPH AKM **Lokal** KK NP/P	BKK Donacione Investime private	Industri Bujqësi Transport Energjetika Minierat Shëndetsi	Plani për ndërtimin dhe përmirësimi e infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave
O1	M3 M4	Ndërtimi i infrastrukturës për menaxhim të mbeturinave të rrezikshme:	**Qendror** MMPH MBPZHR MSHP MSH	BKK Donacione	Industri Bujqësi Transport Energjetika Minierat	Infrastruktura e ndërtuar

		-vendgrumbullimet Qendrat grumbulluese	MEM		Shëndetsi	
O1	M3 M4	Sanimi i gjendjes në 'pikat e nxehta' ekzistuese	**Qendror** MMPH MEM KEK Trepça	BKK Donacione Investime private	Industri Energjetika Minierat	Numri i pikave të nxehta të sanuara
O1	M4	Ngritja e kapaciteteve njerëzore në menaxhimin e mbeturinave posaqërisht inspeksionit	**Qendror** MMPH AKMM AKM **Lokal** KK NP/P	BKK Donacione Investime private	Industri Bujqësi Energjetika Minierat Shëndetsi	Numri i tajnimeve të realizuara Numri i personave të trajnuar
O1	M4	Zhvillimi i Sistemit të Informimit për menaxhim të mbeturinave	**Qendror** MMPH MTI MTT MSH MEM **Lokal** KK NP/P	BKK Donacione	Industri Bujqësi Transport Energjetika Minierat Shëndetsi	Sistemi i informimit për mbeturina funksional
O1	M3 M4	Rehabilitimi i deponive të vjetra dhe ilegale	**Qendror** MMPH **Lokal** KK NP/P	BKK Donacione	Industri Bujqësi Transport Minierat Shëndetsi	Numri i deponive të rehabilituara

4.6 SHËNDETI DHE MJEDISI

Numri i problemeve shëndetësore, që vijnë si pasojë e ekspozimit ndaj mjedisit, është gjithnjë në rritje, posaçërisht te fëmijët. Më herët, ka qenë e mundur të vendoset një lidhje e saktë mes disa efekteve në shëndet dhe faktorëve mjedisor. Mirëpo edhe sot e kësaj dite mungon një pasqyrë e përgjithshme e ndikimeve në shëndet që rezultojnë nga ekspozimet komplekse jetësore. Ndërlidhja mes shëndetit dhe mjedisit duket të jetë shumë më e ndërlikuar se që mendohet zakonisht.

Gjendja e tanishme

Regjistrimi i fundit i plotë i popullsisë në Kosovë është bërë më 1981. Në një Evropë që po mplaket për nga mesatarja e moshës, Kosova bën një përjashtim. Popullsia e Kosovës është e re ku më se një e treta i takojnë grup moshës më të ulët se 15 vjeç, dhe rreth gjysma nën moshën 25 vjeçe. Mesatarja e moshës është 22 deri 23 vjeç.

Treguesi më i mirë i nivelit të shëndetit publik të çdo vendi është numri i vdekjeve të foshnjave të porsalindura. Niveli më i lartë i konfirmuar në Kosovë është 18,9 duke qenë kështu më i larti në Evropë. Arsyeja e 63% të vdekjeve të porsalindurve janë sëmundjet infektive. Në të gjitha komunat sëmundjet më të shpeshta janë sëmundjete rrugëve të

frymëmarrjes, barkëqitja, infektimet e zorrëve dhe zgjeba[32]. Në një raport të UNDP (2002) paraqitet një shifër tjetër për shkallën e mortalitetit të porsalindurve, dhe kjo arrin deri në 34 – 35 në 1000 të lindur gjallë[33] është shumë më e lartë se shifra prej 18 ‰ Mesatarja e pritur e jetesës është 68.8 vjet (67.8 meshkuj dhe 69.9 për femra).

Zhvillimi human është një koncept mbi të cilin duhet bazuar të gjitha reformat e mirëfillta dhe strategjitë zhvillimore në Kosovë. Kosova posedon Indeksin e Zhvillimit Human (IzhH) prej 0.734 duke qëndruar kështu në nivelin e ulët të mesatares së rankut të IzhH për spektrin e zhvillimit human, prej 101. Më se 47% e popullsisë jeton në varfëri, përderisa 13% jetojnë në varfëri të skajshme.

Rreziqet shëndetësore dhe mjedisi

Uji i pijshëm

Vetëm 44-50 % e popullsisë në Kosovë kanë qasje në sisteme të furnizimit me ujë. Popullsia rurale mbulohet me rreth 9 %. Ekzistojnë katër hidrosisteme rajonale të cilat u shërbejnë 900.000 njerëzve.

Këto sisteme përdorin ujin nga liqejt artificial dhe burimet nëntokësore. Po ashtu ka një numër sistemesh të vogla në formë të burimeve të kaptuara dhe bunarëve që shërbejnë për furnizimin e 150,000 njerëzve. Mungesa e klorit që shërben për dezinfektimin e ujit[34] dhe fakti që disa burime të ujit të pijshëm nuk janë të mbrojtura si duhet paraqet edhe një problem. Instituti Kombëtar për Shëndet Publik (IKSHP) rregullisht ndërmerr aktivitetet me qëllim të vendosjes së një kontrolli të shtuar mbi këto burime dhe sigurimin e ujit të shëndosh për popullatën që furnizohet nga këto burime.[35]

Ujërat e zeza

Kosova nuk ka impiante për trajtimin e ujërave të ndotura dhe vetëm 24-30 % e banorëve të zonave urbane kanë qasje në sistem të kanalizimit. Nuk ka ndonjë studim të kryer mbi numrin dhe kushtet e gropave septike në vendet rurale.

Mbeturinat

Problemet me menaxhimin e mbeturinave[36], përcjellen me problemet që ndërlidhen me deponitë ilegale që kanë potencial të lartë për të shkaktuar probleme të mëdha shëndetësore.

Ndotja e ajrit

Burimet industriale të ndotjes[37] në Kosovë paraqesin rrezik të madh shëndetësor si pasojë e ndotjes mjedisore të shkaktuar nga shkarkimet e plumbit, kadmiumit, zinkut, bakrit dhe substancave tjera toksike në ajër. Monitorimi i organizuar dhe i vazhdueshëm nuk kryhet. Një studim i kryer në vitin 2000 mbi nivelin e plumbit në gjak te punëtorët e shkritores dhe te banorët e Mitrovicës dhe vendeve përreth, indikon nivel shumë të lartë të Pb në gjak

[32] Infeksionet e traktit respirator (674.9 raste/javë),barkëqitje (645.8 raste/javë.),infeksione të zorrëve (104 raste/javë) zgjeba (206 raste/javë) Rastet hulumtohen në 1000 individ.

[33] Fleta me të Dhëna mbi Popullsinë Botërore, Zyra për Referenca të Popullsisë (2002).

[34]Rreziqet shëndetësore që lidhen me kontaminimin e ujërave përfshijnë sëmundjet bakteriologjike posaçërisht barkëqitja

[35] UNMIK /JIAS IA 2/99 mbi testimin dhe implementimin e standardëve minimale për ujë të pijshëm në Kosovë

[36] Kapitulli i menaxhimit të mbeturinave

[37] Kryesisht lokacionet në, ose afër Mitrovicës dhe në rajonin e Obiliqit – Prishtinë

posaçërisht te punëtorët dhe fëmijët. Në vijim, dihen edhe të dhëna tjera[38]. Komunikacioni i dendur paraqet edhe një burim serioz të ndotjes. Për shembull, në qytetin e Prishtinës ka probleme të dukshme me pluhurin. Në qytetet tjera ndotja me pluhur është më pak evidente.

Ndikimi i zhurmës

Përveç ndotjes së ajrit, komunikacioni dhe industria në Kosovë shkaktojnë edhe zhurmë të madhe. Nuk janë vendosur ende standardet shëndetësore për zhurmën.

Shëndeti në punë

Aktualisht në Kosovë në disa mjedise mungojnë shërbimet e mirëfillta shëndetësore në punë. Nuk ka zbatim apo inspektim të sigurisë dhe mbrojtjes shëndetsore në punë (Ligji për Inspektoratin Shëndetësor është në përgatitje e sipër, dhe aktet tjera ligjore që rregullojenë këtë sferë). Qasja preventive nuk është zbatuar deri më tani dhe nuk kryhet regjistrimi i pacienteve përveç në Qendrën mjeksore të e KEK-ut, në Obiliq dhe Gjakovë.

Siguria ushqimore

Është në themelim Agjencia e Kosovës për Kontrollin e Produkteve Ushqimore e cila do t'i unifikon dhe koordinon çështjet lidhur me kontrollin e cilësisë së ushqimit. Tani këto funksione realizohen përmes IKSHP , Institutit të Bujqësisë dhe atij të Veterinës.

Korniza ligjore

Korniza ligjore për shëndetin publik përfshin:

- Ligji për Inspektoratin Sanitar (2003/39)
- Ligji i Shëndetësisë së Kosovës (2004/31)
- Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit (2004/42)
- Ligji i Inspektoratit Shëndetësor – në procedurë parlamentare.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHP) është institucion referent në nivelin e Kosovës për monitorimin e kualitetit të ujit të pijshëm.[39]

Prioritetizimi i problemeve

- Mungon Plani i Veprimit për Shëndetësi;
- Mungon sistemi për informim shëndetësor;

[38] Raporti i OBSH në 1988 indikon që në Obiliq tejkalohet niveli i pranueshëm i koncentrimit të Pb (MAC= 0.7mcg/m³) mes 62 dhe 87% asokohe. Në Janar - Maj 1989 koncentrimi i Pb në ajër ndryshonte prej muajit në muaj mes shifrave 5.7 deri 26 mcg/m³. Mostrimet mjedisore të marra në Mitrovicë dhe fshatet përreth nga KFOR francez, në Nëntor 1999 dhe Qershor 2000, tregojën një ngritje të dukshme të koncentrimit të PB në atmosferë. Mostrat e ajrit tregojnë nivele të koncentrimit të Pb mbi ata të pranueshme në (2 mcg/m³). Nivele të larta të Pb u zbuluan edhe në tokat e Mitrovicës (57-720 mg/Kg krahasuar me 20 mg/Kg niveli i pranueshëm për rritjen e shumicës së drithërave) Koncentrimi i plumbit në spinaqin e kultivuar në Mitrovicë ishte 20 deri 30 herë më i lartë se ai i pranueshmi përderisa në patate 30 herë (marr nga UNMIK 'Raporti mbi Mjedisin dhe Shëndetin' Janar 2003)

[39] UNMIK /JIAS IA 2/99 mbi testimin dhe implementimin e standardeve minimale për ujë të pijshëm në Kosovë

- Nuk është vendosur sistemi vëzhgues në shëndetësi (përveç për sëmundjet infektive);
- Mangësitë e regjistrit të sëmundjeve jo ngjitëse dhe sëmundjeve profesionale;
- Numër i lartë i sëmundjeve ngjitëse;
- Cilësia e dobët e ujit të pijshëm;
- Ndotje e ajrit (Obiliq, Mitrovica, Prishtina, Hani i Elezit);
- Niveli i lartë i zhurmës;
- Mungesa e kontrollit të sigurisë së ushqimit;
- Nivel i ulët i vetëdijes dhe edukimit veçanërisht në pjesët rurale.

Objektiva

O1 Të identifikohen dhe reduktohen për 20% dhe parandalohen sëmundjet dhe kërcënimet shëndetësore që dalin si pasojë e faktorëve mjedisor mbrenda 5 vjetëve.

Masat

M1 Zhvillimi dhe implementimi i PKVM në sferën e shëndetit;

M2 Zhvillimi i një sistemi për parandalimin, kontrollin dhe vlerësimin e rreziqeve shëndetësore në pajtim me rekomandimet e OBSH dhe rregulloret e BE.

Objektiva	Aktivitetet		Niveli dhe akteret	Burimet potenciale për financim	Sektorët tjerë me të cilët ndërlidhet	Indikatorët e suksesit
O1	M1 M2	Funksionalizimi i sistemit për menaxhimin e sigurtë të mbeturinave mjekësore	**Qendror** MSH MMPH	BKK Donacione	Mbeturina Rezatimi Ajri Toka Uji	Numri i krematoriumeve Niveli i ndotjes afër krematoriumeve
O1	M1 M2	Sjellja e procedurave të reja për kontrollin e sigurisë së ushqimit dhe vlerave kufitare	**Qendror** MSH **Lokal**	BKK Donacione	Mbeturina Rezatimi Ajri Toka Uji Bujqësia	Përputhja me indikatorët e BE
O1	M1 M2	Funksionalizimi i procedurave të reja për sigurinë e ujit të pijshëm	**Qendror** MSH MMPH MEF MASHT AKM **Lokal** KK	BKK Donacione Investime private	Ajri Uji Toka Bujqësia Rrezatimi Vetëdijësim	Gjatësia e ujësjellsit; Numri i banorve ekuivalent të kyqur
O1	M1 M2	Funksionalizimi i procedurave për sigurinë në vend pune	**Qendror** MSH MPMQ MTI MASHT AKM Sektori privat	BKK Investime private	Bujqësia Ekonomi Industria Transporti	Morbiditeti Traumatizmi Absentizmi

O1	M1	Ngritja e kapaciteteve për profesionistët e rinj në fushën e shëndetit publik	**Qendror** MSH/ IKSHP MMPH	BKK Donacion	Ajri Uji Toka Rrrezatimi	Numri i trajnimeve Numri i stafit të përfshirë
O1	M1	Themelimi i sistemit për informim shëndetësor	**Qendror** MSH MMPH	BKK Donacion	Mbeturina Rezatimi Ajri Toka Uji	Publikimet Web faqja Numri i emisioneve në media
O1	M1	Modernizimi i pajisjeve monitoruese të IKSHPK	**Qendror** MSH MMPH	BKK Donacion	Mbeturina Rezatimi Ajri Toka Uji	Lista e nevojave Janë përtërirë pajisjet e ISHP
O1	M1	Forcimi i rolit të inspeksionit	**Qendror** MSH MMPH MBPZHR MTT MPMQ Doganat	BKK	Mbeturina Rezatimi Ajri Toka Uji Pylltaria	Aktivitetet inspektuese janë më të shpeshta. Numri i lëndve të proceduara
O1	M1	Ngritja e vetëdijes publike nëpërmes fushatave mediale dhe sistemit shëndetësor	**Qendror** MSH MMPH MTT MASHT **Lokal**	BKK Donacion	Mbeturina Rezatimi Ajri Toka Uji Edukimi	Plani për ngritje të vetëdijes. Numri i fushatave të ndërmarra. Numri i publikimeve.
O1	M1	Parandalimi i sëmundjeve ngjitëse dhe jongjitëse	**Qendror** MSH MMPH Biznesi	BKK Donacion Investime private	Mbeturina Rezatimi Ajri Toka Uji Edukimi	Shkalla e sëmundshmërisë Shkalla e hospitalizimit Shkalla e vdekshmërisë

4.7 SIGURIA KIMIKE DHE BIOLOGJIKE

Shoqëria moderne varet nga një numër i madh i prodhimeve kimike dhe biologjike të cilat ajo i përdor në përditshmërinë e saj. Supozohet që më shumë se 100,000 substanca të ndryshme gjenden në tregun evropian. Deri më tani, vetëm një numër i vogël i substancave që gjenden në treg janë studiuar dhe testuar për të vlerësuar sa të sigurta janë ato dhe çfarë rreziqesh paraqesin ato për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

4.7.1 Kimikatet

Gjendja e tanishme

Industria kimike, posaçërisht ajo bazike që nga 1989 ka qenë dega më e rëndësishme e industrisë në Kosovë. Aktualisht nuk ka prodhim vendor të kimikateve të rrezikshme mirëpo ato importohen. Në zonat e fabrikave kanë mbetur sasi të mëdha të kimikateve të cilat kontrollohen vetëm pjesërisht apo nuk kontrollohen fare. Si pasojë këto kimikate kryesisht ruhen në kushte të papërshtatshme, në të shumtën e rasteve nuk kanë pronar dhe mbikëqyrje çka e rrit mundësinë për keqpërdorim dhe aksidente.

Sistemi për menaxhimin e kimikateve nuk është zbatuar në Kosovë. Aktualisht nuk ka strategji për menaxhimin e kimikateve, as kornizë legjislative për të rregulluar menaxhimin e

përgjithshëm të kimikateve në pajtim me legjislacionin e BE. Sidoqoftë, ka dy ligje ekzistuese[40] në zbatim që mbulojnë dy çështje të veçanta[41] të menaxhimit të kimikateve. Mbikëqyrja e importit dhe shfrytëzimi i elementeve kimike të rrezikshme nuk është implementuar ende. Kompetencat në këtë fushë u takojnë: Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Punës dhe Ministrisë së Shërbimeve Publike, Ministria e Transportit dhe Post-telekomunikacionit etj.

Kosova nuk është e përfshirë në Programin Ndërkombëtar për Siguri Kimike (International Program for Chemical Safety - IFCS). Sistemi monitorues dhe shkëmbimi i të dhënave mes organeve të ndryshme qeveritare nuk është i zhvilluar, njësoj sikur edhe sistemi për informim publik. Mungon sistemi edukativ i prodhuesve individual mbi shfrytëzimin e kimikateve.

Prioritizimi i problemeve

- Mungon Strategjia për menaxhimin e kimikateve,
- Mungon baza ligjore, procedurat dhe udhëzimet për menaxhimin e kimikateve,
- Mungon sistemi i përgjithshëm për monitorim,
- Mungon sistemi për regjistrimin, vlerësimin dhe autorizimin e kimikateve,
- Nuk funksionon sistemi i informimit publik,
- Mungojnë procedurat për mbikëqyrjen e transportit ndërkufitar të kimikateve dhe për shkëmbim të të dhënave. Këto duhet përpiluar në pajtim me kërkesat e Konventës mbi mbikëqyrjen e transportit ndërkufitar të kimikateve të ndaluara dhe kimikateve për përdorim të kufizuar (PIC Convention),
- Në procesin e ristrukturimit dhe privatizimit nuk ka obligime për të paraqitur informata lidhur me kimikatet, mbeturinat e rrezikshme dhe elementet tjera që ndikojnë në shëndetin dhe mjedisin.
- Nuk ka program për ndotësit e qëndrueshëm organik (POPs).

Objektiva

O1 Të sigurohen kushte ligjore, teknike dhe resurse njerëzore për menaxhimin dhe implementimin e një sistemi të sigurt për menaxhimin e kimikateve.

Masat

M1 Përgatitja dhe miratimi i Projektligjit për Kimikate duke marrur parasysh edhe trendet e tanishme që ndërlidhen me REACH (Registration Evaluation on Authorising Chemicals).

M2 Forcim institucional dhe ngritja e kapaciteteve për menaxhim me kimikate;

[40]Ligji mbi Plehërat Artificiale (2003/22) dhe Ligji për Pesticide (2003/35), Ligji për Transportin e mallrave të rrezikshme (2004/17).

[41]Kosova në prodhimin e ushqimit përdor 15% më pak plehra artificial dhe pesticide se në vendet përendimore, mirëpo për arsye të përdorimit jo adekuat dhe jo profesional koncentrimi i kimikateve në uhqim dhe ujë është më i lartë se ajo që pritet prej sasisë së përdorur të kimikateve.

Objektiva	Aktivitetet		Niveli dhe akteret	Burimet potenciale për financim	Sektorët tjerë me te cilët ndërlidhet	Indikatorët e suksesit
O1	M1	Hartimi dhe miratimii i Ligjit për Kimikate dhe legjislacionit sekondar	**Qendror** MMPH MBPZHR MSH	BKK Donacione	Bujqësia Ujrat Toka Mbeturinat Industria	Ligji i miratuar Aktet nënligjore të hartuara
O1	M1	Studim mbi kontrollin e aspiratorëve për gazra të rrezikshme	**Qendror** MMPH MTI	BKK Donacione	Bujqësia Industria Mbeturinat	Studimi i kryer
O1	M1 M2	Udhëzues praktik për kompanitë për të menaxhuar rrezikun	**Qendror** MMPH MTI	BKK Donacione	Bujqësia Industria Mbeturinat	Udhëzuesi i përgatitur dhe ipublikuar
O1	M1 M2	Përpilimi i inventarit të kemikateve në Kosovë	**Qendror** MMPH MSH MBPZHR DE	BKK Donacione	Bujqësia Industria Mbeturinat	Inventarizimi dhe Inventari
O1	M2	Themelimi i një institucioni për regjistrimin, vlerësimin dhe autorizimin e kimikateve	**Qendror** MMPH MTI	BKK Donacione	Bujqësia Industria Mbeturinat	Regjistri i kimikateve

4.7.2 Siguria biologjike

Gjendja e tanishme

Në Kosovë nuk ka të regjistruara aktivitete të përdorimit të materialeve dhe organizmave të modifikuara gjenetikisht, (OMGJ) e as prodhimit të tyre për qëllime komerciale.

Sistemi i monitorimit të OMGJ nuk ekziston dhe ka mundësi për importimin e OMGJ. Ende nuk është vendosur baza ligjore për rregullimin e sigurisë biologjike. Mirëpo ka disa ligje të miratura në kohën e funditi[42] që mund të lidhen më çështjen e sigurisë biologjike. Edhe sa i përket inspektimit ka nevojë për përkrahje institucionale.

Objektiva

O1 Të vendosen kushtet ligjore, teknike dhe resurset njerëzore të trajnuara për menaxhimin e prodhimeve me potencial të rrezikshmërisë biologjike

Masat

M1 Përgatitja dhe miratimi i Projektligjit për OMGJ dhe akteve nënligjore relevante

[42]Ligji për Fara (2003/10) dhe Ligji për Materiale Mbjellëse (2004/16)

Objektiva	Aktivitetet		Niveli dhe akteret	Burimet potenciale për financim	Sektorët tjerë me te cilët ndërlidhet	Indikatorët e suksesit
O1	M1	Hartimi i Ligjit për OMGJ-të	**Qendror** MMPH MBPZHR MSH MSHP	BKK	Shëndeti Bujqësia Siguria	Projektligji i hartuar
O1	M1	Themelimi i institucionit përkatës përgjegjës për kontrollin e OMGJ	**Qendror** MMPH MSHP MSH MBPZHR	BKK Donacione	Shëndeti Bujqësia Siguria	Është themeluar institucioni
O1	M1	Informimi i publiku për OMGJ-të	**Qendror** MMPH MSH MSHP MBPZHR	BKK	Shëndeti Bujqësia	Numri i fushatave të realizuar mbi OMGJ.

4.8 MBROJTJA CIVILE

Mbrojtja civile është një formë organizimi, përgatitje dhe participimi të qytetarëve, personave juridik, institucionevel qeveritar dhe njësive lokale qeveritare dhe vetëqeverisëse drejt mbrojtjes dhe shpëtimit të jetës së njerzëve, të mirave dhe mjedisit nga rreziqet dhe pasojat e fatkeqësive natyrore, teknike-teknologjike dhe ekologjike si dhe nga shkatërrimet e konflikteve.

Situata e tanishme

Gjatë luftës së fundit në Kosovë pajisjet për mbrojtjen dhe shpëtimin e jetës së njerzëve dhe të mirave materiale janë shkatërruar fizikisht. Edhe disa nga pajisjet e mbetura tani janë të vjetruara dhe të jashtë përdorimit ashtu që tani nuk ka asnjë vlerë shfrytëzimi.

As gjatë proceseve të rindërtimit e as ripërtëritjes së zonave prodhuese, publike dhe rezidenciale nuk i është kushtuar vëmendje e duhur riparimit apo furnizimit me pajisje të përshtatshme për kryerjen e aktiviteteve të mbrojtjes dhe shpëtimit në raste të fatkeqësive natyrore dhe të tjera. Kërkesat financiare janë shumë të mëdha për t'i bërë pajisjet në me aftësi funksionale, ose për të siguruar pajisje të reja, kështu që përveç donacioneve nga jashtë duhet ndarë fonde nga buxheti i Kosovës, që së paku një pjesë e pajisjeve të mund të sigurohet dhe arrihet një nivel minimal për mbrojtjen e jetës së njerëzve dhe të mirave materiale, posaçërisht në fushën e veprimeve parandaluese.

Korniza ligjore

Ministria e Shërbimeve Publike, përmes Departamentit të Emergjencës, është e autorizuar për organizimin dhe zbatimin e mbrojtjes civile. Përgjegjës për sigurinë janë pronarët, shfrytëzuesit e objekteve rezidenciale, objekteve të punës, dhe organet kompetente që kanë përgjegjësi sipas ndarjes territoriale (komunë dhe rajon). MMPH pas aprovimit të 'Planit të Veprimit në Mjedis' do të punojë së bashku me Ministrinë e Shërbimeve Publike drejt themelimit dhe implementimit të procesit APELL (Awareness and Preparedness at Local Level).

Prioritizimi i problemeve

- Mungesa e rregulloreve për situata të jashtzakonshme;
- Mungesa e pajisjeve për mbrojtjen dhe shpëtimin e jetës së njerzëve dhe të mirave materiale;
- Mungesa e mjeteve financiare;
- Mungesa e Planit për Mbrojtje Civile në raste të jashtëzakonshme.

Objektiva

O1 Të zhvillohet plani afatgjatë dhe efikas për mbrojtje civile në situata të jashtzakonshme.

Masat

M1 Hartimi i rregulloreve, përfshirë edhe harmonizimin me Direktivën SEVESO

M2 Sigurimi i organizimit adekuat institucional dhe trajnimi i stafit

Objektiva	Aktivitetet		Niveli dhe akteret	Burimet potenciale për financim	Sektorët tjerë me te cilët ndërlidhet	Indikatorët e suksesit
O1	M1	Krijimi i bazës ligjore dhe zbatimi i procesit të VNM	**Qendror** MMPH MSHP TMK	BKK Donacione	Shëndeti Industria Bujqësia Transporti	Ligjet e miratura Procesi i përmirësuar i VNM
O1	M1	Përshtatja dhe zbatimi i parimeve të APELL	**Qendror** MMPH MSHP TMK **Lokal** KK	BKK Donacione	Shëndeti Industria Bujqësia Transporti	APELL-i i përshtatuar dhe i zbatuar
O1	M1	Krijimi i sistemit për komunikim dhe informim për mbrojtje dhe shpëtim	**Qendror** MMPH MSHP MBPZHR MTI TMK **Lokal** KK	BKK Donacione	Shëndeti Industria Bujqësia Transporti	Sistemi i zhvilluar dhe funksionalizimi informimit
O1	M2	Ngritja e kapaciteteve të kuadrove për aktivitetet e mbrojtjes civile	**Qendror** MMPH MSHP TMK **Lokal** KK	BKK Donacione	Shëndeti Industria Bujqësia Transporti	Numri i programeve të trajnimit Numri i pjesmarrsve
O1	M2	Vlerësimi i gjendjes së sistemeve për mbrojtje nga zjarri në komplekse për banim kolektiv	**Qendror** MSHP **Lokal** KK	BKK Donacion	Shëndeti Industria Bujqësia Transporti Planifikimi hapësinor	Studimi i publikuar pas vlerësimit
O1	M2	Inventarizimi i	**Qendror**	BKK	Shëndeti	Inventari i

		aksidenteve ekolgjike, rrëshqitjeve dhe objekteve të shkatërruara	MSHP MMPH **Lokal** KK	Donacione	Industria Bujqësia Transporti	përgatitur dhe publikuar

4.9 MBROJTJA NGA RREZATIMI

4.9.1 Rrezatimi jonizues

Kosova, sipas Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (ANEA) nuk i takon vendeve që përdorin burimet e rrezatimit jonizues në mjekësi, industri dhe gjurmime. Kosova nuk ka objekte nukleare, programe nukleare e as materiale apo mbeturina nukleare. Materialet radioaktive dhe burimet e rrezatimet shfrytëzohen vetëm në mjekësi (radioterapi), mirëpo edhe kjo në sasi shumë të vogël për shkak se pajiset e përshtatshme mjekësore nuk janë të instaluara.

Ekzistojnë depo të vogla (Obiliq, Stan Tërg) ku janë të vendosura materie dhe mbeturina radioaktive nga aktivitetet industriale të KEK-ut dhe Trepcës.

Problem në Kosovë janë edhe të ashtuquajturat burime të humbura të rrezatimit[43], kontaminimi i tokave me uraniumin e varfëruar (DU) gjatë luftës së fundit[44].

Po ashtu, nuk ka monitorim të radioaktivitetit dhe nuk ka studime tjera në Kosovë sa i përket ndikimit të tij në shëndetin e njeriut në mjedis. Nuk ekzistojnë as të dhëna mbi ndikimin në florë, faunë, ajër, ujëra sipërfaqësor dhe nëntokësor.

Në Kosovë nuk ka sistem për regjistrimin e burimeve jonizuese të rrezatimit. Ligjet ekzistuese nuk e rregullojnë çështjen e mbrojtjes nga rrezatimi dhe nuk ka plane as masa për reduktimin e ekspozimit ndaj burimeve të tilla të rrezatimit.

Objektiva

O1 Të vendosen korniza ligjore dhe teknike për mbrojtje efikase nga rrezatimi jonizues.

Masat

M1 Identifikimi dhe analiza e plotë e burimeve të rrezatimit jonizues;

M2 Përpilimi legjislacionit dhe të gjitha akteve nënligjore.

4.9.2 Rrezatimi jo jonizues

Burimet e rrezatimit jo-jonizues janë llambat ultra violete që përdoren për terapi të ndryshme dhe qëllime kozmetike, mikrovalët, stacionet e radios dhe TV, sistemet me voltazh të lartë, stacionet elektrike dhe njësi tjerë industriale të këtyre përmasave.

[43] Burimet e humbura të radiacionit janë: alarmet për zjarre, shkopet ndriquese radioaktive, pajisjet e përdorura medicinale dhe industriale që kanë humbur gjatë bombardimeve të këtyre objekteve gjatë luftës apo edhe pas luftës, ashtu që këto mundtë paraqesin rrezik për njerëzit që jetojnë në rrethinë dhe ata të mos jenë fare të vetëdijshëm për rrezikun.

[44] Uraniumi i varfëruar në Kosovë – UNEP 1999, raport sipas të cilit uraniumi i varfëruar është hasur në 112 vend mostrime në Kosovë. Përmbajta ultraviolete konsiderohet të jetë 9.3 t, nga 31. 000 predha të përdorura nga NATO në Kosovë.

Në Kosovë kjo çështje nuk është rregulluar ende dhe nuk ka plane për kontrollin dhe monitorimin e burimeve të rrezatimit jo-jonizues

Objektiva

O2 Të krijohet korniza ligjore dhe teknike për mbrojtje efikase nga rrezatimi jo-jonizues

Masat

M3 Hartimi i ligjit mbi rrezatimin jojonizues

Objektiva	Aktivitetet		Niveli dhe akteret	Burimet potenciale për financim	Sektorët tjerë me te cilët ndërlidhet	Indikatorët e suksesit
O1	M1	Miratimi i legjislacionit për mbrojtje nga rrezatimi jonizues dhe jojonizues	**Qendror** MMPH	BKK Donacione	Shëndetsi Siguria kimike Mbeturina	Miratimi i ligjit Numri i akteve nënligjore
O1	M1	Ngritja e kapaciteteve të stafit në shëndetësi, industri	**Qendror** MMPH MSH MTI	BKK Donacione	Shëndetsi Siguria kimike Mbeturina	Numri i trajnimeve Numri i pjesmarrsve
O1	M1	Vendosja e sistemit për monitorim dhe informim	**Qendror** MMPH MSH	BKK Donacione	Shëndetsi Siguria kimike Mbeturina	Është dizajnuar, dhe zhvilluar rrjeti monitorues
O1	M1	Kontrolli i transportit të materialeve dhe mbeturinave radioaktive	**Qendror** MMPH MTT MTI Doganat	BKK	Shëndetsi Siguria kimike Mbeturina Transporti	Procedura e përshtatura për kontroll.
O1	M2	Hartimi i udhëzuesve për punë me burimet e rrezatimit jonizues dhe jo-jonizues	**Qendror** MMPH MSH MTI	BKK Donacione	Shëndetsi Siguria kimike Mbeturina Edukimi	Udhëzuesit e publikuar
O2	M3	Inventarizimi i burimeve jonizuese dhe jojonizuese mbikëqyrja e tyre	**Qendror** MMPH	BKK Donacione	Shëndetsi Siguria kimike Mbeturina	Inventari i burimeve jonizuese dhe jojonizues

4.10 ENERGJETIKA

Zhvillimi i qëndrueshëm nënkupton përmirësimin e cilësisë së jetës me shfrytëzimin racional të resurseve natyrore dhe zvogëlimin e presioneve në mjedis. Cilësia e jetës sonë ngritet shumë me shfrytëzimin e energjisë dhe shërbimet që ofron ajo. Burimi kryesor për prodhimin e energjisë elektrike në Kosovë është linjiti. Çështja qëndron në atë se si mund t'i përdorim resurset ekzistuese të energjisë në mënyrë të qëndrueshme dhe si t'i zëvendësojmë ato me burime të ripërtritshme.

Gjendja e tanishme

Sektori energjetik paraqet njërin ndër sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë së Kosovës, por edhe sektor që shkakton ndotjen më të madhe në mjedis.

Burimi kryesor për prodhimin e energjisë elektrike është linjiti me prodhim 97% të energjisë elektrike, ndërsa 3% e energjisë prodhohet nga hidrocentralet. Nuk ka prodhim të energjisë nga burimet alternative (solare, me erë etj.)

Burimet kryesore të energjisë në Kosovë përbëhen nga dy basene më të mëdhej të linjitit, të emërtuara Kosova dhe Dukagjini, me depozitim të përdorshëm të linjitit, të vlerësuar se tejkalojnë 11.55 miliardë (bilion) tonelata. Rezervat e linjitit kanë përmbajtje të ulët të sulfurit me përqendrim relativisht të mjaftueshëm të gëlqeres për absorbimin e sulfurit gjatë djegies.

Sistemi i integruar i energjisë elektrike, përbëhet nga dy miniera të linjitit në Bardh dhe Mirash dhe dy termocentrale, Kosova A dhe B, me kapacitet të përgjithshëm efektiv prej 645 deri 710 MW, prej 1478 MW të kapacitetit të instaluar, të cilat shfrytëzojnë përafërsisht 7 milionë tonelata në vit linjit.

Që nga muaji maj 2005 kapaciteti total i sistemit të prodhimit në Kosovë (B1+B2, A1+A5 dhe hidrocentrali i Gazivodës/Ujmanit), është prej 585/745 MW, me kapacitet prodhimi vjetor prej rreth 3,800 GWh. Duhet të përmendet se neto prodhimi total gjatë viteve 2000-2004 është rritur vazhdimisht nga 1,914 GWh në vitin 2000, 2,568 GWh në vitin 2001, 3,153 GWh në vitin 2002, 3,326 GWh në vitin 2003, deri 3,501 GWh në vitin 2004, që interpretohet në 1751 kWh, për kokë të banorit.

Në krahasim me mesataren botërore, që në vitin 2000 ishte 2343 kWh/për kokë, dhe me mesataren e vendeve të OBEZH, përkatësisht 8089 kwh/për kokë. Kjo do të thotë se prodhim vjetor në Kosovë është 75% i mesatares botërore dhe vetëm 22% e mesatares së OBEZH. Deficiti i energjisë së prodhuar është një faktor shumë kufizues për përmirësimin e standardit jetësor në Kosovë.

Në përgjithësi efikasiteti i energjisë është mjaft i ulët. Në sektorin e energjisë mbizotëron teknologjia e viteve të 60-ta dhe 70-ta që është një indikator i qartë për problemet mjedisore.

Presionet mjedisore

Sektori energjetik është një ndër ndotësit më të madhej të mjedisit në Kosovë, posaçërisht në rajonin e Prishtinës. Emisionet e gazrave nga termocentralet me përqendrim të madh të materieve acidike, pluhurit dhe vetëndezja e thëngjillit, shkaktojnë ndotjen e madhe të ajrit. Është evidente që sektori energjetik në Kosovë është po ashtu kontribuuesi më i madh në shkarkimin e gazrave të serrës (greenhouse gas (GHG)). Mostrajtimi i ujërave nga procesi teknologjik, ujërave që rrjedhin nga minierat sipërfaqësore, gjendja jo e mirë e rezervarëve dhe baseneve të ujërave fenolike dhe fenolit të koncentruar në zonën e gazifikimit dhe shpërlarja e tokës nga të reshurat atmosferike, në tërë zonën e KEK-ut, e cila gjatë kohës është ndotur me fenole, shkakton në masë të madhe ndotjen e lumit Sitnica, me theks të veçantë me fenole. Probleme shtesë janë edhe deponitë e hirit të cilat akumulojnë më shumë se 40 milion tonelata hi, duke uzurpuar kështu rreth 150 ha tokë punuese, si dhe krateret e hapura gjate mihjeve sipërfaqësore për eksploatimin e thëngjillit.

Burime të mëdha të ndotjes në territorin e Kosovës janë:

- Termocentralet (Kosova A dhe Kosova B)
- Mihja sipërfaqësore e linjitit në Obiliq/Kastriot
- Kompleksi industrial në Mitrovicë

- Ferronikeli në Gllogovc
- Fabrika e përpunimit të metalit në Janjevë
- Fabrika Ballkan në Therandë
- Fabrika e çimentos- Sharcem në Han të Elezit
- Sistemet për ngrohje qendrore (Prishtinë, Gjakovë dhe Mitrovicë)
- Industria e rëndë bazike (aktualisht nuk funksionon) në Gjakovë, Pejë dhe Gjilan
- Trafiku

Në Kosovë, momentalisht nuk ekziston një sistem monitorimi të ajrit, ujit apo i dheut. Nuk janë vendosur sistemet për menaxhimin e mjedisit nëpër industritë që janë në funksion dhe nuk zbatohen parimet e Konventës së Aarhusit. Për arsye të statusit të paqartë politik të Kosovë kjo konventë nuk është ratifikuar ende. Edhe pse të dhënat nuk janë të kuantifikuara, informatat reflektojnë probleme serioze mjedisore të cilat duhen zgjidhur urgjentisht.

Korniza ligjore

Deri tani në Kosovë janë miratuar vetë tri ligje themelore.[45] Ligji i Energjetikës, Ligji mbi Energjinë Elektrike dhe Ligji për Rregullimin e Energjisë. Fatkeqësisht zbatimi i ligjit nuk është shumë efikas. Po ashtu ende nuk janë krijuar kushtet për zbatimin e Direktivës IPPC (Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes). Zbatimi i kësaj direktive do të ndikojë shumë në sektorin energjetik sa i përket kostos së implementimit të saj.

Është miratuar Strategjia e Energjisë e Kosovës për periudhën 2006-2015, e cila parasheh investime në termocentralet me shfrytëzim të linjitit (fuqi shtesë 1000 MW deri në 1600 MW). Investimet në shfrytëzimin e burimeve të ripërtritshme i lihen sektorit privat edhe pse në këtë drejtim nuk është ndërmarr asnjë hap.

Përkundër ekzistimit të ligjit dhe strategjisë, aktualisht nuk ka ndonjë qasje të definuar për bashkëpunim horizontal në nivel qeveritar, me qëllim të vendosjes së normave madhore esenciale në sektorin energjetik.

Në Kosovë janë derdhë mjete të konsiderueshme ndërkombëtare, të cilat kanë mund të shfrytëzohen edhe për pilot projekte më të vogla por edhe për projekte të mëdha për infrastrukturë në sektorin e energjetikës.

Këto projekte duhet të aktualizojnë rëndësinë e efikasitetit energjetik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Bashkëpunimi me industri deri më tani ka ekzistuar vetëm deklarativisht; nuk janë implementuar projekte konkrete për zgjidhjen e problemeve mjedisore, veçanërisht në sektorin energjetik.

Nevojat për energji, posaçërisht për energji elektrike është në rritje të vazhdueshme. Megjithatë, duke pasur parasysh dinamikën e zhvillimit të parashikuar[46], deri më 2015, janë bërë iniciativat e para për ndërtimin e kapaciteteve të reja por edhe për riparimin e termocentraleve ekzistuese – Kosova A, ku parashihet shtimi i fuqisë prej 75% dhe në Kosova B prej 85%. Në këtë mënyrë, burimi kryesor për prodhimin e energjisë edhe më tej mbetet linjiti, me të gjitha problemet që i përcjellin ato, si dhe përdorimi i shtuar i rrjedhave ujore për hidrocentrale (aktualisht vetëm hidorcentrali i Gazivodës/Ujmanit është në funksion dhe

[45] 2004/21, 2004/22, dhe 2004/20

[46] Strategjia e Energjisë dhe Politikat e Kosovës, Green - Paper, AKM - DM.

pritet aktivizimi i hidrocentralit të Zhurit) dhe biomasa, e cila deri më tani nuk është përdorur fare për qëllime energjetike.

Prioritizimi i problemeve

Problemet kryesore mjedisore që rrjedhin nga sektori energjetik janë:

- Prodhimi i energjisë elektrike, kryesisht bazohet në shfrytëzimin e resurseve të jo ripërtritshme (linjiti);
- Përdorimi i sasisë së madhe të linjitit, me cilësi të ulët, në prodhimin e energjisë posaçërisht asaj elektrike;
- Shfrytëzim i ulët i burimeve të ripërtritshme të energjisë; Kosova tani me prodhim vetanak mbulon vetëm një pjesë të nevojave të veta për energji;
- Nuk ka inventar të gazrave të serrës edhe pse sektori energjetik është kontribuuesi kryesor në lirimin e gazrave të tilla;
- Ndotje e madhe e ajrit me SO_2, grimca të suspenduara, NOx, CO, metale të rënda, nga sektori energjetik dhe mbeturinave industriale nga aktivitetet e mëparshme të Trepçës, posaçërisht në lokacionet Obiliq dhe Mitrovicë. Në këto lokacione të ndotura jeton rreth 65% të popullsisë së Kosovës;
- Kontaminimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ajrit dhe dheut i shkaktuar nga objektet e KEK-ut dhe mihjeve sipërfaqësore;
- Teknologji të vjetruara dhe pajisje të papërdorshme;
- Intensitet i lartë i energjisë në industri, në sektorët publik dhe amvisëri;
- Investime të vogla në teknologji të reja dhe në programet për efikasitet energjetik;
- Në sektorin energjetik ligjet mbi vlerat për emision ndërkufitar, asnjëherë nuk janë zbatuar plotësisht;
- Për arsye të mungesës së monitorimit mjedisor nuk ka as të dhëna statistikore relevante për mjedisin;
- Kapacitetet institucionale nuk janë të zhvilluara në masë të mjaftueshme;
- Nuk ka zbatim të instrumenteve ekonomike;

Objektivat

O1 Reduktimi i presioneve mjedisore nga sektori energjetik duke implementuar projekte për efikasitet energjetik (EE) dhe sjellja graduale e burimeve të ripërtritshme energjetike (BRE) dhe teknologjive të reja.

Masat

M1 Finalizimi dhe implementimi i Strategjisë për Energjetikë dhe Planit të Veprimit dhe miratimi i nënligjeve të nevojshme.

M2 Ngritja e kapaciteteve institucionale.

M3 Ngritja e instrumenteve ekonomike.

M4 Inventari i gazrave nga serrat dhe limitet nacionale.

Objektiva	Aktivitetet		Niveli dhe akteret	Burimet potenciale për financim	Sektorët tjerë me te cilët ndërlidhet	Indikatorët e suksesit
O1	M1	Sigurimi i kushteve ligjore dhe teknike për implementimin e pilot programeve për EE dhe BRE	**Qendror** MEM MMPH KEK	BKK Donacione Investime	Miniera Ajri Uji Toka Mbeturina	Është zhvilluar korniza legjislative për EE dhe BRE
O1	M1 M4	Pilot projekte për të zbuluar potencialin energjetik të mbeturinave	**Qendror** MEM MMPH MTI AKM **Lokal** KK	BKK Donacione Investime	Miniera Ajri Uji Toka Mbeturina	Lista e pilot projekteve të identifikuara dhe të zbatuara
O1	M1	Zhvillimi i një plani për menaxhimin e mbeturinave nga sektori energjetik	**Qendror** MMPH MEM	BKK Donacione	Miniera Ajri Uji Toka Mbeturina	Është përgatitur plani për menaxhimin e mbeturinave
O1	M1	Sigurimi i kushteve ligjore dhe teknike për transfer njohurive dhe teknologjive të reja	**Qendror** MMPH MEM MTI	BKK Donacione	Ajri Toka Mbeturina	Është përgatitur legjislacioni përkatës
O1	M1 M3 M4	Zbatimi ligjor i kontrollit të cilësisë së karburanteve	**Qendror** MMPH MEM MTI	BKK Donacione	Ajri Toka Mbeturina	Regullorja për cilësinë e karburanteve
O1	M1 M2	Themelimi i sistemit monitorues dhe informues	**Qendror** MMPH KEK Bizneset	BKK Donacione Investime	Ajri Uji Toka Mbeturina	Është dizajnuar, zhvilluar dhe vendosur sistemi për monitorim dhe informim
O1	M1 M4	Përcaktimi i limiteve për emisionet nga termoelektranat dhe sistemet e ngrohjes qendrore	**Qendror** MMPH MEM **Lokal** KK	BKK Donacione	Ajri Uji Toka Mbeturina	Akti ligjor për limitet e emisioneve
O1	M1	Zhvillimi i rregulloreve për përformancën energjetike të ndërtesave	**Qendror** MMPH **Lokal** KK	BKK Donacione	Ajri Uji Toka Mbeturina	Është përgatitur dhe miratuar legjislacioni
O1	M1 M2 M3 M4	Inkurajimi i përdorimit të sistemeve të kombinuara për ngrohje	**Qendror** MMPH MEM	BKK Donacione	Ajri Uji Pylltaria	Sistemet e reja për ngrohje
O1	M2	Ngritja e kapaciteteve të personelit në sektorin e energjetikës	**Qendror** MMPH MEM	BKK Donacione	Miniera Ajri Uji Toka Mbeturina	Numri i trajnimeve Numri i pjesmarrsve
O1	M2 M3 M4	Mbështetje për marrëveshjet volluntere mes qeverisë dhe industrisë	**Qendror** MEM MMPH Bizneset	BKK Investimet	Miniera Ajri Uji Toka Mbeturina	Numri i marrëveshjeve të arritura
O1	M3 M4	Vlerësimi i mundësive për sjelljen e taksave për CO_2	**Qendror** MMPH MEM MEF	BKK	Miniera Ajri Uji Toka Mbeturina	Studimi i vlerësimit të mundësive për sjelljen e taksave për CO_2

O1	M1 M2 M3 M4	Zhvillimi i shfrytëzimit të BRE	**Qendror** MMPH MEM KEK	BKK Investimet	Miniera Ajri Uji Toka Mbeturina	Është përfunduar forcimi i kapaciteteve të EE dhe BRE

4.11 INDUSTRIA DHE MINIERAT

Gjendja e tanishme

Zhvillimi i industrisë në Kosovë ka qenë i diktuar nga interesat ekonomike të ish Jugosllavisë. Sipas projekteve të asja kohe eksploatimi i resurseve natyrore ishte shumë intenziv, sa që në vitin 1988 energjetika, metalet me ngjyrë dhe procesimi i tyre përbënte 63% të prodhimeve industriale në Kosovë. Këto aktivitete zhvillimore i kanë anashkaluar masat për mbrojtjen e mjedisit[47], kanë shkaktuar ndikime të mëdha në mjedis dhe pasojat e tyre nuk janë rehabilituar sot e kësaj dite.. Kosova, nga shumë aspekte i takon grupit të vendeve në Evropë me sipërfaqe më të ndotura. Sektori i prodhimit privat ka filluar të zhvillohet këto vitet e fundit mirëpo pa një koncept dhe vizion të shëndoshë.

Ky problem është posaçërisht evident në Trepçë dhe Obiliq që nga viti 1962 kur minierat filluan punën. Probleme të ngjashme janë edhe në Hajvalija, Kishnica, Artanë, Klina, Hani i Elezit dhe në mihjet sipërfaqësore, të cilat në të shumtën e rastit janë të lokalizuara në toka të punueshme, të cilat janë të mbuluar nga mbetjet (hiri). Treguesi i prodhimit fizik ka rënë shumë gjatë këtyre viteve të fundit dhe pas luftës s nuk është ngritur. Kjo ka krijuar një situatë të tillë që niveli i ndotjes është më i ulët por problemet janë ende prezent. Është shumë e vështirë të definohen efektet ndotëse nga industritë dhe minierat në Kosovë ngase të dhënat përkatëse mungojnë[48].

Në Kosovë, zonat me pasura me plumb dhe zink janë të koncentruara më së shumti në brezin e Trepçës, siq janë vendburimet në: Stan Tërg (me vendburimet në Melenicë dhe Zijaçë), Kishnicë, Artanë (Novo Brdo), dhe Leposaviq.

Vlerësohet të ekzistojnë këto rezerva:

Vetëndodhjet	Kategoria e rezervave	Sasia (t)	Permbajtja Pb (%)	Zn (%)	Ag (g/t)
Stan Tërg	A+B+C1	23,968,312	3.45	2.36	74
	C2	5,200,000	3.40	2.23	81
Melenica	A+B+C1	915,000	10.37	11.25	84
Zijaça	B+C1	4,273,000	2.58	1.11	19
Kishnica e	A+B+C1	13,274,165	5.27	4.48	78
Artana	C2	5,400,000	4.38	3.53	-
Kopaonik	A+B+C1	3,690.333	5.88	4.04	89
Leposavic	C2	1,531,500	5.48	4.61	65
Gjithsej	A+B+C1	46,120,810	4.23	3.15	70
	C2	12,131,500	4.10	3.11	-

Ka interes edhe për eksploatimin e rezervave të 47.000.00 t mineralesh, që përbëhen prej 25% plumb, 5% zink, dhe 45 gr/t argjend në lokacionin e quajtur Çuka e Batllavës.

[47] Resurset natyrore në të shumtën e kohës janë eksploatuar në mnëyrë jo prefesionale pa kontroll speciale dhe pa projekte mjedisore

[48]Gusht 2000 UNMIK nxorri një raport mbi jë studim të kryer në Mitrovicën veriore. Studimi indikon që niveli i plumbit asokohe ishte tepër i lartë, duke i tejkaluar nivelet e lejuar nga OBSH për 200 herë. Arsye kryesore për këtë është shfrytëzimi i teknologjisë së vjetruar për eksploatimin e të gjitha resurseve.

Përveç dy lokacioneve të njohura me Nikel dhe Kobalt në Çikatovë[49] dhe Magure, dihet që në Kosovë ekzistojnë me dhjetëra lokacione tjera me këto minerale. Dy vendndodhjet kryesore janë gjurmuar thellësisht dhe vërtetohen 20 milion t rezerva: Ni 1.31% dhe Co 0.07%. Pas një numër vitesh eksploatimi të këtyre lokacioneve llogaritet që 11 mil t minerale të jenë në dispozicion, çka do të mjaftonte për një dekadë eksploatim.

Në Kosovë dihet edhe për ekzistimin e boksiteve, më saktësisht në rajonin e Greminkut[50] (Volljakë) dhe paraqiten në formë të trupave të ndryshëm mineral. Boksitet e Gremnikut janë ferrosive ngase përmbajnë një sasisë të madhe të hekurit. Studimet gjeologjike kanë vërtetuar rezerva te boksiteve prej rreth 5 mil ton, që përbehen prej: Al_2O_3, rreth 48%, SiO_2 rreth 2.5% Fe_2O_3 rreth 36%. Pas disa vitesh eksploatim llogaritet që rezervat e boksiteve të jenë rreth 2.700.000 t., që është sasi e mjaftueshme për 15 vitet e ardhshme.

Minierat e hekurit më të njohurat në Kosovë gjenden në lokacionet e Çarit – Sedlarit dhe Tërstenik – Caralevë – Ivaj, kryesisht në formë të lokacioneve të mesme apo trupave të shpërndarë mineral.

Pluhuri i kuarcit është shumë i përhapur edhe pse hulumtime janë kryer vetëm në dy zona: Mirosalje (Ferizaj) dhe Sllovi (Lipjan) me përafërsisht 3 milion t rezerva cilësore që mund të përdoren për qëllime të ndryshme.

Nga resurset e mineraleve jometalike, më të njohurat janë ato të magnezitit me vedndodhjet në Strezovc dhe Magur me 3 miljon t respektivisht 2.350.000 t rezerva ekzistuese.

Në Karaçevë paraqitet vendndodhjet i Kaolinës me 7.500.000 t rezerva.

Resurset e lëndës së parë për prodhimin e çimentos gjenden në Han të Elezit dhe janë duke u eksploatuar tash një kohë të gjatë. Rezervat e vërtetuara më herët vërtetonin 15.000.000 t, sasi e cila nga eksploatimet shumëvjeçare tani është përgjysmuar.

Aktualisht, industria ushqimore, industria e duhanit, përpunim i drurit dhe tekstilit nuk janë në funksion. Megjithatë, procesi i privatizimit është duke ndodhur dhe ndikimet potenciale negative duhen të merren në konsiderim që në fazat e planifikimit.

Presionet mjedisore

Aktivitetet e mëposhtme mund të dallohen si burime kryesore të presioneve mjedisore në ajër, ujë dhe në dhe:

- Eksploatimi dhe shfrytëzimi i lignjitit;
- Shfrytëzimi i minierave nëntokësore;
- Pasurimi dhe përpunimi i resurseve minerale;
- Shfrytëzimi i inerteve aluviale;
- Guroret.

Korniza ligjore

Një nga objektivat kryesore të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, është edhe shfrytëzimi racional dhe i qëndrueshëm i resurseve natyrore.

[49] Për të riaktivizuar minierat dhe proceset metalurgjike në Çikatovë dhe Magure ekzistojnë dy pengesa teknike – teknologjike. Problemet e vetme janë sigurimi i fondeve për investim dhe fizibiliteti, duke pasur parasysh gjendjen aktuale energjetike.

[50] Vështirësi në riaktivizimin e eksploatimit të zhavorit në Gremnik paraqesin edhe thellësia e boksiteve dhe shtresat e trasha të gurëve me të cilat janë të mbuluara boksitet dhe të cilat ngrisin edhe më shumë koston e punës

Po ashtu në Ligjin për Energjetikë, si qëllim parësor është edhe promovimi i një menaxhimi racional të burimeve energjetike dhe promovimi i shfrytëzimit të burimeve të ripërtritëshme.

Rregullorja për miniera dhe minerale, (e aprovuar me 21.01.2005), parashikon hartimin e Planit për Menaxhim me Resurse Minerale nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), dhe do t'ia prezantoi Ministrisë për Energjetikë dhe Miniera.

Prioritizimi i problemeve

- Mosrespektimi i ligjeve ekzistuese dhe mungesa e akteve nënligjore;
- Mungesa e kufijve për shkarkime;
- Mungesa e sistemeve menaxhuese për mjedis në sektorë të veçant;
- Mangësitë në procedimet e VNM-së;
- Ndotja e trashëguar nga industria dhe minierat;
- Praktika pamjaftueshme dhe jo adekuate për menaxhimin e mbeturinave;
- Teknologji industriale e vjetruar me performancë të ulët mjedisore;
- Mungesa e instrumenteve ekonomike;
- Mungesa e planit për menaxhimin dhe shfrytëzimin e resurseve minerale.

Objektiva

O1 Të rehabilitohet sektori i industrisë dhe minierave në Kosovë, dukepërcjellur me veprime për sanimin dhe rehabilitimin e "hot spoteve" ekzistuese, dhe evitimin e dëmeve të mëtutjeshme mjedisore në fazën e zhvillimit të Kosovës

Masat

M1 Zhvillimi i legjislacionit dhe sigurimi i organizimit institucional për zbatimin e IPPC;

M2 Reduktimi i emisioneve në ajër, ujë dhe në tokë nga sektori industrial dhe aktivitetet minerare përfshirë këtu edhe rehabilitimin e deponive të vjetra

Objektiva	Aktivitetet		Niveli dhe akteret	Burimet potenciale për financim	Sektorët tjerë me te cilët ndërlidhet	Indikatorët e suksesit
O1	M1	Kompletimi i akteve nënligjore për mbrojtjen e mjedisit	**Qendror** MMPH MEM MTI MEF	BKK Donacione	Ajri Uji Toka Mbeturina Shëndet	Numri i akteve nënligjore të pështatura
O1	M1	Përkrahje institucionale për teknologjitë e pastra dhe burimet e ripërtritshme	**Qendror** MMPH MEF MTT MEM MTI	BKK Donacione Investimet private	Ekonomia Energjetika Mbeturinat Shëndeti	Plani për përkrahjen e projekteve për Burimet e ripërtritshme dhe Efiçienca në energjetikë

O1	M1	Plani i Veprimit të guroreve të Kosovës	**Qendror** KPMM MMPH MTI	BKK Donacione	Biodiversiteti Pylltaria Ujrat	Plani i përgatitur dhe i përshtatur
O1	M1	Studimi mbi zbatimin e SMM (EMS, ISO 9000 dhe 14 000)	**Qendror** MMPH MTI	BKK Donacione	Ekonomi Shëndeti	Studimi i përfunduar
O1	M1	Plani për stimulimin e gjurmimeve shkencore mjedisore në fushën e industrisë dhe minierave	**Qendror** MMPH MASHT UP	BKK Donacione Investime private	Edukimi Ajri Uji Toka	Plani për stimulim të gjurmimeve shkencore
O1	M2	Pilot projekte për ngritjen e eko-efikasitetit në industri	**Qendror** MTI **Lokal** KK Biznesi privat	BKK Donacione Investime private	Bujqësia Energjia Pylltaria Shëndeti	Numri i pilot projekteve të identifikuara
O1	M2	Përparimi i metodave dhe teknikave për ekstraktim dhe prodhim	**Qendror** MMPH MTI MEM Biznesi	BKK Investime private	Bujqësia Energjia Pylltaria Shëndeti	Shkalla e përdorimit të teknikave të përparuara
O1	M2	Involvimi i industrisë si partner në zgjidhjen e problemeve mjedisore	**Qendror** MMPH MTI MEF **Lokal** KK Biznesi	BKK Investimet private	Energjia Shëndeti	Standardet e caktuara të arritura
O1	M2	Zëvendsimi gradual i teknologjive të vjetra	**Qendror** MTI MEF Biznesi	BKK Investimet private	Ajri Uji Toka Energjia Shëndeti	Shkalla e përmirësimit të teknologjisë
O1	M2	Mbyllja apo rivitalizimi i minierave pas proceseve eksploatuese	**Qendror** MMPH MEM KPMM Minierat	BKK Minierat Donacione	Ajri Uji Toka Energjia Shëndeti	Numri i mihjeve të mbyllura dhe të rivitalizuara
O1	M2	Zbatimi i taksave për eksploatim	**Qendror** MMPH MEF MTI MEM	BKK	Bujqësi Pylltari Ujrat	Niveli i mbushjes së Fondit për rehabilitim
O1	M1 M2	Planifikimi i zonave industriale në planin hapësinor	**Qendror** MMPH MTI **Lokal** KK	BKK	Planifikimi hapësinor Bujqësia Toka Shëndeti	Zonat industriale të planifikuara
O1	M1 M2	Zvoglimi i sasisë së mbetjeve industriale dhe të rrezikshme	**Qendror** MMPH MTI MEM **Lokal** Biznesi	BKK Investimet private	Ajri Uji Toka Energjia Shëndeti Ekonomia	Shkalla e zvoglimit të sasisë së mbetjeve dhe rrezikut që paraqesin..

4.12 TRANSPORTI

Një sistem transporti efikas dhe fleksibil është esencial për ekonomi dhe për cilësi më të mirë të jetës. Sistemi i tanishëm i transportit paraqet rrezikshmëri në rritje për shëndetin njerëzor

dhe për mjedisin për arsye të rritjes së madhe të mjeteve të transportit në rrugët tona si e vetmja ne formë kryesore e transportit.

Gjendja e tanishme

Qasja në infrastrukturë të mirë transporti është vitale për lëvizjen e lirë të njerëzve dhe të mirave dhe për këtë është esenciale për rimëkëmbjen ekonomike të Kosovës.

Kosova mbulon një sipërfaqe prej përafërsisht 11,000 km² - me një shtrirje prej 190 km Veri/Jug dhe 150 km Lindje/Perëndim. Territori i Kosovës shërbehet nga një rrjetë prej 1700 km, me rrugë dykahëshe kryesore dhe dytësore (rajonale), 330 km sistem njëbinarësh hekurudhor, në Veri/Jug dhe Veri-Lindje/ Perëndim të Prishtinës dhe me një aeroport rajonal.

Densiteti i rrjetit është relativisht i ulët, përafërsisht 0.35 km/km². Të gjitha këto rrugë kanë nevojë urgjente për riparime për t'i sjellur ato në standarde të pranueshme, së bashku me pajisjet transportuese. Këtë situatë sot e rëndon edhe më shumë, sepse kemi trashiguar një infrastrukturë rrugore të shkatrruar nga lufta e fundit si dhe mungesa e investimeve dhe mirëmbajtjes adekuate gjatë viteve të fund . Pjesa dërmuese e rrjetit rrugore mirëmbahet por në standarde shumë të ulëta. 25% të rrjetit të rrugëve kryesore dhe rajonale kanë nevojë për rehabilitim urgjent[51]. Pas luftës së fundit pasoi një rritje enorme e numrit të automjeteve. Përafërsisht 215.000 automjete të regjistruara[52] dhe një numër i konsiderueshëm i automjeteve[53] të UNMIK-ut dhe KFOR-it. Pjesëmarrja e transportit publik është shumë e vogël. Shumë prej automjeteve në Kosovë janë më të vjetra se 20 vjet, dhe një numër i kosiderueshëm i tyre teknikisht nuk janë në rregull. Në vijim, edhe dukuritë si përdorimi i karburanteve të cilësisë ulët dhe automjete pa sistem katalitik të përshtatshëm janë poashtu mjaft prezent.

Presionet mjedisore

Sektori i transportit është mjaft specifik në raport me mjedisin ngase paraqet ndikime negative serioze gjatë ndërtimit dhe operimit. Transporti ndikon në cilësinë e përgjithshëm të mjedisit në Kosovë (posaçërisht në mjediset urbane) duke ndotur ajrin, ujërat dhe tokave. Gjithashtu transporti kontribuon në ndryshimet klimatike, ndryshimet e peizazhit dhe shfrytëzimit të tokës, përfshirë këtu edhe degradimin e mundshëm të habitateve dhe trashëgimisë kulturore gjatë fazave të ndërtimit. Automjetet e papërdorshëm paraqesin poashtu një rrezik serioz për mjedisin.

Korniza ligjore

Në Kosovë ka tri ligje kryesore të cilat rregullojnë çështjet e transportit:

- Ligji për Transportin Rrugor (2005/23),
- Ligji për Transportin e Materialeve të Rrezikshme (2004/17), dhe
- Ligji i Rrugëve (2003/24). Ligjet janë përgatitur në pajtim me standardet e BE.

Përveç kësaj Kosova është pjesëmarrëse aktive në Vëzhgimet e Transportit të Evropën Jugore Lindore dhe Objektit për Përgatitjen e Projekteve të Transportit.

[51]Efektet e investimeve jo të mjaftueshme gjate viteve 1990-ta dhe dëmet e shkaktuara gjatë konfliktit të 1999 sollën rrugët, urat dhe hekurudhën në Kosovë në një gjendje të mjerueshme. Prej përafërsisht 1,700km rrugë në krahinën e atëhershme, 40 % ishin në gjendje shumë të dobët në fund të vitit 1999. Një rrugë disa kilometërshe mund të zgjaste me orë të tëra për shkak të gropave që nganjëherë ishin shumë të thella.

[52] Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit

[53] Vlerësohet që numri i tyre arrin rreth 15-20% të numrit të plotë të automjeteve të regjistruara

Politika e Transportit të Kosovës dhe Plani janë pjesë të rëndësishme për përgatitjen e Kosovës për proceset e ardhshme të inkuadrimit në BE. Plani i Politikës së Transportit identifikon nevojën për një qasje ndërvepruese të MMPH dhe Ministrisë së Transportit në politika të përbashkëta për zhvillimet urbane dhe transportit, të cilat do të plotësojnë këtë qasje.

Udhëzimi Administrativ për VNM (9/2004) përputhet me Direktivën e amendamentuar të (97/11/EC) mirëpo zbatimi praktik i Direktivës ende është në përgatitje e sipër.

Prioritizimi i problemeve

- Mungesa e planifikimit të integruar (gjithëpërfshirës) hapësinor;
- Mungesa e Politikës së Transportit dhe Planit;
- Praktika jo efikase ekzistuese për VNM dhe VSM;
- Rritja rapide e transportit nga automjetet private;
- Mungesa e monitorimit të ajrit nga sektori i transportit;
- Numri i madh i automjeteve të vjetruara;
- Zhvillim i ulët i transportit publik posaçërisht atij hekurudhor;
- Cilësia e ulët e karburanteve (përmbajtje e lartë e sulfurit);
- Mungesa e rregulloreve për cilësinë e karburanteve.

Objektiva

O1 Të formësohen parimet e zhvillimit të qëndrueshëm në sektorin e transportit

Masat

M1 Hartimi dhe miratimi i nënligjeve të nevojshme në pajtim me nevojat që parashtron legjislacioni i BE;

M2 Reduktimi i emisioneve dhe gazrave ndotëse nga ky sektor;

M3 Përmirësimi dhe ngritja e shërbimeve me transport publik.

Objektiva	Aktivitetet		Niveli dhe akteret	Burimet potenciale për financim	Sektorët tjerë me te cilët ndërlidhet	Indikatorët e suksesit
O1	M1	Miratimi i Politikës së Transportit dhe Planit	**Qendror** MTT	BKK Donacione	Ajri	Dokumenti i përgatitur dhe i miratuar
O1	M1 M2	Të themelohet një Laborator për kontrollin e cilësisë të karburanteve	**Qendror** MTI MTT MMPH	BKK Donacione	Ajri	Laboratori funksional
O1	M1	Miratimi i rregullores për cilësinë e karburanteve dhe kontrollin e cilësisë	**Qendror** MTI MMPH MTT	BKK Donacione	Ajri	Rregullorja e miratuar
O1	M2	Monitorimi i ndikimeve të sektorit të transportit në ndotjen e mjedisit	**Qendror** MTT MMPH **Lokal** KK	BKK Donacione	Ajri Uji Siguria	Raportet mbi studimin e ndikimeve

O1	M2	Studimi mbi numrin dhe kategorinë e mjeteve motorike në Kosovë	**Qendror** MTT MSHP **Lokal** KK	BKK Donacione	Ajri Uji Toka Siguria Mbeturinat	Studimi i publikuar
O1	M1 M2	Zbatimi i ligjeve për transportin e materieve të rrezikshme dhe miratimi i rregullores mbi klasifikimin e rrugëve ku lejohet transporti i materieve të rrezikshme	**Qendror** MTT MMPH MSHP	BKK	Industria Mbeturinat Kimikatet Siguria	Numri i ligjeve të zbatuara Rregullorja e miratuara
O1	M2 M3	Stimulimi i transportit hekurudhor për udhëtar dhe mallra	**Qendror** MTT	BKK Investime	Industria Mbeturinat	Numri i linjave të aktivizuara

4.13 BUJQËSIA

Bujqësia tradicionalisht ka qenë një ndër sektorët më të rëndësishëm në Kosovë. Sot, bujqësia është lënë pas dore dhe shumica e produkteve bujqësore importohen nga jashtë. Edhe pse ka shumë çështje të hapura, kushtet për zhvillimin e bujqësisë të bazuar në parimet organike janë të favorshme.

Gjendja e tanishme

Pas Luftës II Botërore Kosova banohej kryesisht nga një shoqëri rurale ku popullata rurale përbënte 80% të popullatës së përgjithshme. Në 1991, popullsia e Kosovës ishte 63% rurale, dhe vlerësohet së në vitin 2000 përqindja e popullsisë rurale[54] zbriti në 60%. Trendet e ardhshme nuk mund të parashikohen lehtë por duket sikur Kosova tani gjendet në një situatë të urbanizimit të përshpejtuar. Kjo do të zvogëloj numrin e banorëve të vendeve rurale, të cilët do të gjeneronin të ardhurat e tyre nga aktivitetet bujqësore.

Prej 585 000 ha të tokës së punueshme, në 51% të saj kultivohet gruri, 45% janë luadhe dhe kullosa, 2% pemishte dhe më pak se 1% vreshta.

Sektori i bujqësisë në Kosovë është në gjendje shumë të vështirë. Shumë ferma janë të braktisura përderisa edhe infrastruktura është pjesërisht e në disa raste edhe plotësisht e dëmtuar[55].

Kultura bujqësore më e rëndësishëme në Kosovë[56] për periudhën 1981–1996, matur në sipërfaqe, ka qenë misri i cili është kultivuar në një sipërfaqe prej rreth 100 000 ha. E dyta, për nga sipërfaqja kultivuese ishte gruri (70 000 ha). Kultivimi i produkteve tjera pësoi rënie përveç patateve dhe lakrës.

Numri i kafsheve është ngritur prej 1981 dhe 1996, mirëpo me variacione të vogla. Kultivimi i deleve dhe shpezëve ka rënë shumë në periudhën 1981- 1996. Më 1996, në ndërmarrjet shoqërore pothuajse nuk kishte fare blegtori, me përjashtim të derrave. Sipas një studimi[57] të NSH në verën e 2003 pothuajse nuk ka fare ndërmarrje që merren me blegtori. Lloji më i rëndësishëm për kultivim janë lopët me një numër prej rreth 320 000 krerë. Deri më tani, në bazën e të dhënave janë regjistruar 91. 000 fermer apo kultivues.

[54]Sot popullata bujqësore e Kosovës llogaritet rreth 1.3 milion
[55] MBPZHR, Libri i Gjelbër i Kosovës, Prishtina 2003, faqe 9
[56]Statistika Bujqësore Kosovë 2002
[57]Statistika Bujqësore Kosovë 2002

Bujqësia si sektor kontribuon në të GDP e Kosovës me rreth 30%. Kosova nuk përmbush nevojat e popullsisë me prodhimtari vetanake, për këtë 80% e prodhimeve importohen. Deri më tani nuk është kryer kontroll adekuate e produkteve të importuara apo e atyre të kultivuara në vend.

Duke pasur parasysh situatën të tillë, nivelin e përgjithshëm të prodhimtarisë bujqësore dhe nivelin e plehrave të përdorur, në Kosovë duhet të studjohet dhe të vendoset se cili orientim kishte me qenë më i qëlluari. Vlerësohet se bujqësia organike është një mundësi e mirë dhe reale[58].

Presionet mjedisore[59]

Ndikimi mjedisor i shkaktuar nga zhvillimi i prodhimtarisë bujqësore në Kosovë aktualisht është më i ulët se në vendet fqinje. Përdorimi i plehrave dhe kimikateve bujqësore është i ulët[60], për këtë nuk e ndot në masë të madhe ujin dhe tokën. Niveli i mekanizimit është poashtu i ulët kështu që bujqësia ende zhvillohet kryesisht në shkallë të ulët dhe me punë dore e makineri të lehtë. Kjo, po ashtu shkakton ndikim të ulët në mjedis.

Aktivitetet për prodhim organik nuk ndërmerren në formë të organizuar. Shumë ferma të vogla në Kosovë, në fakt, i kanë parakushtet e shkëlqyera për të filluar me aktivitete për prodhim organik, kjo për shkak të përdorimit të ulët të plehrave dhe pesticideve të përdorura gjatë dekadave të fundit dhe zhvillimit të dobët industrial.

Korniza ligjore

Korniza ligjor për bujqësinë përfshinë një numër ligjesh të miratuara, si:

- Ligji për mbrojtjen e natyrës,
- Ligji për farërat (UNMIK/REG/2003/10)
- Ligji për kooperativat bujqësore
- Ligji për plehrat artificiale (UNMIK/REG/2003/22)
- Ligji për planifikim hapësinor (UNMIK 2003/30)
- Ligji për pesticidet (UNMIK/REG/2003/35)
- Ligji për materialin fidanor
- Ligji për veterinarinë (UNMIK/REG/2004/33)
- Ligji për ujëra (UNMIK 2004/24)
- Ligji për mbrojtjen e ajrit (UNMIK 2004/37)
- Ligji për blegtorinë e Kosovës (2004/33).

Instalimet për kultivim intensiv të shpezëve, derrave, lopëve me më shumë se 10 000 krerë shpezësh, 500 derra, 100 lopë, dhe 1000 shtazë të vogla kërkojnë VNM të plotë.

Projekte për ristrukturimin e tokave bujqësore rurale, projekte për shfrytëzimin e tokës jo të kultivuar apo gjysmë natyrale për qëllime bujqësore (ujitja, kullimi i tokës), pyllëzimi apo shpyllëzimi intensiv (me qëllim të ruajtjes së një lloji tjetër të tokës), fermat për rritje intensive të peshqve, instalimet për therjen e shtazëve, deponitë e materialeve të mbetura pas

[58] Siperfaqe te vogla te punueshme, fuqi e lire punetore dhe redukim i mjeteve financiare

[59] Ndikimi kryesor në mjedis mund të jetë në biodiversitet, erozion të tokat, degradim fizik dhe të trashëgimisë kulturore, gjenerimi i mbeturinave bujqësore dhe ndotja e ujërave apo pranuesve nëntokësor dhe sipërfaqësor, me plehra pesticide si dhe me emisione të gazrave nga serrat.

[60] Deri 7 herë më e ulët se mesatarja në BE

trajtimit të ujërave nga kanalizimi, zonat për hedhjen e shtazëve të ngordhura kërkojnë VNM të thjeshtësuar.

Prioritizimi i problemeve

- Mungesa e akteve nënligjore;.
- Mungesa e kontrollit dhe monitorimit të mirëfilltë të importit dhe përdorimit të plehrave dhe pesticideve;.
- Shumica e prodhimeve bujqësore importohen;
- Nuk ka impiante për renderimin (largimi i yndyrës nga mbetjet shtazore) dhe menaxhim i dobët me mbeturinat bujqësore (veçanërisht me mbeturinat shtazore dhe përdorimi i biomasës së mbeturinave);
- Mungesa e trajtimit të ujërave të ndotura të përdorura në bujqësi;
- Sistemi i ujitjes i lënë pas dore;
- Shfrytëzimi i tokave bujqësore për ndërtim dhe qëllime tjera;
- Ndarja (fragmentimi) i tokës dhe të drejtat e pronësisë;
- Mungesa e fondeve për zhvillimin e bujqësisë miqësore ndaj mjedisit.

Objektiva

O1 Të sigurohet zhvillimi i infrastrukturës ligjore, teknike, financiare dhe njerëzore për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor.

Masat

M1 Përfshirja e shqetësimeve mjedisore në sektor

M2 Promovimi dhe përkrahja e prodhimtarisë organike

M3 Rregullimi i shfrytëzimit të plehrave dhe pesticideve

Objektiva	Aktivitetet		Niveli dhe akterët	Burimet potenciale për financim	Sektorët tjerë me te cilët ndërlidhet	Indikatorët e suksesit
O1	M1	Kompletimi i legjislacionit dhe harmonizimi me normat e BE	**Qendror** MBPZHR MMPH	BKK Donacione	Uji Toka Kemikaljet	Legjislacioni është përgatitur dhe përafrimi me BE
O1	M1	Hartimi Planit të Veprimit për Bujqësi	**Qendror** MBPZHR	BKK Donacione	Uji Toka Kemikaljet Planifikimi hapësinor	Plani i Veprimit për Bujqësi i miratuar
O1	M1	Riparimi i rrjetit për ujitje	**Qendror** MBPZHR MMPH **Lokal** Komunat	BKK Donacione Investime private	Uji Toka	Plani për riparimin e rrjetit për ujitje
O1	M1	Zhvillimi i eko-turizmit	**Qendror** MBPZHR MMPH MTI **Lokal**	BKK Investime private	Pylltari Ujrat Toka Biodiversiteti	Numri i pikave eko turistike

			Biznesi			
O1	M2 M3	Zbatimi i instrumenteve nxitëse për zbatimin e metodave alternative për prodhimtari bujqësore dhe kompostim	**Qendror** MBPZHR MMPH Biznesi privat	BKK Donacione Investime	Uji Toka Mbeturinat	Lista e instrumenteve Sasia vjetore e mbetjeve organike të trajtuar dhe kompostuara.
O1	M2	Sigurimi i lehtësimeve për importin e materialeve për bujqësi dhe plasimi i produkteve ushqimore	**Qendror** MBPZHR MMPH MTI MEF	BKK	Pylltari Toka Kemikaljet	Lista e lehtësimeve Sasia e prodhimeve të importuara dhe eksportuara
O1	M1 M2 M3	Mbajtja e metodave tradicionale nëpër ferma	**Qendror** Lokal Biznesi	BKK Donacione Investime private	Pylltari Uji Toka Mbeturinat	Numri i fermave tradicionale
O1	M1 M2 M3	Zhvillimi i programeve trajnuese për fermerët që merren me çështjet e praktikave të mira në bujqësi	**Qendror** MBPZHR MMPH **Lokal** KK	BKK Donacione	Pylltari Uji Toka Vetësdijësimi dhe edukimi	Numri i trajnimeve të mbajtura Numri i fermerëve pjesëmarrës
O1	M1	Zhvillimi i treguesve bujqësor-mjedisor të monitorimit	**Qendror** MBPZHR MMPH	BKK Donacione	Pylltari Uji Toka Mbetjet	Lista e treguesve bujqësor-mjedisor
O1	M2	Vendosja sistemit për çertifikimin e prodhimeve organike	**Qendror** MBPZHR MMPH	BKK Investime private	Transporti	Sistemi i pranuar për çertifikim.

4.14 MENAXHIMI I PYJEVE

Një zgjidhje efikase kundër shkatërrimit të resurseve pyjore në gjithë botn është ndërmarrja e ndonjë hapi drejt menaxhimit të qëndrueshëm me pyje. Shfrytëzimi i qëndrueshëm i pylltarisë sjell barazpeshënë mes të nevojave ekologjike dhe atyre ekonomike duke ofruar një mënyrë alternative përballë formave destruktive të eksploatimit të pyjeve si prerja e pakontrolluar, kullotja e bagëtive dhe lloje tjera të bujqësisë. Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve synon sigurimin e ngritjes së vazhdueshme të cilësisë të prodhimeve të pyllit dhe njëkohësisht ruajtjen esenciale biologjike dhe integritetin ekologjik të pyjeve të shëndosha dhe vetqëndrueshme për një kohë të gjatë.

Gjendja e tanishme

Rreth 47% të gjithë territorit të Kosovës përbëhet nga pyjet, tokat pyjore dhe djerrinat, ose rreth 512.400 ha të sipërfaqes së përgjithshme. Prej kësaj, sipërfaqe pyjore janë 460.800, ose 89.93%, toka tjera pyjore janë 28.200ha ose 5.50%, dhe djerrina 23.400 ha ose 4.57%.

Pyjet në Kosovë paraqesin një resurs shumë të rëndësishëm. Mirëpo si pasojë e menaxhimit jo adekuat të pyjeve në të kaluarën ka ardhur deri të degradimi i pyjeve. Rreth 28.4000 ha ose 61.63% sipërfaqes pyjore është në pronësi publike përderisa pjesa tjetër e mbetur, prej 176.800 ha ose 38.37% është në pronësi private. Sipas të dhënave të Agjencisë Pyjore të Kosovës rreth 222.000 m^3 të drurit teknik dhe drurit për djegie, eksploatohet nga të dyja sektorët në vit. Masa drurore[61] e tërsishme është rreth 54 mil m^3. Vëllimi mesatar i drunjëve për ha është përafërsisht 90 m^3, dhe rritja mesatare vjetore arrin përafërsisht 3 m^3 për ha.

Kërkesat e mëdha për drurin në kohën e pasluftës vendosin presion të madh në qëndrueshmërinë e pyjeve dhe ekosistemeve të Kosovës. Druri kryesisht përdoret për ngrohje dhe ndërtim. Eksploatimi ilegal i pyjeve është një problem i madh dhe nuk ekziston ndonjë zgjidhje alternative për ngrohje. Prerjet ilegale dhe të pakontrolluara kanë shkaktuar edhe erozione në zonat malore. Pyjet janë shkatërruar edhe nga zjarret; sipas Departamentit të Pylltarisë në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, 3.263 ha të pyjeve janë shkatërruar nga zjarri vetëm në vitin 2000.

Presionet mjedisore

- Prerjet ilegale të pyjeve;
- Sëmundjet bimore dhe parazitët e drurëve;
- Struktura cilësore pyjore e dobët;
- Përdorim jo i mjaftueshëm i kapacitetit të tokës pyjore;
- Dëmtimi i pyjeve nga zjarret;
- Implmentim jo i mjaftueshëm i masave sivikulturore;
- Degradimi i tokave pyjore nga eksploatimi i gurit dhe zhavorrit.

Korniza ligjore

Ligji ekzistues për pyjet e Kosovës (2003/6, 2004/9), bazohet në parimet e qendrueshmërisë të vendosura në Konventën e Rio-s. Ky ligj definon pyjet si resurs kombëtar dhe vë bazën për përmirësimin e menaxhimit të pyjeve dhe shfrytëzimin më efikas të tokave pyjore.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjëse për krijimin dhe implementimin e politikave dhe legjislacionit të bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural.

Agjencia Pyjore e Kosovës, e themeluar në vitin 2003, me Ligjin për Pyjet e Kosovës, është përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin me pyje dhe toka pyjore publike si dhe kontrollimin e menaxhimit me pyje dhe tokave pyjore private.

Ristrukturimi organizativ dhe legjislativ është bërë më mbështetjen e FAO-s. Projektet kryesore në pylltari ishin Projekti për Rehabilitim Emergjent të Pylltarisë të Kosovës, Mbështetje institucionale për Institucionet e Pylltarisë dhe projekti për Inventarizimin e Pyjeve nga qeveria e Norvegjisë si dhe projekti "Mbështetja e Arsimimit dhe Trajnimeve në Pylltari" nga Sida e Suedisë.

[61] Të dhëna nga Inventarizimi i pyjeve 2003

Prioritizimi i problemeve

Menaxhimi me pyje dhe toka pyjore ballafaqohet me vështirësi dhe probleme të shumta si:

- Veprimet ilegale në shfrytëzimin e pyjeve dhe tokave pyjore;
- Zbatim i dobët i ligjeve ekzistuese dhe mungesa e akteve tjera nënligjore të nevojshme;
- Mungesa e strategjisë kombëtare për menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve;
- Mungesa e kuadrove profesionale të pylltarisë;
- Mungesa e për ngrohje alternative;
- Mungesa e bashkëpunimit të mirëfilltë mes institucioneve, shoqërisë civile, institucioneve financiare etj.;
- Mungesa e vetëdijës publike për rëndësinë e ekosistemeve pyjore për mjedisin;
- Mungesa e investimeve për mbrojtje dhe zhvillim të pyjeve.

Objektivat

O1 Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve.

Masat

M1 Krijimi i bazës së nevojshme administrativo-ekonomike (Adoptimi i ligjeve dhe akteve nënligjore dhe Strategjisë Kombëtare për Menaxhim të Qëndrueshëm të Pyjeve së bashku me Planin e Veprimit si dhe sigurimi i investimeve).

M2 Përforcimi i kapaciteteve teknike, kadrovike dhe organizativo-institucionale për menaxhimin e pyjeve.

Objektiva	Aktivitetet		Niveli dhe akterët	Burimet potenciale për financim	Sektorët tjerë me te cilët ndërlidhet	Indikatorët e suksesit
O1	M1 M2	Ndalimi i prerjeve dhe dëmtimit të pyjeve	**Qendror** MBPZHR MMPH **Lokal** KK Policia, Gjykatat, Inspekcionet	BKK Donacinet	Bujqësia Biodiversiteti	Masat e ndërmarra për parandalimin e eksploatimit ilegal të pyjeve
O2	M1	Kompletimi dhe zbatimi i legjislacionit	**Qendror** Kuvendi i Kosovës, MBPZHR MMPH **Lokal** KK Policia Gjykatat Inspektorati	BKK Donacione	Bujqësia Biodiversiteti Planifikimi Hapësinor	Ligjet dhe aktet tjera nënligjore të miratuara
O1	M1 M2	Regjistrimi i plotë i ekosistemeve pyjore	**Qendror** MBPZHR MMPH	BKK Donacinet	Bujqësia Biodiversiteti	Regjistri i ekosistemeve pyjore

O1	M1	Hartimi i planeve afatgjata menaxhuese	**Qendror** MBPZHR	BKK Donacinet	Bujqësia Biodiversiteti	Planet e përgatitura
O1	M1	Shpallja e zonave të mbrojtura natyrore	**Qendror** MBPZHR MMPH **Lokal** KK	BKK Donacione	Biodiversiteti Planifikimi hapësinor	Përqindja e territorit të mbrojtur
O1	M2	Përmirësimi i strukturës profesionale në sektor	**Qendror** MBPZHR MASHT	BKK Donacinet	Edukimi	Numri i trajnimeve Numri i pjesëmarësve
O1	M1	Zgjidhja e konflikteve ligjore dhe atyre mbi pronësinë	**Qendror** MBPZHR MMPH MPL **Lokal** KK	BKK		Numri i rasteve të zgjidhura
O1	M2	Identifikim dhe monitorimi i dëmtuesve dhe sëmundjeve të pyjeve	**Qendror** MBPZHR MMPH	BKK Donacione	Biodiversiteti Bujqësia	Dizajnimi, zhvillimi dhe vendosja e sistemit monitorues
O1	M2	Zhvillimi i prodhimtarisë së farave dhe fidaneve pyjore	**Qendror** MBPZHR MTI	BKK Donacione	Bujqësi	Numri i prodhuesve te farave dhe fidaneve
O1	M2	Sanimi preventiv i zonave erozive	**Qendror** MBPZHR MMPH	BKK Donacione	Bujqësi Industri Ujëra Mbeturina	Zonat e sanuara
O1	M1 M2	Hartimi i strategjisë për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri	**Qendror** MBPZHR MMPH	BKK Donacione	Bujqësi Biodiversitet	Strategjia e përgatitur
O1	M2	Pyllëzimi i sipërfaqeve të gjveshura pyjore (1000 ha në vit)	**Qendror** MBPZHR	BKK Donacione	Biodiversitet Bujqësi	Ha e pyllëzuar
O1	M1 M2	Themelimi i Shërbimit për Diagnostifikim Prognozim dhe Raportim, si dhe vendosja e pikave bio-indikative	**Qendror** MBPZHR **Lokal**	BKK Donacione	Biodiversitet	Plani për vendosjene pikave bio indikative
O1	M2	Operimi parandalues dhe vendosja e masave dhe metodave biologjike	**Qendror** MBPZHR MMPH	BKK Donacione	Biodiversiteti	Masat dhe metodat biologjike të vendosura

4.15 EDUKIMI DHE NDËRGJEGJËSIMI

Edukimi, arsimimi dhe ndërgjegjësimi për mjedisin është një proces mjaft kompleks, për ngritjen e ndërgjegjes për mbrojtjen, ruajtjen dhe qëndrimin miqësor ndaj çështjeve dhe problemeve mjedisore. Ky proces nënkupton krijimin e qëndrimit pozitiv dhe të menduarit kritik ndaj të të gjitha dukurive mjedisore në rrethin ku jeton dhe vepron individi. Ky proces, gjithashtu, nënkupton edhe marrjen e qëndrimit ndaj dukurive negative në mjedis si dhe qëndrimin pozitiv dhe kritik ndaj atyre që shkaktojnë dukuri negative për mjedisin ose për pjesë të tij. Gjithashtu, ky proces ka të bëjë edhe me ngritjen e ndjeshmërisë së qytetarëve për të marrë pjesë në të gjitha

proceset e vendimmarrjes lidhur me të ardhmen e mjedisit dhe gjendjen e tij momentale si dhe marrjen e përgjegjësive.

Gjendja e tanishme

Popullsia e Kosovës është shumë e re në moshë. Vendi përballet me shumë probleme socio-ekonomike. Institucionet e edukimit ende janë në ndërtim e sipër të strukturës së qëndrueshme. Edukimi mjediso ende konsiderohet dytësor në procesin e edukimit dhe arsimit.

Planet dhe programet e edukimit dhe arsimit në nivele të ndryshme të shkollimit janë në hartim e sipër, ku parashihet përfshirja e përmbajtjeve mjedisore të bazuara në zhvillim të qëndrueshëm. Format e arsimimit jashtëshkollor, nga lëmi i mjedisit, sidomos të disa grupeve me interes të veçantë (bujqit, konsumatorët, amviset etj.) gati nuk ekzistojnë.

Programet mësimore ekzistuese nuk janë konceptuar në nivel të mjaftueshme me përmbajtje mjedisore. Në shkollat tona mungon ana vepruese e krijimit të shprehive për mbrojtjen e mjedisit. OJQ-të mjedisore kanë efikasitet të vogël për shkak të mungesës së përvojës dhe të mbështetjes financiare.

Mjetet e informimit publik nuk i përcjellin, në nivelin e duhur, problemet mjedisore. Shpesh problematikës së mjedisit i qasen në mënyrë sensacionale, ndërsa edukimi dhe arsimimi për mjedisin në radio dhe televizionet publike dhe lokale është i pamjaftueshëm. Mungon gazetaria hulumtuese në lëmin e mjedisit.

Korniza ligjore

Ligjet që rregullojnë këtë lëmi janë:

- Ligji për mbrojtjen e mjedisit;
- Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm;
- Ligji për arsimin parafillor;
- Ligji për informim;
- Ligji për qasje në dokumentat zyrtare.

Prioritizimi i problemeve

Përfshirja e çështjeve mjedisore dhe e zhvillimit të qëndrueshëm në programet e arsimit nuk është e mjaftueshme. Problemet kryesore janë:

- Ngecje e bashkëpunimit ndërinstitucional në programet e përbashkëta mjedisore;
- Përkrahja e vogël e institucioneve publike për OJQ-t mjedisore që promovojnë edukimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve për çështjet mjedisore;
- Mungesë e informimit medial, të gjithanshëm dhe cilësor të popullatës për të gjitha çështjet mjedisore;
- Mungon zhvillimi i programeve edukative e arsimore afatgjata si dhe fushata për ndërgjegjësim dhe përkrahjen/nxitjen/ e projekteve shkencore të fokusuara në mjedis.

Objektivat

O1 Të integrohen çështjet mjedisore në programet mësimore në të gjitha nivelet e arsimit si lëndë interkurikulare me 0.5% të masës së lëndëve.

O2 Të ngritet përkrahja institucionale dhe financiare e rritjes së nivelit të informimit dhe edukimit të popullatës lidhur me çështjet mjedisore dhe me pasojat nga gjendja e tillë e mjedisit;

O3 Të bëhet përfshirja e çështjeve mjedisore në programe jashtëmësimore3 përmes aktiviteteve të OJQ-ve mjedisore dhe institucioneve që do t'i zbatonin këto programe në shkolla.

Masat

M1 Zbatimi i edukimit dhe arsimit për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm në programet mësimore në shkolla dhe fakultete si dhe të shoqërisë civile me pikësynim aftësimin për pjesmarrje në vendimmarrje;

M2 Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve në të gjitha nivelet për menaxhimin e problemeve mejdisore;

M3 Të nxiten dhe të mbështeten projektet mjedisore në të gjitha nivelet/inatitucionet;

Objektiva	Aktivitetet		Niveli dhe akteret	Burimet potenciale për financim	Sektorët tjerë me te cilët ndërlidhet	Indikatorët e suksesit
O1	M1	Analiza e sasisë dhe e cilësisë së përmbajtjeve edukative të programeve mësimore në lëmin e mjedisit	**Qendror** MMPH MASHT	BKK Donacione	Me të gjithë sektorët	Raporti mbi analizat e përmbajtjeve
O1	M1	Propozimi i përmbajtjeve mjedisore nëpër lëndë mësimore në të gjitha nivelet e edukimit	**Qendror** MMPH MASHT	BKK Donatorët	Me të gjithë sektorët	Sasia e përmbajtjeve të shtuara
O1	M2	Aftësimi i kuadrit mësimor në lëmin e edukimit mjedisor	**Qendror** MMPH MASHT	BKK Donacione	Me të gjithë sektorët	Numri i trajnimeve, % e kuadrit të prëfshirë
O1	M3	Përgatitja e "Paketa e gjelbër" për Kosovën	**Qendror** MMPH MASHT	BKK Donacione	Në të gjithë sektorët	Paketa e Gjelbër e publikuar dhe e shpërndarë
O2	M3	Ngritja e qendrës informative të mjedisit, në kuadër të AKMM	**Qendror** MMPH	BKK Donacione	Në të gjithë sektorët	Qendra informative funksionale
O2	M3	Nxjerrja e revistës informative të MMPH-së	**Qendror** MMPH	BKK Donacione	Të gjithë sektorët	Numri publikimeve brenda vitit
O2	M2	Begatimi i vazhdueshëm i Web-faqes së MMPH-së	**Qendror** MMPH	BKK	Të gjithë sektorët	Numri i artikujve/rubrikave të reja/
O3	M3	Mbështetja e OJQ-ve për, realizimin e projekteve mjedisore	**Qendror** MMPH **Lokal**	BKK Donacione	Të gjithë sektorët	Numri i OJQ-ve funksionale, Numri i projekteve të realizuara dhe financuara

4.16 MENAXHIMI I INTEGRUAR HAPËSINOR

Trajtimi profesional i integruar i hapësirës kosovare duhej të ishte njeri nga faktorët shumë të rëndësishëm qe do të ndikonte në mbrojtjen e mjedisit duke marr parasysh gjendjen shqetësuese mjedisore të tanishme si pasojë e veprimeve të e pakontrolluara në hapësirën prej 10887 km². Sipas legjislacionit ekzistues të planifikimit hapësinor problematika e mjedisit është e përcjellë në të gjitha fushat e veprimit - mbetet vetëm implementimi i ligjit në të ardhmen si fazë shumë delikate për rrethanat tona. Plani Hapësinor i Kosovës si dhe planet e nivelit komunal sipas ligjit dhe akteve nënligjore janë të obliguar të marrin në konsideratë të gjithë problematikën mjedisore natyrisht në koordinim me departamentin e mjedisit si dhe me faktorët tjerë relevant. Në princip duhet përkrahur të gjitha ato kërkesa mjedisore të cilat janë reale, të domosdoshme dhe të zbatueshme për rrethanat tona.

Gjendja e tanishme

Hapësira e Kosovës asnjëherë nuk ka qenë në mënyrë të drejtë e trajtuar, pasi ndikimi i zhvillimit industrial i viteve 70-ta të shekullit të kaluar fare nuk ka respektuar ndikimet negative në mjedis.

Procesi i urbanizimit të pa planifikuar si dhe migrimet e popullsisë për shkaqe ekonomike, ka ndikuar në braktisjen e bujqësisë si sektor shumë i rëndësishëm në zhvillimin e përgjithshëm të vendit. Pas luftës së vitit 1998/99, si rezultat i lëvizjes së popullsisë në relacionin fshat-qytet ballafaqohemi me ndryshime të mëdha demografike në zonat urbane si dhe zgjerimin e pa kontrolluar të këtyre zonave, posaçërisht në qytetet kryesore dhe kryeqendrën, Prishtinën, siç thuhet, si caku i "shpëtimit" për shumë banorë të zonave periferike dhe qyteteve tjera. Të gjitha këto kanë ndikuar në shpenzimet e mëdha të funksionimit të qyteteve, braktisjen dhe shkatërrimin e fshatrave si dhe në organizimin jo racional të hapësirës me probleme të cilët drejtpëdrejt ndikonin në mjedis.

Në qytetet ku kemi koncentrimin më të madh të popullsisë, ballafaqohemi me degradimin e mjedisit urban, si rezultat i ndërtimeve të pa kontrolluara, moskujdesi ndaj hapësirave publike, mos adoptimi i infrastrukturave publike kushteve reja, mungesa e zonave atraktive si: kopshtet zoologjike,botanike e të ngjashme.Të gjitha këto, aktualisht paraqesin probleme serioze mjedisore . Kur kësaj i shtojmë edhe mostrajtimin e problemeve serioze në relacionin fshat- qytet ku partneriteti në mes tyre në një masë të madhe do të zbuste problematikën e trajtimit të hapësirës dhe mjedisit, atëherë lirisht mund të konstatojmë së trajtimi i integruar i hapësirës duhet të ketë vendin dominant në procesin e veprimeve në mjedis.

Në përgjithësi për menaxhimin e integruar të hapësirës kosovare mund të konstatojmë:

- Është i domosdoshëm zbatimi i GIS teknologjisë në nivelin qendror dhe lokal për të përcjell intervenimet në hapësirë të cilat ndikonin në mbrojtjen e mjedisit.
- Ndërtime të pa kontrolluara si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale, si dhe afër akseve të rrugëve kryesore, drejtpërdrejt ndikojnë në rrezikimin e mjedisit, në veçanti shkatërrimin e sipërfaqeve të gjelbëruara nëpër zonat urbane.
- Trajtimi dhe shfrytëzimi i hapësirave publike është minimal posaçërisht në zonat urbane.
- Infrastrukturat nuk përcjellin zgjerimet e zonave urbanë,çfarë drejtpërdrejt ndikon në ndotjen e mjediseve urbane dhe rurale.

- Zhvillimi jo i barabartë rajonal si dhe mos trajtimi i partneriteti urbano – rural direkt ndikon në migrimet e pa kontrolluara të popullsisë, si rezultat i së cilës kemi kaosin urbanistik në vendbanimet urbane dhe qendrat rurale me implikime serioze në mjedis.
- Është evidente mungesa e zonave atraktive si kopshteve zoologjike,botanike e të ngjashme të cilët do të zbusnin problemet mjedisore sidomos në zonat urbane.
- Mos respektimi i kritereve mjedisore gjatë përgatitjes së dokumenteve hapësinore, të cilat janë të parapara me Ligjin e Planifikimit Hapësinor (neni 28).

Korniza ligjore

Ligjet të cilat duhet zbatuar pasi janë miratuar nga Kuvendi i Kosovës si dhe nga PSSP (UNMIK):

- Ligji për Planifikim Hapësinor (2003/30)-së bashku me aktet nënligjore promovon principet e planifikimit të qëndrueshëm dhe të barabartë të hapësirës, si dhe trajton si shumë të rëndësishme kyçen e problemeve mjedisore gjatë përpilimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor.
- Ligji për Ndërtimin (nr 2004/15), përcakton kriteret e ndërtimeve duke respektuar mjedisin (nga ligji pë Ndërtimit janë miratuar vetëm dy akte nënligjore, të tjerët janë në procedurë).
- Ligji për Ujëra (2004/24),
- Ligji për Rrugë (2003/11),
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës (i miratuar nga Kuvendi i Kosovës),
- Ligji për pyje, (2003/6, 2004/9),
- Ligji për Gjuetinë - i miratuar në Kuvend,
- Vendime për mbrojtjen e disa llojeve të faunës dhe florës.

Për të pasur sukses në arritjen e qëllimeve sipas ligjeve aktuale dhe atyre që do të miratohen do të bëjmë kategorizimin e qëllimeve në tri grupe:afatshkurta, afatmesme dhe afatgjate.

Qëllimet afat shkurtëra:

- Ndërprerja e menjëhershme e ndërtimeve të pa kontrolluara - pa leje ndërtimi,
- Hartimi i rregullores për trajtimin e ndërtimeve ilegale,
- Përfundimi i akteve nënligjore të parapara në Ligjin e Planifikimit Hapësinor dhe në Ligjin për ndërtim,
- Trajnimi i planerëve hapësinorë të kyçur në procesin e përgatitjes së dokumenteve hapësinore,
- Aftësimi dhe trajnimi i ekspertëve të nivelit qendror dhe të atij lokal në fushën e GIS.

Qëllimet afat mesme:

- Përpilimi i planeve hapësinore në nivelin lokal dhe qendror,
- Përpilimi i planeve hapësinore për zona të veçanta e posaçërisht për eko sistemet,

- Përgatitja e kornizës së plotë ligjore dhe Udhëzuesve për zbatimin e Ligjeve ekzistuese dhe trajnimi për rol-huajtësit,
- Forcimi i kapaciteteve në nivelin qendror dhe lokal si dhe trajnimet sistematike të zyrtarëve në grupe të veçanta.

Qëllimet afat gjata:

- Kujdesi permanent i trajtimit dhe aplikimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor e posaçërisht të zonave të veçanta ku përfshihet problematika e mbrojtjes së mjedisit.
- Aplikimi dhe avancimi i rregullativave dhe standardeve ndërkombëtare në fushën e menaxhimit të integruar të hapësirës.
- Vetëdijesimi i popullsisë për trajtim adekuat te hapësirave të përbashkëta,
- Formimi dhe favorizimi i institucioneve hulumtuese që do të përcjellin dhe propozonin format bashkëkohore të zhvillimit të barabartë të mjedisit në tërë territorin e Kosovës duke u bazuar në dokumentet aktuale ndërkombëtare dhe të BE.
- Monitorimi dhe inspektimi i zbatimit te ligjeve dhe rregulloreve.
- Përgatitja e planeve të veprimit për rregullimin e infrastrukturës dhe mobiliarit urban në territorin e Kosovës.
- Ngritja e policisë ndërtimore.

Për trajtimin dhe realizimin e këtyre qëllimeve nevojitet mobilizimi maksimal i të gjithë pjesëmarrësve në proces duke përfshirë të gjitha institucionet përgjegjëse qeveritare, shoqërinë civile etj.

Prioritizimi i problemeve

- Mungesa e profileve profesionale në lëmin e planifikimit të integruar të hapësirës;
- Mos zbatimi i ligjeve të miratura nga organet relevante, si dhe të ligjeve aktuale të aplikueshme;
- Mungesa e instrumenteve ekonomike për përmirësimin e mjedisit dhe planifikimit hapësinor;
- Mungesa e investimeve në infrastrukturën teknike duke respektuar mbrojtjen e mjedisit, e posaçërisht trashëgiminë kulturore dhe natyrore;
- Mungesa e strategjisë së zhvillimit të barabartë hapësinor të territorit të Kosovës;
- Mungesa e investimeve në ngritjen e kopshteve zoologjike dhe botanike në nivel qendror dhe lokal;
- Mungesa e planeve afat gjata të zhvillimit të integruar të hapësirës;
- Ndërtime të pa kontrolluara si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale, si dhe afër akseve të rrugëve kryesore, drejtpërdrejt ndikonin në e mjedis,në veçanti në shkatërrimin e sipërfaqeve të gjelbëruara nëpër zonat urbane;
- Shfrytëzimi joadekuat i hapësirave publike në zonat urbane;
- Infrastrukturat nuk përcjellin zgjerimet e zonave urbanë, çfarë ndikon në ndotjen e mjediseve urbane dhe rurale;
- Zhvillimi jo i barabartë rajonal si dhe mos trajtimi i partneriteti urbano – rural drejtpërdrejti ndikon në migrimet e pa kontrolluara të popullsisë si rezultat i se cilës

kemi kaosin urbanistik në vendbanimet urbane dhe qendrat rurale me implikime serioze në mjedis;

- Mos respektimi i kritereve mjedisore gjatë përgatitjes së dokumenteve hapësinore të cilat janë të parapara me Ligjin e Planifikimit Hapësinor;

Objektiva

O1 Të sigurohet zbatimi i Ligjit të Planifikimit Hapësinor si dhe kushteve teknike (GIS- teknologjisë) dhe atyre financiare , kapaciteteve njerëzore për vendosjen e bazës për menaxhimin e integruar të hapësirës, në bashkëpunim me pjesëmarrësit e tjerë në proces, duke respektuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Masat

M1 Vendosja e bazës ligjore, si dhe ngritja e kapaciteteve institucionale dhe njerëzore për menaxhim të integruar dhe të qëdrueshëm të hapësirës

Objektiva	Aktivitetet		Niveli dhe akteret	Burimet potenciale për financim	Sektorët tjerë me te cilët ndërlidhet	Indikatorët e suksesit
O1	M1	Hartimi rregullativës ligjore nga fusha e planifikimit hapësinor dhe ndërtimit	**Qendror** MMPH **Lokal** KK	BKK Donacione	Korniza ligjore Vetëdijesimi	Numri i ligjeve dhe akteve nënligjore
O1	M1	Miratimi i dokumenteve të planifikimit hapësinor në të dy nivelet	**Qendror** MMPH **Lokal** KK	BKK	Tokat Bujqesia Biodiversiteti Transporti	Numri i dokumenteve të përgatitura
O1	M1	Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve ne të dy nivelet e planifikimit hapësinor	**Qendror** MMPH **Lokal** KK	BKK Donacione	Edukimi	Numri i trajnimeve Numri i pjesëmarrësve
Furnizimi me software-ë të përshtatshëm, takimi i punës me qëllim trajnimi 2 ditorë teknik dhe për instalim për 10 anëtarë të ekipit nga IKMN & MMPH (10 ditë eksperti ndërkombëtar + 10 ditë eksperti vendor për instalimin e software-it + software-i + shpenzimet e takimit të punës)	4 muaj	MMPH (IKMN), UP, MBPZHR	1,200	11,550	12,750
Përtrirja e shënimeve për zonat ekzistuese të mbrojtura dhe atyre që parashihet të mbrohen në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare (IUCN) – 1 koordinator me orar të plotë në MMPH, 44 ditë pune ekspertët vendorë, 22 ditë pune eksperti ndërkombëtar.	6 muaj	MMPH (IKMN), UP, MBPZHR	1,800	27,250	29,050
Takime të punës me qëllim trajnimi (3 ditore) për menaxherët e zonave të mbrojtura, mbikqyrësit dhe punëtorët e tjerë relevant pranë MMPH-IKMN për zbatimin e standardeve për mbrojtjen e natyrës, legjislacionin e BE dhe mbrojtjen e llojllojshmërisë biologjike – shpenzimet e takimit të punës + 10 ditë eksperti ndërkombëtar.	1 muaj	MMPH (IKMN), UP, MBPZHR	300	10,500	10,800
TOTALI			**4,500**	**49,300**	**53,800**

Titulli i projektit:

Sajimi i një Liste të Kuqe dhe Libri të Kuq të të dhënave për llojet e rrezikuara në territorin e Kosovë

Kohëzgjatja e projektit: 2 vite	**Data e propozuar për fillimin e projektit:** 2007
Nisma nga: MMPH – Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit	**Do të zbatohet nga:** MMPH – Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit

Vendi: Kosovë	
Qëllimet/synimet: – Identifikimi i llojeve të rrezikuara dhe klasifikimi i tyre në bazë të shkallës së rrezikut në përputhshmëri me kriteret e IUCN	**Të dhënat themelore (situata aktuale):**. – Në bazë të studimeve që janë kryer para pak kohe janë evidentuar gati 1800 lloje të florës. Ekziston supozimi se ky numër është shumë më i madh dhe arrinë deri në 2,500 lloje. – Vlerat natyrore të Kosovës janë shfrytëzuar me shekuj, megjthatë ato kanë përjetuar ndryshime të mëdha gjatë shekullit të kaluar, posaçërisht gjatë dekadës së fundit, falë zhvillimit të industrisë dhe komunikacionit të kombinuar me shtimin e popullsisë dhe vetëdijen e ulët ekologjike. – Ligji mbi Mbrojtjen e Natyrës është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në mars të vitit 2005. – Mungesa e strategjisë dhe planit për veprim për mbrojtjen e llojllojshmërisë biologjike.
Caqet/Rezultatet që priten: – Krijimi i sistemit të standardizuar për identifikimin e llojeve të rrezikuara. – Krijimi i pikave të references prej do të bëhet monitorimi i gjendjes së llojeve në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare.	**Treguesit/njësia matëse:** – Shënimet më të reja për lojet e rrezikuara. – Hartimi dhe vënia e planit për menaxhimin e llojeve të rrezikuara. në dispozicion të të gjitha palëve të interesuara – Pjesëmarrja aktive në proces e komunave dhe e organizatave joqeveritare.
Trupi monitorues: MMPH (IKMN), Universiteti, ekspertët ndërkombëtarë, OJQ-të	
Buxheti i përgjithshëm i propozuar: 60,810 EUR	

Aktivitet që do të financohen:	**Kohëzgjatja**	**Trupi/personi përgjegjës**	**Buxheti i brendshëm (muaj* paga në EUR)**	**Buxheti i jashtëm (EUR)**	**Buxheti total**
Vendosja e kontaktit direkt me IUCN, rishikimi i të dhënave dhe dokumenteve ekzistuese, takime punuese me IUCN mbi kushtet për përgatijen e listës së kuqe – vizitë 5 ditore e stafit të IUCN në Prishtinë.	3 muaj	MMPH, IKMN, IUCN	900	5,000	5,900
Formimi i grupit për projekt të përbërë nga ekspertët kosovarë, stafit të IKMN, stafit nga zona e mbrojtur dhe 1 ekspert ndërkombëtar.	2 muaj	MMPH, IKMN	600		600

Hartimi i planit të punës për identifikimin dhe evidentimin e llojeve në bazë të udhëzimeve të IUCN – Manual për punë në terren në gjuhën shqipe – 15 ditë eksperti ndërkombëtar, 15 ditë eksperti vendor, 1 muaj stafi i MMPH/IKMN.	1 muaj	MMPH, IKMN	300	16,250	16,550
Puna në terren dhe përgatitja e Listës së Kuqe – 22 ditë eksperti ndërkombëtar, 50 ditë ekspertët vendorë.	6 muaj	MMPH, IKMN	1,800	26,200	28,000
Takimet informative (4 komuna) dhe ngjarje mediale për publikimin e Listës së Kuqe dhe gjendjen e llojeve.	2 muaj	MMPH, IKMN	600	260	860
Publikimi dhe shpërndarja e dokumentit informativ përfshirë Listën e Kuqe (25 faqe, A5, 400 kopje, 20 EUR/kopje).	3 muaj	MMPH, IKMN	900	8,000	8,900
TOTALI			**5,100**	**55,710**	**60,810**

Titulli i projektit:

Përgatitja e Strategjisë në nivel të Kosovës për mbrojtjen e llojllojshmërisë biologjike dhe ngritja e vetëdijes së opinionit për këtë qëllim

Kohëzgjatja e projektit: 15 muaj	**Data e propozuar për fillimin e projektit:** 2007
Nisma nga: MMPH	**Do të zbatohet nga:** MMPH
Vendi: Kosovë	

Qëllimet/synimet:	**Të dhënat themelore (situata aktuale):**
– Hartimi i strategjisë dhe Planit për Veprim për mbrojtjen e llojllojshmërisë biologjike. – Identifikimi i të gjitha problemeve që u kërcnohen vlerave natyrore të Kosovës. – Caktimi i prioriteve në zgjidhjen e problemeve. – Zëvendësimi i prioriteteve me veprime konkrete. – Informimi i opinionit të gjërë për Strategjinë në nivel të Kosovës për Mbrojtjen e Llojllojshmërisë Biologjike dhe sigurimi i pjesëmarrjes së opinionit aty ku është e mundur.	– Kosova me vlerat e saj natyrore dhe estetike, me një fond gjenetik të llojeve bimore dhe shtazore është një nga zonat me rëndësi të posaçme edukative, kulturore dhe rekreative në Ballkan. – Kosova posedon një llojllojshmëri relativisht të pasur biologjike. – Dokumentet ekzistuese ligjore jane Ligji mbi Mbrojtjen e Ambientit, Strategjia për Mbrojtjen e Ambientit dhe Plani për Veprim për Mbrojtjen e Ambientit në Kosovë. – Ligji mbi Mbrojtjen e Natyrë I miratuar në Kuvendin e Kosovës. Ky ligj paraqet zhvillimin e Strategjisë dhe Planit për Veprim për Mbrojtjen e Mjedisit.
Caqet/Rezultatet që priten:	**Treguesit/njësia matëse:**
– Evidentimi i gjendjes reale të trashëgimisë natyrore dhe kulturore. – Identifikimi i problemeve prioritare. – Definimi i masave dhe veprimeve që duhen ndërmarrë drejt zgjidhjes së problemeve të identifikuara, duke përfshirë këtu edhe përcaktimin e kornizës kohore dhe sigurimin e fondeve.	– Përgatitja e strategjisë Kombëtare (shtetërore) për mbrojtjen e llojllojshmërisë biologjike me Planin për Veprim. – Zbatimi i fushatës për informimin e opinionit të gjërë dhe ngritjen e vetëdijes së tij.
Trupi monitorues: MMPH-IKMN	
Buxheti i përgjithshëm i propozuar: 106,000 EUR	

Aktivitet që do të financohen:	**Kohëzgjatja**	**Trupi/personi përgjegjës**	**Buxheti i brendshëm (muaj* paga në EUR)**	**Buxheti i jashtëm (EUR)**	**Buxheti total**
Përgatitja e Pikave të Referencës për sajimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit për Veprim për Mbrojtjen e Natyrës dhe Llojllojshmërisë Biologjike.	3 muaj	MMPH-IKMN	900		900
Formimi i ekipit për projekt nga stafi i MMPH-IKMN, ekspertëtë vendorë dhe ekspertiza e përkohshme ndërkombëtare.	2 muaj	MMPH-IKMN	600		600

Grupe punuese sipas temave të shqyrtuara, të kryesuara nga ekipi i MMPH dhe IKMN, ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë punojnë në kapitujt e Strategjisë (5 punëtorë të MMPH-IKMN, 5*30 ditë ekspertiza ndërkombëtare).	6 muaj	MMPH-IKMN	9,000	65,200	74,200
Përgatitja e 5 Planeve për Veprim për temat/zonat kryesore – 5 punëtorë të MMPH/IKMN plus 50 ditë ekspertiza vendore.	6 muaj	MMPH-IKMN	9,000	8,500	17,500
Përezantime dhe diskutime publike mbi draftin e strategjisë dhe planet për veprim – 4 takime në komunat relevante + 1 në nivel qendror – 20 pjesëmarrës në secilin prej tyre, pijet freskuese dhe qiraja për dhomën.	1 muaj	MMPH-IKMN	300	700	1,000
Finalizimi i dokumenteve dhe bërja publike e tyre sa më gjërë, përfshirë fletepalosjen përmbledhëse prej 5 faqesh, 1000 kopje të shpërndara (7 EUR/kopje).	3 muaj	MESP-IKMN	900	7,000	7,900
Dizajnimi i faqes në Internet për mbrojtjen e llojllojshmërisë biologjike dhe të natyrës, të lidhur me faqen e Internetit të MMPH – përfshirë këtu trajnimin e ekipit të MMPH-IKMN për futje të rregullt të informatave (2 muaj stafi i MMPH-IKMN plus 20 ditë ekspertët vendorë.)	2 muaj	MMPH-IKMN	600	3,300	3,900
TOTALI			**21,300**	**84,700**	**106,000**

Titulli i projektit:

Evidentimi (shënimet e detajuara) për florën dhe faunën në Bjeshkët e Nemuna

Kohëzgjatja e projektit: 2 vite	**Data e propozuar për fillimin e projektit:** 2007
Nisma nga: MMPH – IKMN	**Do të zbatohet nga:** MMPH – Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit
Vendi: Pejë, Burim, Gjakovë, Deçan	

Qëllimet/synimet:	**Të dhënat themelore (situata aktuale:**
– Mbledhja e të dhënave kërkimore që ekzistojnë mbi florën dhe faunën në Bjeshkët e Nemuna – Kompletimi i shënimeve të detajuara mbi llojet dhe biotopet – Përgatitja e hartës ku janë paraqitur zonat më të rëndësishme – Hulumtimi i burimeve natyrore me vlera turistike – Paraqitja e të gjitha të dhënave të mbledhura me qëllim të ngritjes së vetëdijes për mbrojtjen e tyre. – Definimi i pikave kritike të natyrës së Bjeshkëve të Nemuna. – Inicimi i bashkëpunimit përtej kufirit me Shqipërinë dhe Malin e Zi	– Zonat më të pasura me florë dhe faunë në Kosovë janë Malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna. – Territori i BN njihet për llojllojshmërinë biologjike dhe pamjet pitoreske falë pozitës gjeografike, kushteve gjeologjike, pedologjike dhe hidrologjike si dhe karakteristikat e tij qëtësuese dhe klimës së tij. : – Disa zona të Bjeshkëve të Nemuna tashmë janë vënë nën mbrojtje ligjore, shih tabelën:
Caqet/Rezultatet që priten:	**Treguesit/njësia matëse:**
– Një regjistër elektronik (bazë e të dhënave për) i florës dhe faunës, i llojeve të bimëve dhe shtazëve në Bjeshkët e Nemuna. – Përmbledhja e të dhënave ekzistuese. – Kategorizimi i zonave me vlerë të lartë në bazë të IUCN. – Kategorizimi i zonave në bazë të nivelit të rrezikut për llojet dhe vendbanimet e tyre. – Hartat e biotopeve – Fillimi i bashkëpunimit përtej kufirit.	– Evidentimi i llojeve të bimëve dhe shtazëve dhe i vendbanimeve të tyre. – Organizimi i të dhënave ekzistuese në baza elektronike të të dhënave. – Numri i vizitave në terren dhe i hulumtimeve të realizuara. – Kryerja e kategorizimit të zonave. – Paraqitja e biotopeve në harta (%) – Numri i takimeve me përfaqësuesve rajonal dhe fillimi i bashkëpunimit .
Trupi monitorues: MMPH-IKMN	
Buxheti i përgjithshëm i propozuar: 126,750 EUR	

Aktivitet që do të financohen:	**Kohëzgjatja**	**Trupi/personi përgjegjës**	**Buxheti i brendshëm (muaj* paga në EUR)**	**Buxheti i jashtëm (EUR)**	**Buxheti total**
Përgatitja e Pikave të Referencës për evidentimin e llojeve në përputhshmëri me standardet e IUCN	3 muaj	MMPH-IKMN	900		900
Formimi i ekipit për projekt nga ekipi i MMPH-IKMN, ekspertët vendorë dhe ekspertiza ndërkombëtare.	2 muaj	MMPH-IKMN	600		600
Rishikimi i të dhënave, raporteve, materialeve ekzistuese – shkëmbimi i tyre me ekspertët ndërkombëtar.	1 muaj	MMPH-IKMN	300	4,800	5,100

Dizajnimi i fushatës për evidentim/hulumtim nën mbikqyrjen e ekspertit ndërkobmëtar, përfshirë këtu trajnimin 5 ditor të organizuar për ekipin e projektit mbi atë se si të bëhet evidentimi, zhvillimi i punës ekipore dhe raportimi i kushteve (kërkesave) (5 ditë, 20 pjesëmarrës) – 22 ditë TA ndërkombëtar + 6 ekspertë vendorë +14 anëtarë të stafit të MMPH-IKMN.	2 muaj	MMPH-IKMN	8,400	25,300	33,700
Kryerja e punës në terren në zonat e mbrojtura – 14 anëtarë të ekipit të MMPH-IKMN, 4 muaj secili prej tyre me gjysmë orari, 6 ekspertë vendorë, 22 ditë secili prej tyre, mbikqyrja nga eksperti ndërkombëtar, 10 ditë plus shpenzimet e përafërta të udhëtimit brenda vendit.	4 muaj	MMPH-IKMN	8,400	24,200	32,600
4 takime konsultative 1 ditore për diskutimin e rezultateve të hulumtimeve brenda ekipit për projekt dhe me ekspertët e jashtëm vendorë – 20 pjesëmarrës në secilin prej tyre, dhoma e mbledhjeve në MMPH.	1 muaj	MMPH-IKMN	300	2,400	2,700
Hartimi i raportit final, të përbërë nga një grup raportesh nën mbikqyrjene ekspertit ndërkombëtar dhe drejtuesit të projektit pranë MMPH – 2 muaj ekipi i MMPH për koordinim + 1 muaj, 7 anëtarë të stafit që punojnë në raportet e tyre mbi temat e veçanta + 30 ditë pune për ekspertin ndërkombetar + 10 ditë pune për 6 ekspertë vendorë.	2 muaj	MMPH-IKMN	2,700	31,550	34,250
Botimi i librit për florën, faunën dhe biotopet e Bjeshkëve të Nemuna – 200 faqe, me ngjyra, 500 kopje, 32 EUR/kopje.	3 muaj	MMPH-IKMN	900	16,000	16,900
TOTALI			**22,500**	**104,250**	**126,750**

Titulli i projektit:

Evidentimi i florës dhe faunës në Malet e Sharrit

Kohëzgjaja e projektit: 2 vite	**Proposed start date:** Shtator 2006
Nisma nga: MMPH – Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit	**Do të zbatohet nga:** MMPH – Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit
Vendi: Malet e Sharrit	
Qëllimet/synimet: – Të mblidhen të gjitha të dhënat ekzistuese për florën dhe faunën në Malet e Sharrit në një bazë elektronike të të dhënave. – Të përtrihen shënimet për llojet dhe biotopet.	**Të dhënat themelore (Situata aktuale):** Në bazë të hulumtimeve të fundit të kryera në Kosovë janë evidentuar rreth 1.800 lloje të florës, por supozohet se numri mund të arrijë deri në 2.500 lloje. Ajo çka e bënë florën dhe faunën e Kosovës të rëndësishme dhe atraktive është numri i madh i llojeve

– Të bëhet paraqitja në hartë e botopeve dhe zonave me llojllojshmëri biologjike në Sharr. – Të definohen vendet potenciale për nisma të qëndrueshme turistike. – Të inicohet dhe të promovohet bashkëpunimi përtej kufirit me autoritetet relevante në Republikën e Maqedonisë dhe atë të Shqipërisë.	të ndryshme endemike, relikte dhe gjysmë endemike. Malet e Sharrit kanë llojllojshmëri të madhe biologjike shumë të pasur me lloje të faunës dhe me vegjetacione. 86 nga këto lloje janë me rëndësi shtetërore, 26 janë përfshirë në listen e kuqe evropiane të bimëve dhe shtazëve dhe 32 prej tyre janë në listen e kuqe të IUCN si lloje të rrezikuara. Në bazë të këtyre fakteve këto male mund të konsiderohen si qendër e llojllojshmërisë në Evropë. Një pjesë e Maleve të Sharrit tashmë është shpallur si park nacional në vitin 1986. Kjo sipërfaqe përbëhet nga 39,000 ha dhe përfshinë kufinjtë e katër komunave, Prizrenit, Shtërpcës, Therandës dhe Kaçanikut. .Në bazë të IUCN Malet e Sharrit janë regjistruar në listen e zonave ndërkombëtare të mbrojtura. Kjo zone ka mbi 2000 lloje të identifikuara bimësh dhe mbi 230 lloje të larta të kurrizorëve, por ende nuk është bërë evidentimi i plotë.
Caqet/Rezultatet që priten: – Baza gjithëpërfshirëse e të dhënave për llojet e bimëve dhe të shtazëve në Malet e Sharrit – Përtrirja dhe përfshirja e të dhënave ekzistuese. – Kategorizimi i zonave me vlera të larta në bazë të IUCN I – Kategorizimi i zonave në bazë të nivelit të rrezikut që u kërcnohet llojeve dhe vendbanimeve të tyre. – Hartat e biotopeve – Fillimi i bashkëpunimit përtej kufirit	**Treguesit/njësia matëse:** – Kryerja e evidentimit të llojeve të bimëve dhe shtazëve dhe përfshirja e tyre në bazat elektronike të të dhënave. – Ripunimi i të dhënave ekzistuese. – Numri i zonave të vizituara dhe i hulumtimeve që janë bërë. – Kategorizimi i zonave – Paraqitja e biotopeve në harta (%) – Numri i takimeve me përfaqësuesit nga matanë kufirit dhe vendosja e bashkëpunimit fillestar.
Trupi monitorues: MMPH-IKMN	
Buxheti i përgjithshëm i propozuar: 126,750 EUR	

Aktivitet që do të financohen:	**Kohëzgjatja**	**Trupi/personi përgjegjës**	**Buxheti i brendshëm (muaj* paga në EUR)**	**Buxheti i jashtëm (EUR)**	**Buxheti total**
Përgatitja e Pikave të Referencës për evidentimin e llojeve në përputhshmëri me standardet e IUCN	3 muaj	MMPH-IKMN	900		900
Formimi i ekipit për projekt nga stafi i MMPH-IKMN, ekspertët vendorë dhe ekspertiza ndërkombëtare.	2 muaj	MMPH-IKMN	600		600
Rishikimi i të dhënave, raporteve, materialeve ekzistuese – shkëmbimi i tyre me ekspertët ndërkombëtar (5 ditë)	1 muaj	MMPH-IKMN	300	4,800	5,100

Dizajnimi i fushatës për evidentim/ hulumtim nën mbikqyrjen e ekspertit ndërkombëtar, përfshirë këtu trajnimin 5 ditor të ekipit për projekt mbi atë se si duhet të bëhet evidentimi, zhvillimi i punës ekipore & raportimi i kushteve (kërkesave) (5 ditë, 20 pjesëmarrës) – 22 ditë TA ndërkombëtar + 6 ditë ekspertët vendorë + 14 anëtarë të MMPH	2 muaj	MMPH-IKMN	8,400	25,300	33,700
Puna në terren në zonat e mbrojtura – 14 anëtarë të stafit të MMPH-IKMN, 4 muaj secili prej tyre me gjysmë orari, 6 ekspertë kosovarë, 22 ditë secili prej tyre, mbikqyrja nga eksperti ndërkombëtar, 10 ditë plus shpenzimet të udhëtimit brenda vendit.	4 muaj	MMPH-IKMN	8,400	24,200	32,600
4 takime konsultative 1 ditore për diskutimin e rezultateve të hulumtimeve brenda ekipit për projekt dhe me ekspertët e jashtëm dhe vendorë – 20 pjesëmarrës në secilin prej tyre, dhoma e mbledhjeve në MMPH	1 muaj	MMPH-IKMN	300	2,400	2,700
Hartimi i raportit përfundimtar, të përbërë nga një grup raportesh nën mbikqyrjen e ekspertit ndërkombëtar dhe drejtuesit të projektit pranë MMPH – 2 muaj stafi i MMPH për koordinim + 1 muaj, 7 anëtarë të stafit që punojnë në raportet mbi temat e caktuara + 30 ditë pune për ekspertët ndërkombëtarë + 10 ditë pune për 6 ekspertë vendorë.	2 muaj	MMPH-IKMN	2,700	31,550	34,250
Botimi i librit për florën, faunën dhe biotopet në Malet e Sharrit 200 faqe, me ngjyra, 500 kopje, 32 EUR/kopje.	3 muaj	MMPH-IKMN	900	16,000	16,900
TOTALI			**22,500**	**104,250**	**126,750**

5.1.5 Menaxhimi i mbeturinave

Titulli i projektit:
Rehabilitmi i deponisë së hirit në termocentralin Kosova A

Kohëzgjatja e projektit: 2,5 vite	**Data e propozuar për fillimin e projektit:** 2007
Nisma nga: MMPH	**Do të zbatohet nga:** MEM, KEK, MMPH, MEF, MSH
Vendi: Kosovë, Kastriot	

Qëllimet/synimet:	**Të dhënat themelore (situata aktuale):**
– Mirëmbajtja dhe rehabilitimi i deponisë së hirit të KEK-ut	– Sipërfaqja e deponisë është 110 ha, 32 mil ton. – Ndotja e ajrit – e shpërndarë pëermes erës (40 km) – Ndotja e tokës – erozioni, shkatërrimi i tokës. – Ndotja e ujit – ujrave nëntokësorë dhe sipërfaqësor. – Ekzistojnë studimet (puna shkencore) mbi mirëmbajtjen e deponisë.
Caqet/Rezultatet që priten:	**Treguesit/njësia matëse:**
– Deponia e rehabilituar. – Minimizimi i ndotjes – Përvojat e reja për mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e deponive të tjera. – Shkëmbimi i përvojave të ngjashme me shtetet e tjera të rajonit.	– Madhësia e sipërfaqes së rehabilituar. – Ulja e shkallës së ndotjes ekologjike (ajrit, ujit & tokës). – Investime më të mëdha në sipërfaqe rreth Kastriotit për të krijuar ambient më joshës dhe për ta zvogëluar ndotjen dhe rrezikun nga sëmundjet.

Trupi monitories: MEM, KEK, MMPH , MEF, MSH

Buxheti i përgjithshëm i porpozuar: 3.700.000 EUR.

Ky buxhet është përmbledhje e buxhetit që i takon një projekt-propozimi të plotë të hartuar nga MMPH. Shifrat janë llogaritje të përafërta të bazuara në metodën e propozuar për rehabilitim (mbulimin, bllokimin, dhe kultivimin e vegjetacionit që rritet shpejt dhe është zgjedhur posaçërisht). Edhepse ky projekt është me prioritet të lartë, nuk ekziston mundësia për të hartuar një buxhet shtesë apo alternativ për shkak të mungesës së informatave mbi aktivitetet e detajuara të projektit dhe të situatës tejet specifike të deponive të hirit në Kosovë.

Aktivitetet që do të financohen	**Kur (skema kohore)**	**Trupi/Personi Përgjegjës**	**Çmimi për aktivitet**
Realizimi i projektit	6 muaj		300,000 €
Ndihma teknike dhe profesionale	3x2 muaj		300,000 €
Dizajni i detajuar teknik	2 muaj		250,000 €
Aktivitetet për mirëmbajtje	12 muaj		2 800,000 €
Vlerësimi dhe raportimi përfundimtar	2 muaj	Lokal dhe ndërkombëtar	50,000 €
TOTAL			**3.700,000**

Titulli i projektit:

Ndërtimi i një objekti të përkohshëm për rajtjen e mbeturimave të rrezikshme

Kohëzgjatja e projektit:	**Data e propozuar për fillimin e projektit:**
2 vite	2007
Nisma nga:	**Do të zbatohet nga:**
MMPH	MMPH, MSH , MIT, MBPZHR
Vendi: Kosovë, mbetet të vendoset pas vlerësimit të detajuar të lokacionit, sasia dhe cilësia e mbeturinave të rrezikshme në atë territor	
Qëllimet/pikësynimet:	**Të dhënat themelore (situata aktuale):**
– Ruajtja (e përkohshme, deri në një kohë të caktuar) e mbeturinave të rrezikshme.	– Mbeturinat e rrezikshme aktualisht ruhen në hapësira të ndryshme joadekuate.

– Inventarizimi i sasisë dhe cilësisë së mbeturnave të rrezikshme..	– Rreziqet për popullatën dhe mjedisin. – Mungesa e kushteve të duhura për trajtimin e mbeturinave të rrezikshme dhe për minimizimin e sasisë së tyre.
Caqet/Rezultatet që priten: – Ruajtja e përkohshme ose për një kohë të caktuar dhe kontrollimi i vazhdueshëm i mbeturinave të rrezikshme të ruajtuara në atë objekt. – Minimizimi i rreziqeve shëndetësore dhe ekologjike.	**Treguesit/njësia matëse:** – Ndikimet pozitive në mjedis – Ulja e rrezikut nga mbeturinat e rrezikshme. – Krijimi i kushteve adekuate për ruajtje të sigurtë të përkohshme ose për një kohë të caktuar të mbeturinave të rrezikshme.
Trupi monitorues: MMPH	
Buxheti i përgjithshëm i propozuar: 760 000 EUR. Këto llogaritje të përafërta i ka dhënë MMPH dhe buxheti fillestar është dhënë në detaje më poshtë. Nuk ka pasur mundësi të jepen detaje për supozimet që fshihen prapa buxhetit as për madhësinë e objektit, vendin ku do të ndërtohet ose kapacitetin e tij. Natyrisht se kjo varet nga vlerësimi i hulumtimeve që do të zbatohen para se të mund të përgatitet një projekt-propozim i plotë dhe i detajuar.	

Aktivitetet që do të financohen	**Kur (skema kohore)**	**Trupi/Personi Përgjegjës**	**Çmimi për aktivitet**
Formimi i Grupit Punues	3 muaj	MMPH, MIT	10,000€
Studimi vlerësues dhe përgatitja e projektit	8 muaj	Lokal dhe ndërkombëtar	100,000€
Konstruktimi i objektit për ruajtje të mbeturinave	10 muaj	Tenderi	200,000€
Mbledhja (grumbullimi) dhe transportimi i mbeturinave nga vendet e ndryshme ku ato po mbahen aktualisht.	3 muaj	Tenderi	100,000€
Klasifikimi dhe vendosja në vendin për ruajtje	2 muaj	Komisioni i ekspertëve, TMK	150,000€
Menaxhimi afatgjatë	48 muaj	Menaxheri i vendit për ruajtje	200,000€
TOTALI			**760,000**

Titulli i projektit:
Pilot projekt mbi rehabilitimin e deponive të vjetra në komuna

Kohëzgjatja e projektit: 2 vite	**Data e propozuar për fillimin e projektit:** 2007
Nisma nga: MMPH	**Do të zbatohet nga:** AKM, Kuvendi Komunal i Prizrenit, kompania e deponisë
Vendi: Kosovë - Prizren	
Qëllimet/synimet: – Mirëmbajtja dhe rehabilitimi i deponisë së vjetër komunale në Prizren.	**Të dhënat themelore (situata aktuale):** – Sipërfaqja e deponisë rreth 15,000 m2, – Ndotja e ajrit nga djegia dhe lirimi i gazrave.

	– Ndotja e tokës – erozioni, shkatërrimi i tokës. – Ndotja e ujit – ujrave nëntokësor dhe sipërfaqësor. . – Mungesa e njohjes së anës praktike të përfitimeve potenciale ekonomike.
Caqet/Rezultatet që priten: – Rehabilitimi i deponisë – Minimizimi i ndotjes; – Përvojat e reja dhe njohuritë e vjelura për mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e deponive të tjera nëpër komuna (edhe shumë të tjera që kërkojnë punë në tërë Kosovën);	**Treguesit/njësia matëse:** – Sipërfaqja e rehabilituar, me përfitime potenciale ekonomike dhe më joshëse për komunitetin. – Ulja e nivelit të ndotjes mjedisore – Hulumtimet fillestare mbi numrin e deponive të tjera në Kosovë, të cilat do të mund të trajtoheshin në mënyrë të ngjashme.
Trupi monitorues: MMPH , KK Prizren, ndërmarrja shoqërore	
Buxheti i përgjithshëm i propozuar: 133,950 EUR. Çmimi i pajisjeve si dhe koha e punës që do ta bënin mirëmbajtjen është llogaritur përafërisht. Vlerësimi i deponive do ta bëjnë të mundur llogaritjen më të saktë të buxhetit.	

Aktivitet që do të financiohen:	**Kohëzgjatja**	**Trupi/personi përgjegjës**	**Buxheti i brendshëm (muaj* paga në EUR)**	**Buxheti i jashtëm (EUR)**	**Buxheti total**
Përgatitja e pikave të referencës për projektin, përfshirë këtu përshkrimin e rolit të ekspertëve teknik vendorë	2 muaj	MMPH	500		500
Rekrutimi i ekipit për projekt (1 drejtuesi të projektit nga MMPH, 1 anëtari të ekipit, 2 ekspertë vendorë).	2 muaj	MMPH	500		500
Vlerësimi teknik i deponisë së vjetër në Prizren, përfshirë këtu rekomandimet për rehabilitimin dhe përgatitjen e udhëzimeve për furnizimin e kompanisë mirëmbajtëse – 6 muaj DP nga MMPH me gjysmë orari të punës, 6 muaj ekipi nga komuna, 100 ditë ekspertët vendorë.	6 muaj	Komuna e Prizrenit, MMPH	1,950	19,000	20,950

Tenderimi i mirëmbajtjes së deponisë bazuar në specifikimet nga vlerësimi teknik – 1 muaj DP nga MMPH, 1 ekspert i furnzimit (10 ditë).	1 muaj	MMPH	250	1,900	2,150
Aktivitetet e mirëmbajtjes – mbulimi, kullimi, bllokimi, bjellja, vendosja e rrethojave – 8 muaj DP nga MMPH me gjysmë orari të punës dhe zyrtari komunal, 44 ditë eksperti vendor, 3*200 ditë të punës, pajisjet (betoni, fidanet, toka e pastër, sistemi për kullim, ai për bllokim, etj).	8 muaj	MMPH, Komuna e Prizrenit	2,600	105,600	108,200
Vlerësimi dhe raportimi – 2 muaj DP nga MMPH, ekipi i MMPH me gjysmë orari të punës, stafi i komunës me gjysmë orari të punës, 5 ditë eksperti vendor.	2 muaj	MMPH	700	950	1,650
TOTALI			**6,500**	**127,450**	**133,950**

Titulli i projektit:

Zgjërimi i infrastrukturës për mbledhjen e mbeturinave shtëpiake nëpër fshatra (Pilot projekt për një komunë rurale të Kosovës)

Kohëzgjatja e projektit: 3 vite	**Data e propozuar për fillimin e projektit:** 2007
Nisma nga: MMPH	**Do të zbatohet nga:** AKM, KK, ndërmarrja shoqërore
Vendi: Një komunë rurale e Kosovës	
Qëllimet/synimet: – Zgjërimi i rrjetit për mbledhjen e mbeturinave shtëpiake dhe rrijta e përqindjes së zonave ku mblidhen mbeturinat; – Përfshirja e më shumë zonave rurale në rrjetin e mbledhjes (grumbullimit) të mbeturinave. – Njohuritë e fituara mbi atë se si të përfshihen në	**Të dhënat themelore (situata aktuale):** – Vetëm 10% të fshatrave në Kosovë janë të përfshira në sistemin e mbledhjes së mbeturinave. – Ekziston një numër i madh i deponive të paligjshme në zonat rurale; – Ekziston rreziku i përhershëm nga deponimi i pakontrolluar i mbeturinave, djegia dhe

mënyrë sa më ekonomike zonat rurale në sistemin e mbledhjes së mbeturinave shtëpiake.	keqpërdorimi i tyre.
Caqet/Rezultatet që priten: – Rritja e nivelit të mbledhjes së mbeturinave shtëpiake në fshatra. – Ulja e nivelit të ndotjes së sipërfaqes – Përfitimi dhe shkëmbimi i përvojave për pastrimin e zonave dhe mbledhja efikase e mbeturinave në zonat rurale.	**Treguesit/njësia matëse:** – Mbledhja ekonomike e mbeturinave shtëpiake në zonat rurale. – Ulja e nivelit të ndotjes ekologjike në fshatra. – Mundësitë për të përfituar nga mbeturinat (letra, plastika, ricilimi i aluminit).
Trupi monitorues: MMPH	
Buxheti i përgjithshëm i propozuar: 139,305 EUR.	

Aktivitet që do të financiohen:	**Kohëzgjatja**	**Trupi/person i përgjegjës**	**Buxheti i brendshëm (muaj* paga në EUR)**	**Buxheti i jashtëm (EUR)**	**Buxheti total**
Përzgjedhja e pilot komunës rurale përmes rishikimit të raporteve ekzistuese dhe të dhënave që kanë të bëjnë me mbledhjen e mbeturinave shtëpiake si dhe interesimit të kompanive të mbeturinave dhe komunave për të marrë pjesë – 2 muaj Drejtuesi i Projektit nga MMPH, 10 ditë eksperti vendor.	2 muaj	MMPH Komuna	500	1,900	2,400
Përgatitja e planit të punës për përfshirjen e zonave rurale në komunën e zgjedhur në sistemin për mbledhjen e mbeturniave – 2 muaj DP nga MMPH, 2 muaj menaxhmenti i kompanisë së mbeturinave me gjysmë orari të punës, 22 ditë eksperti vendor.	2 muaj	MMPH, Komuna, kompania e mbeturinave	1,100	4,180	5,280

Furnizimi me pajisjet e nevojshme, përfshirë këtu kontejnerët, një automjet shtesë për mbledhjen e mbeturinave, rrobe, etj. – 1 muaj DP nga MMPH, ekipi nga komuna, menaxhmenti i kompanisë së mbeturinave, 10 ditë eksperti vendor.	1 muaj	MMPH, Komuna, kompania e mbeturinave	650	91,900	92,550
Shpërndarja e shportave për mbeturina dhe fushata për informimin e qytetarëve të përfshirë në sistemin për mbledhjen e mbeturinave – 3 muaj DP nga MMPH, ekipi nga komuna me gjysmë orari të punës, menaxhmenti i kompanisë së mbeturinave me gjysmë orari të punës, 22 ditë eksperti vendor, përgatitja dhe shpërndarja e 750 fletëpalosjeve.	3 muaj	MMPH, Komuna, kompania e mbeturinave	1,350	6,055	7,405
Monitorimi i zbatimit dhe i përshtatjes së projektit, aty ku ka nevojë – DP nga MMPH gjysmën e kohës së punës, ekipi nga komuna dhe menaxhmenti i kompanisë së plehrave, 6 punëtorë shtesë për kompaninë e mbeturinave, 48 ditë eksperti vendor.	24 muaj	MMPH, Komuna, kompania e mbeturinave	3,120	26,400	29520
Vlerësimi dhe rekomandimet – 1 muaj DP nga MMPH, 10 ditë eksperti vendor.	1 muaj	MMPH	250	1,900	2,150
TOTALI			**6,970**	**132,335**	**139,305**

Titulli i projektit:

Përdorimi i sërishëm i mbeturinave organike – mbështetja për iniciativat lokale për prodhimin (përpunimin) e plehrave dhe themelimin e fabrikës për përpunimin e plehrave

Kohëzgjatja e projektit: 3 vite	**Data e propozuar për fillimin e projektit:** 2007
Nisma nga: MMPH	**Do të zbatohet nga:** MMPH, MBPZHR
Vendi: Kosovë (vendi i saktë mbetet të përcaktohet, së paku një komunë me numër të mjaftueshëm të popullsisë të ndarë në mes të zonave rurale dhe urbane).	
Qëllimet/synimet: – Pengimi i grumbullimit të mbeturinave dhe minimizimi i hedhurinave, që do ta mbronte ajrin, tokën dhe ujrat tokësor dhe zgjatjen e afatit (jetës) së deponive. – Dizajnimi dhe zbatimi i një sisitemi efikas për	**Të dhënat themelore (situata aktuale):** – Nuk ekziston asnjë sistem për ndarjen e mbeturinave, vetëm kompani private për përdorimin e sërishëm të mbeturinave organike. – Ekziston një iniciativë lokale e shoqatës së bujqve 'Agroklina' për të prodhuar plehra natyror

menaxhim të mbeturinave biologjike – projekte provuese në një ose dy komuna. – Përfitimet ekonomike nga përpunimi i plehrave. – Promovimi i bujqësisë ekologjike, përdorimi i shtuar i përzierjes së plehrave për plehërim natyror.	në një shkallë më të lartë. – Mbeturiat organike përfundojnë në deponitë e zakonshme. – Nuk ekzistojnë kompani për prodhimin e plehrave natyror. – Plehrat natyror që përdoren për lule importohen (përderisa do të mund të prodhoheshin në Kosovë).
Caqet/Rezultatet që priten: – Krijimi i sistemit për ndarjen e mbeturinave, përfshirë mbledhjen dhe përpunimin e tyre. – Themelimi i një fabrike për prodhimin e plehrave natyror – në komuna. – Prodhimi i plehrave natyror për tregun kosovar. – Shtimi i përdorimit të sërishëm të materialit organik në ferma (të vogla). – Përgatitja dhe miratimi i neneve dhe akteve nënligjore. – Ulja e vëllimit të përgjithshëm të mbeturinave që hudhen dhe ulja e nivelit të ndotjes.	**Treguesit/njësia matëse:** – Sasia e mbeturinave organike që – shndërrohen (prodhohen) si plehra (në vit) – Numri i furnizuesve të fabrikës për – prodhimin e plehrave me mbeturina organike. – Të arriturat ekonomike dhe financiare të fabrikës për prodhimin e plehrave në përfundim të projektit. – Ngritja e nivelit të vetëdijes së qytetarëve për përpunimin e plehrave dhe pjesëmarrja e shtuar – e fermave (të vogla) në përpunimin e plehrave. – Zbatimi e sistemit ligjor.
Trupi monitorues: MMPH, MBPZHR	
Buxheti i përgjithshëm i propozuar: 1,254,910 EUR.	

Aktivitet që do të financiohen:	**Kohëzgjatja**	**Trupi/person i përgjegjës**	**Buxheti i brendshëm (muaj* paga në EUR)**	**Buxheti i jashtëm (EUR)**	**Buxheti total**
Përzgjedhja e pilot komunës përmes rishikimit të raporteve dhe të dhënave ekzistuese lidhur me mbledhjen e mbeturinave shtëpiake dhe sipas interesimit të kompanive për mbeurina dhe komunave për të marrë pjesë – 2 muaj Drejtuesi i Projektit nga MMPH, 10 ditë eksperti vendor.	2 muaj	MMPH	500	1,900	2,400
Përgatitja e pikave të referencës për projekt – 2 muaj DP nga MMPH, 2 muaj ekipi nga komuna, 2 muaj me gjysmë orari menaxhmenti i kompanisë së mbeturinave., 22 ditë eksperti vendor.	2 muaj	MMPH, Komuna kompania për mbeturina	1,100	4,180	5280
Tenderi, përzgjedhja dhe formimi i ekipit për projekt – DP nga MMPH 2 muaj me gjysmë orari të punës, eksperti vendor për 5 ditë.	1 muaj	MMPH	250	950	1,200

Përmbledhja e legjislacionit ekzistues, hartimi i neneve të nevojshme dhe hartimi i legjislacionit dhe procedurave shtesë – 4 muaj me gjysmë orari të punës DP nga MMPH, 22 ditë eksperti ligjor ndërkombëtar, 22 ditë eksperti ndërkombëtar për mbeturina organike, 44 ditë eksperti vendor.	4 muaj	MMPH, MBPZHR	500	50,960	51,460
Furnizimi me pajisje për sistem mbledhës – kontejnerë të mëdhenj për mbledhjen e mbeturinave organike (në rrugë ose për një grup familjesh), shporta të vogla për çdo shtëpi (përafërsisht 12,000 sosh), 2 automjete për mbeturina organike, rrobe - 3 muaj stafi i MMPH+stafi i komunës me gjysmë orari të punës dhe ekipi i kompanisë për mbeturina, 22 ditë eksperti vendor, 10 ditë eksperti ndërkombëtar.	3 muaj	MMPH, Komuna, kompania për mbeturina	1,350	512,030	513,380
Dizajnimi dhe zbatimi i fushatës për informimin e të gjitha familjeve në pilot komunë (përafërsisht 12,000 sosh) – 6 muaj ekipi i MMPH, ekipi i komunës me gjysmë orari të punës, 22 ditë eksperti vendor, 10 ditë eksperti ndërkombëtar, 100 ditë distributorët.	6 muaj	MMPH, Komuna	2,100	54,030	56,130
Përgatitja e Pikave të Referencës për ndërtimin e fabrikës rajonale për prodhimin e plehrave – 2 muaj DP nga MMPH, 1 muaj ekipi i komunës, 22 ditë eksperti ndërkombëtar, 33 ditë eksperti vendor.	2 muaj	MMPH, Komuna	700	23,170	23,870
Tenderi dhe përzgjedhja e konsorciumit/kompanisë për ndërtimin e fabrikës për përpunimin e plehrave – DP nga MMPH për 1 muaj, eksperti ndërkombëtar për 5 ditë, eksperti ndërkombëtar, 5 ditë.	1 muaj	MMPH	250	6,150	6,400
Ndërtimi i fabrikës për përpunimin e plehrave – llogaritjet e përafërta për ndërtimin e plotë dhe të gjitha pajisjet – mbikqyrja e punive nga ana e ekipit të MMPH dhe komunës (6 muaj, gjysmën e kohës së punës), eksperti vendor- 44 ditë, eksperti ndërkombëtar- 22 ditë, çmimi i fabrikës.	6 muaj	MMPH, Komuna	1,350	525,260	526,610
Kryerja e ndarjes së mbeturinave organike, sistemi për mbledhje dhe përpunim të plehrave – ekipi i MMPH gjysmën e kohës së punës - 18 muaj, menaxhmenti i kompanisë së mbeturinave gjysmën e kohës së punës - 18 muaj, eksperti ndërkombëtar - 22 ditë, ekspertët vendorë - 44 ditë, 15 punëtorë të fabrikës për përpunimin e plehrave - 15 ditë, 2 punëtorë shtesë për automjetet e mbeturinave.	18 muaj	MMPH, Komuna, kompania për mbeturina	40,770	25,260	66,030

Vlerësimi dhe rekomandimet 1 muaj DP i MMPH, 10 ditë eksperti vendor, 5 ditë eksperti ndërkombëtar.	1 muaj	MMPH	250	1,900	2,150
TOTALI			**49,120**	**1,205,790**	**1,254,910**

Titulli i projektit:
Objekti qendror për sterilizimin e mbeturinave infektive

Kohëzgjatja e projektit: 30 muaj	**Data e propozuar për fillimin e projektit:** 2008
Nisma nga: MMPH	**Do të zbatohet nga:** MMPH, MSH
Vendi: Prishtinë	
Qëllimet/pikësynimet: – Reduktimi i rreziqeve nga mbeturinat infektive	**Të dhënat themelore (situata aktuale):** – Sasi të mëdha të mbeturinave infektive, ruhet në shumë vende të papërshtatshme; – Rrezik i madh shëndetësor edhe për mjedisin edhe për popullatën në përgjithësi; – Mungojnë kushtet adekuate për trajtimin e mbeturinave infektive dhe reduktimin e sasisë së tyre.
Caqet/Rezultatet që priten: – Sterilizimi i mbeturinave infektive në një objekt qendror – Vendosja e monitorimit adekuat për mbeturinat infektive në rajon – Reduktimi i rreziqeve mjedisore dhe shëndetësore	**Treguesit/njësia matëse:** – Ndërtimi i objektit sterilizues – Sasia e mbeturinave të trajtuara në vit – Përqindja e mbeturinave infektive të trajtuara nga sasia e përgjithshme e tyre

Trupi monitorues: MMPH, MSH
Buxheti i përgjithshëm i propozuar: Nuk mund të përgatite buxhet për këtë projekt ngase nuk është bërë vlerësim i mirëfilltë i sasisë së mbeturinave infektive. Për më shumë transporti i mbeturinave infektive në një objekt qendror kërkon vëmendje të posaçme. Paraprakisht duhet kryer një studim i ndikimeve në shëndet nga ky transport dhe pastaj të zhvillohet ideja me gjerësisht. Vlen të theksohet se ky nuk është ndonjë projekt urgjent.

5.1.6 Shëndeti dhe mjedisi

Titulli i projektit:
Modernizimi i pajisjeve për kontroll në IKSHP

Kohëzgjatja e projektit: Gjatë një viti	**Data e propozuar për fillimin e projektit:** 2007
Nisma nga: IKSHP	**Do të zbatohet nga:** IKSHP
Vendi: Prishtinë	
Qëllimet/synimet: – Pajisja e Insitutit me mjete të standardizuara për monitorim (kontroll) – Ofrimi i trajnimeve përkatëse për personelin e Institutit	**Të dhënat bazike (situata aktuale):** – Në bazë të Direktivës Administrative të UNMIK-ut 2/99, IKSHP është përgjegjës për kontrollimin e cilësisë së ujit të pijshëm. – Edhepse IKSHP ka pasur mundësi ta përmirësojë thelbësisht funsionimin e tij përmes donacioneve nga ICRC,WHO, ECHO, pajisjet e reja janë të domosdoshme për kontrollin e mirëfilltë të substancave që duhen kontrolluar.

Caqet /Rezultatet që priten:	**Treguesit/njësia matëse:**
– Sigurimi i pajisjeve GC dhe HPLC. – Sigurimi i pajisjeve për përcaktimin e mostrave dhe vlerësimin e shpejtë të ujit të pijshëm (në laboratorin qëndror dhe në pikat rajonale) – Trajnimi i personelit të Institutit për operimin e pajisjeve. – Sigurimi i mirëmbajtjes së duhur përmes kontratës për servisim.	– Pajisjet e blera dhe të instaluara – Numri i personelit të përfshirë në trajnime. – Komentet e pjesëmarrësve në trajnime. – Kontraktimi i kompanisë për mirëmbajtje.
Trupi monitorues: MMPH	
Buxheti i përgjithshëm i propozuar: 233.510 EUR – çmimet e pajisjeve të nevojshme janë shuma të përafërta që janë siguaruar nga IKSHP.	

Aktivitetet që do të financohen	**Kohëzgjatja**	**Organizata/personi përgjegjes**	**Buxheti i brendshëm (muaj* paga në EUR)**	**Buxheti i jashtëm (EUR)**	**Buxheti total**
Përgatitja e Pikave të Referencës dhe një tenderi të bazuar në rregullat dhe procedurat e furnizimit – 2 muaj me gjysmë orari të punës; personeli i MMPH/IKSHP	2 muaj	IKSHP MMPH	500		500
Përzgjedhja e kompanisë/konsorciumit për sigurim të GC, HPLC dhe GCMRS dhe trajnimit të duhur për personelin – 2 muaj me gjysmë orari të punës; personeli i MMPH/IKSHP.	2 muaj	IKSHP, MMPH	500		500
Dërgesa dhe instalimi i këtyre tri pajisjeve – gjysmën e kohës personeli i IKSHP, 22 ditë ekperti ndërkombëtar duke llogaritur edhe shpenzimet e përafërta të pajisjeve.	2 muaj	IKSHP, MMPH	250	191,900	192,150
Trajnimi i personelit të Institutit për t'i përdorur pajisjet e reja – takime pune 3-5 ditore, përfishihen 5 anëtarë të ekipit, trajnim një javor në vend të punës 5*1 muaj ekipi i IKSHP; 30 ditë eksperti ndërkombëtar.	1 muaj	IKSHP, MMPH	1250	22,610	23,860

Udhëtim studimor njëjavor në Slloveni për 7 ekspertë të Kosovës të kontrollit të cilësisë së ujit , 3 persona kyç nga MMPH, të organizuar nga koordinatori i MMPH – (10,000 EUR për logjistikë për 10 persona + 10 ditë TA ndërkombëtar).	2 muaj	IKSHP, MMPH	500	16,000	16,500
TOTALI			**3,000**	**230,510**	**233,510**

Titulli i projektit:
Rishqyrtimi i rregulloreve mbi standardet për cilësinë e ujit të pijshëm

Kohëzgjatja e projektit: Gjatë një viti	**Data e propozuar për fillimin e projektit:** 2007
Nisma nga: IKSHP	**Do të zbatohet nga: IKSHP**
Vendi: Kosovë	
Qëllimet/synimet: – Përmirësimi i cilësisë së ujit të pijshëm për konsumatorët duke siguruar kontroll më të mirë dhe më të saktë të cilësisë së ujit të pijshëm.	**Të dhënat themelore (situata aktuale):** – Rregullorja mbi Kontrollin e Cilësisë së Ujit të Pijshëm, e aprovuar nga JIAS/UNMIK IA 2/99, e cila: – E autorizon IKSHP ta kontrollojë dhe të vendosë standarde. minimale për ujin e pijshëm. – T'i definojë standardet minimale për ujin e pijshëm në rajonet urbane dhe rurale, ujit të paketuar dhe atij rekreativ. – T'i definojë strategjitë për përcaktimin e mostrave për kontoll rutinor të ujit të pijshëm. – Rekomandohet që të gjitha këto të rishqyrtohen.

Caqet/Rezultatet që priten:	**Treguesit/njësia matëse:**
– Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i rregullores së re mbi ujin e pijshëm. – Rritja e kapacitetit të IKSHP për monitorim (kontroll) sipas standardeve të reja përmes trajnimit të personelit (takimeve të punes, udhëtimeve me qëllim studimi).	– Numri i pjesëmarrësve në vizitat studimore dhe takimet e punës. – Komentet e pjesëmarrësve. – Përgatitja dhe shpërndarja e manualit të udhëzimeve për zbatimin e cilësisë së ujit. – Hartimi dhe miratimi i rregullores së re.
Trupi monitorues: MMPH, ekspertët ndërkombëtar	
Buxheti i përgjithshëm i propozuar: 78,743 EUR	

Aktivitetet që do të financohen	**Kohëzgjatja**	**Organizata/personi përgjegjes**	**Buxheti i brendshëm (muaj* paga në EUR)**	**Buxheti i jashtëm (EUR)**	**Buxheti total**
Tenderi, përzgjedhja e ekipit zbatues kombëtar dhe ndërkombëtar – MMPH -1 muaj, personeli i IKSHP- 1 muaj, eksperti vendor -5 ditë.	1 muaj	IKSHP, MMPH	500	950	1,450
Hartimi i rregulloreve për kontrollin e cilësisë së ujit pas rishqyrtimit – personeli i MMPH -3 muaj me gjysmë orari të punës, personeli i IKSHP- 3 muaj, eksperti vendor- 22 ditë, eksperti ligjor ndërkombëtar-22 ditë.	3 muaj	IKSHP, MMPH	1,125	23,280	24,405
Takime të punës për personelin e IKSHP, hartuesit e politikave dhe menaxherëve të kompanive të ujit të pijshëm për rregulloret e reja (12 pjesëmarrës, takim 2 ditor) – 1 muaj personeli i IKSHP, 6 ditë- eksperti ndërkombëtar, 10 ditë- eksperti vendor (dhoma e mbledhjeve në IKSHP).	2 muaj	IKSHP, MMPH	250	7,708	7,958

Takim pune për 5 ekspertë të teknikës dhe kimisë nga IKSHP mbi detajet e rregulloreve të reja – trajnim në vendin e punës 10 ditor i realizuar nga eksperti ndërkombëtar dhe ai vendor.	1 muaj	IKSHP, MMPH	1250	9,750	11,000
Udhëtim njëjavor studimi në Slloveni dhe Kroaci për hartuesit e politikave mbi ujin nga MMPH, drejtorët e kompanive të ujit dhe personelin e IKSHP (10 pjesëmarrës – me shumën e përafërt të shpenzimeve prej 10, 000 EUR – 2 muaj MMPH gjysmën e kohës së punës, 10 ditë ekipi pranues (nikoqir) ndërkombëtar.	2 muaj	IKSHP, MMPH	250	16,000	16,250
Përgatitja e manualit për zbatimin e direktivave mbi cilësinë e ujit – 50 kopje; 2 muaj personeli i IKSHP, 22 ditë eksperti vendor, 15 ditë eksperti ndërkombëtar.	2 muaj	IKSHP MMPH	500	17,180	17,680
TOTALI			**3,875**	**74,868**	**78,743**

5.1.7 Sguria kimike dhe biologjike

Titulli i projektit:
Krijimi i sistemit për regjistrimin dhe autorizimin e kemikateve

Kohëzgjatja e projektit: 2 vit	**Data e propozuar për fillimin e projektit:** 2007
Nisma nga: MMPH	**Do të zbatohet nga:** MMPH, MSHP (Departamenti për Emergjencë)
Vendi: Kosovë	

Qëllimet/synimet:	**Të dhënat themelore (situata aktuale):**
– Krijimi i sistemit për regjitrimin dhe autorizimin e kemikateve të importuara. – Krijimi i infrastrukturës institucionale. – Aftësimi profesional i ekipit.	– Prodhimtaria vendore e kemikateve është e ulët (e parëndësishme), por ekzistojnë sasitë e mëdha të kemikateve të mbetura që duhet të menaxhohen në mënyrë të duhur. – Ligji mbi kemikatet nuk është miratuar ende. – Sistemi për informimin e opinionit nuk funksionon. – Kemikatet e importuara po përdoren në Kosovë sidomos në: – Industrinë e prodhimit të – metaleve – Në industritë e tjera të prodhimit dhe përpunimit. – Në institucionet mjekësore si në laboratore, etj. . – Në sektorin e bujqësisë – llojet e ndryshme të pesticideve dhe plehrave.
Caqet/Rezultatet që priten:	**Treguesit/njësia matëse:**
– Krijimi i bazës së të dhënave për kemikatet që importohen dhe shfrytëzohen në (industri, bujqësi, institucionet mjekësore) në Kosovë. – Përgatitja e udhëzimeve për regjistrim dhe autorizim. – Trajnimi i stafit mbi rregulloret – Forcimi i anës ligjore të menaxhimit të kemikateve. – Adoptimi i listës së kemikateve importimi dhe shfrytëzimi i të cilave duhet të ndalohet (sipas politikave të EU për kemikatet).	– Kompletimi i listës me numrin dhe llojet e kemikateve që përdoren në industritë dhe kompanitë e caktuara, institucionet dhe komuna dhe të kemikateve të importura. – Krijimi i bazës së të dhënave dhe regjistrimi e kontrolli i rregullt. – Përgatitja e udhëzimeve dhe shpërndarja e tyre zyrave ndërlidhëse dhe laboratoreve. – AKMM i implementon udhëzimet, i monitoron kemikatet dhe i përtrinë të dhënat.
Trupi monitorues: MMPH, DM, MSH	
Buxheti i përgjithshëm i propozuar: 108,260 EUR	

Aktivitet që do të financohen:	**Kohëzgjatja**	**Trupi/personi përgjegjës**	**Buxheti i brendshëm (muaj* paga në EUR)**	**Buxheti i jashtëm (EUR)**	**Buxheti total**
Vlerësimi i të dhënave ekzistuese në Kosovë dhe kërkesave legjislative të BE mbi kemikatet	3 muaj	MMPH	900		900
Përgatitja e Pikave të Referencës për zbatimin e projektit	3 muaj	MMPH	900		900
Përzgjedhja e ekipit për projekt & sotftware-it të përshtatshëm për krijimin e bazës së të dhënave.	1 muaj	MMPH	300		300
Furnizimi me software-ë & trajnimi i stafit të MMPH (AKMM) për përdorimin e software-it – 10 ditë eksperti vendor + 2,5 ditë takim pune me 10 persona, dhoma e mbledhjeve e siguruar nga MMPH:	2 muaj	MMPH, ekspertët e jashtëm, specialistët e TI	600	2,500	3,100

Mbledhja e të dhënave nga kompanitë, institucionet, agjencionet bujqësore, bujqit e mëdhenj, etj, anekënd Kosovës (3 punëtorë të ministrive, 15 muaj + 66 ditë shumëzuar me 3 ekspertë vendorë).	15 muaj	MMPH - AKMM,	13,500	56,450	69,950
Fushata për informimin e palëve të interesuara – shpërndarja e broshurës, 10 faqe, A5, 5000 kopje.	3 muaj	MMPH - AKMM,	900	10,250	11,150
TOTALI			**17,100**	**69,200**	**86,300**

Titulli i projektit:
Hartimi i Ligjit për Kemikatet

Kohëzgjatja e projektit: 15 muaj	**Data e propozuar për fillimin e projektit:** Fillimi i 2007
Nisma nga: MMPH	**Do të zbatohet nga:** MMPH, MSHP, MSH, MBPZHR
Vendi: Kosovë	

Qëllimet/synimet:	**Të dhënat themelore (situata aktuale) :**
